



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

RAPORTI I GJELBËR 2021



Raporti i Gjellbër i Kosovës 2021

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë 2021

Dhjetor, 2021

Fjala hyrëse

Sektori i bujqësisë ka një rëndësi të veçantë për zhvillim ekonomik të vendit andaj duhet parë dhe trajtuar si prioritet kombëtar

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka përgatitur Raportin e Gjelbër përmes të cilit është prezantuar gjendja e sektorit të bujqësisë në vend si dhe zhvillimet për vitin paraprak.

Përmes këtij raporti ofrohen informacione për gjendjen e sektorit të bujqësisë, për politikat zhvillimore, strategjitë dhe të dhëna tjera të cilat shërbejnë si tregues real të zhvillimit të sektorit në vendin tonë.

MBPZhR, gjatë kësaj periudhe ka arritur që të realizojë objektivat e veta, me qëllim të përmirësimit të qasjes në bujqësi, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin dhe zbatimin e legjislacionit si dhe modernizimin e tij në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Gjithashtu përmes memorandumeve të bashkëpunimit me vende mike, janë adresuar çështjet e bashkëpunimit institucional, ngritjes së kapaciteteve, aplikimit në projekte të përbashkëta zhvillimore, harmonizim të aktiviteteve, shkëmbim të praktikave si dhe çështje tjera të rëndësishme të veçantë që lidhen me zbatimin e praktikave më të mira.

Zhvillimi dhe implementimi i politikave të favorshme bujqësore janë prioritet i yni për zhvillim ekonomik të vendit. Eliminimi i obligimeve të grumbulluara ndër vite karshi fermerëve, përkrahje më e madhe financiare ndaj tyre për vitin fiskal 2021, rritja e buxhetit për vitin e ardhshëm mundëson rritjen e cilësisë së prodhimeve vendore, e në këtë mënyrë, rriten mundësitë reale të plasimit të prodhimeve vendore në tregje të reja.

Prioritet i yni vazhdon të mbetet zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe avancimi i tij, zhvillimi i zonave rurale, digjitalizimi i sektorit, avancimi i teknologjive, bashkëpunimi me gjitha palët e interesit vetëm që vendit dhe fermerit ti ofrohet shërbim cilësor, korrekt dhe në kohë.

Faton Peci

Ministër

Hyrja

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, këtë vit për 9ⁱⁿ vit me radhë harton dhe publikon Raportin e Gjellbër i cili për këto vite ka qen i vetmi raport që ka ofruar të dhëna të unifikuara në nivel vendi.

Tashmë, Raporti Gjellbër është bërë një udhërrëfyes për përdoruesit i cili vazhdon të ofrojë informacione për politikën, strategjitë zhvillimore, për gjendjen statistikore në Kosovë e gjithashtu duke ofruar informacione edhe mbi mundësitë e investimeve në sektor bazuar në të dhënat e paraqitura në raport.

Raporti Gjellbër çdo vit tenton të bëhet edhe më i pasur me të dhëna, falë bashkëpunimit të ngushtë me gjitha departamentet përgjegjëse dhe agjencitë e MBPZhR-së, Komitetin Drejtues të këtij raporti, agjencitë jashtë ministrisë si dhe organizatat tjera qeveritare dhe jo-qeveritare.

Raporti Gjellbër 2021 në përmbajtjen e tij paraqet të dhënat për mjedisin e përgjithshëm ekonomik, prodhimin bujqësor dhe përdorimin e tij, pylltarinë, tregtinë, sigurinë dhe cilësinë e ushqimit, politikën bujqësore të cilat përfshijnë pagesat direkte si dhe përkrahjen e zhvillimit rural, sa i përket këtyre të fundit (pagesat direkte dhe grantet) raportimi për vitin 2020, nuk ka qen i rregullt si vitet tjera për arsye të mos funksionimit të sistemit.

Si çdo vit edhe këtë vit Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore - DAESB përbërë nga **(Delvina Hana Bakija, Hakile Xhaferi, Adelina Maksuti, Edona Mekuli Fazliu, Skender Bajrami, Belgin Dabiqaj dhe Shkëlqim Duraku)** të cilët kanë rolin kryesor në hartimin e Raportit të Gjellbër, kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë me përkushtim maksimal që raporti të ofroj informacionet e nevojshme dhe të qëndrueshme mbi sektorin.

DAESB falënderon të gjithë lexuesit të cilët ofrojnë mbështetje dhe kritika e po ashtu, inkurajon të gjithë që të japin mendimet dhe sugjerimet e tyre që Raporti Gjellbër të jetë gjithnjë e më i plotësuar dhe në shërbim të sektorit.

Delvina Hana Bakija



Drejtoresh e Departamentit të Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave.....	4
Lista e figurave.....	7
Lista e shkurtesave	9
1 Mjedisi i përgjithshëm ekonomik	11
1.1 Niveli i zhvillimit socio-ekonomik.....	13
1.2 Puna dhe punësimi.....	14
1.3 Llogaritë ekonomike në bujqësi.....	16
1.3.1 Prodhimet bujqësore	16
1.3.2 Të ardhurat sipërmarrëse	19
1.3.3 Inputet në bujqësi	21
1.4 Çmimet e inputeve dhe prodhimeve bujqësore	22
1.4.1 Çmimet e inputeve bujqësore	22
1.4.2 Çmimet e prodhimeve bujqësore	24
Çmimet e fermës të prodhimeve bujqësore	24
Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore	25
Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore	27
Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së.....	29
1.5 FADN - Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit në fermë	30
1.5.1 Rezultatet Standarde të FADN-së në Kosovë	31
1.5.2 Krahasimi me vendet e BE-së	36
1.6 Privatizimi i tokave bujqësore	38
1.7 Bizneset bujqësore – Agroindustria	42
2 Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij.....	50
2.1 Përdorimi i tokës bujqësore.....	50
2.2 Madhësia e fermës.....	52
2.3 Prodhimtaria bimore.....	54
2.3.1 Drithërat	54
2.3.2 Perimet.....	57
2.3.3 Pemët.....	64
2.3.4 Vreshtat dhe verërat.....	70
Vreshtat.....	70
Verërat	74
Analizat fiziko-kimike të verës	75
2.3.5 Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra.....	77
2.3.6 Kulturat industriale.....	78
2.3.7 Prodhimtaria Organike në Kosovë.....	78
2.4 Ujitja e tokës bujqësore	79
2.5 Blegtoria.....	81
2.5.1 Gjedhet.....	81
2.5.2 Dhentë dhe dhitë	83
2.5.3 Derrat dhe kafshët tjera të fermës	83
2.5.4 Shpezëtaria	84
2.5.5 Bletaria	85

3	Pylltaria	86
4	Tregtia	96
4.1	Tregtia e përgjithshme	96
4.2	Tregtia e produkteve bujqësore	96
4.2.1	Tregtia sipas grupeve të shteteve	98
	Tregtia me vendet e CEFTA-s	98
	Tregtia me vendet e BE-së	100
	Tregtia me vendet e treta	102
4.2.2	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)	103
	Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)	103
	Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24)	104
5	Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit	106
5.1	Emetimi i gazrave serrë në Kosovë	112
6	Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural	116
6.1	Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve	116
6.2	Pagesat direkte/subvencionet	120
6.2.1	Pagesat direkte për kulturat bujqësore, verë dhe sigurim bujqësor	121
	Sigurimi bujqësor	124
6.2.2	Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht	125
6.2.3	Mbështetja e inputeve në bujqësi	127
	Mbështetja e fidanëve	127
6.3	Agro kreditë dhe fondi garantues	128
6.3.1	Agro Kreditë	128
6.3.2	Fondi garantues	132
	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore – FK GK	133
6.4	Sigurimet në fushën e bujqësisë	135
	Produktet Indeks të Sigurimit Bujqësor	135
	Dëmet/humbjet dhe Pagesat e Dëmshpërblimit	137
	Produktet Tradicionale të Sigurimit Bujqësor	137
	Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore	138
	Kampanjat Publike Vetëdijësuese	138
	Sistemi Informativ i Sigurimeve Bujqësore	138
	Faqja (www.sigurimibujqesor.com)	139
6.5	Projektet e zhvillimit rural – Grantet investive	139
6.6	Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve	143
6.6.1	Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor	143
6.6.2	Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor	147
6.7	Politikat mbi tregjet, tregtinë dhe zhvillimet e politikave ndërkombëtare	147
7	Shtojcat	149
7.1	Lista e ligjeve dhe akteve ligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural	149
7.1.1	Legjislacioni kombëtar në fuqi	149
7.1.2	Udhëzimet Administrative të miratuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2020	149
7.2	Statistikat krahasuese	149
7.3	Personat përgjegjës për Raportin e Gjellbër, 2021	151

Lista e tabelave

Tabela 1:	Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale (në '000 €)	12
Tabela 2:	Indikatorët kryesor të tregut të punës sipas variablave, 2017-2020 (%).....	15
Tabela 3:	Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2015-2020, (2015=100).....	23
Tabela 4:	Çmimet vjetore për energji elektrike dhe naftë në €, 2016-2020	24
Tabela 5:	Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, €/kg	25
Tabela 6:	Çmimet mesatare vjetore të tregut me shumicë, €/kg	26
Tabela 7:	Çmimet mesatare vjetore të tregut me pakicë, €/kg	27
Tabela 8:	Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, €/kg	28
Tabela 9:	Vlera për njësi e prodhimeve bujqësore të importuara, €/kg	29
Tabela 10:	Çmimet e disa prodhimeve në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2020, €/kg	30
Tabela 11:	Lloji dhe madhësia e fermës	31
Tabela 12:	Rezultatet standarde si mesatare për fermë, 2019.....	33
Tabela 13:	Lloji dhe struktura e fermës, 2019	36
Tabela 14:	Rezultatet standarde sipas regjioneve në €, 2019	36
Tabela 15:	Pragu minimal i madhësisë ekonomike dhe numri i fermave	37
Tabela 16:	Rezultatet standarde në Kosovë dhe disa vende të Bashkimit Evropian.....	37
Tabela 17:	Shitjet e tokave bujqësore në Kosovë, sipas regjioneve, 2005-2020.....	38
Tabela 18:	Shitja e tokave bujqësore në Kosovë, 2005-2020	41
Tabela 19:	Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2016-2020.....	43
Tabela 20:	Ndërmarrjet e regjistruara të agrobizneseve, 2016-2020	44
Tabela 21:	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari, 2020.....	46
Tabela 22:	Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive	50
Tabela 23:	Madhësia e ekonomive sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2020.....	52
Tabela 24:	Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i drithërave, 2016-2020	54
Tabela 25:	Bilanci i furnizimit për grurin, 2016-2020.....	55
Tabela 26:	Bilanci i furnizimit për misrin, 2016-2020	56
Tabela 27:	Sipërfaqja me perime, 2016 - 2020	57
Tabela 28:	Prodhimtaria e perimeve, 2016 - 2020.....	58
Tabela 29:	Rendimenti i perimeve, 2016 - 2020	59
Tabela 30:	Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i kulturave të dyta pas korres së parë	60
Tabela 31:	Bilanci i furnizimit për domaten, 2016-2020	61
Tabela 32:	Bilanci i furnizimit për specin, 2016-2020.....	62
Tabela 33:	Bilanci i furnizimit për pataten, 2016-2020.....	63
Tabela 34:	Sipërfaqja dhe prodhimtaria e pemëve, 2016 - 2020	65
Tabela 35:	Rendimenti i pemëve, 2016 - 2020.....	66
Tabela 36:	Bilanci i furnizimit për mollën, 2016-2020.....	67
Tabela 37:	Bilanci i furnizimit për kumbullën, 2016-2020.....	68
Tabela 38:	Bilanci i furnizimit për dredhëzën, 2016-2020	69
Tabela 39:	Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i rrushit, 2016-2020	70
Tabela 40:	Bilanci i furnizimit për rrush tryeze, 2016-2020	71

Tabela 41:	Varietetet e rrushit të tryezës, 2020	72
Tabela 42:	Varietetet e rrushit të verës, 2020	73
Tabela 43:	Prodhimi i verës 2016-2020, '000 litra	74
Tabela 44:	Prodhimi i verës sipas kompanive, 2020	75
Tabela 45:	Analizat fiziko – kimike të verës për periudhën 2016 - 2020	76
Tabela 46:	Sipërfaqja, prodhimtaria, rendimenti i kulturave foragjere dhe drithërave të kositura të gjelbëra, 2016-2020	77
Tabela 47:	Sipërfaqja dhe prodhimtaria e kulturave industriale, 2016-2020	78
Tabela 48:	Ujitja e tokave bujqësore në komuna për vitin 2020	80
Tabela 49:	Fondi dhe struktura e gjedheve, 2016-2020.....	81
Tabela 50:	Bilanci i furnizimit për mish të gjedhit, 2016-2020.....	82
Tabela 51:	Bilanci i furnizimit për qumështin dhe produktet e qumështit të lopës, 2016-2020	82
Tabela 52:	Numri i dhenve dhe dhive, 2016-2020.....	83
Tabela 53:	Numri i derrave dhe kafshëve të tjera të fermës, 2016-2020	84
Tabela 54:	Numri i shpezëve dhe vezëve 2016-2020, në '000	84
Tabela 55:	Numri i koshereve të bletëve, 2016-2020.....	85
Tabela 56:	Sipërfaqja pyjore sipas përbërjes dhe strukturës së grumbullit, (ha)	87
Tabela 57:	Pëlqimet për themelim, dhënia në menaxhim dhe PM	88
Tabela 58:	Tabela mbi licencat.....	89
Tabela 59:	Hartimi i Planeve Menaxhuese, 2020.....	90
Tabela 60:	Planifikimi vjetor në pyjet shtetërore, m ³	90
Tabela 61:	Realizimi i planit në shfrytëzim në pyjet shtetërore, m ³	90
Tabela 62:	Realizimi i shfrytëzimit të pyjeve shtetërore	90
Tabela 63:	Plani në pyjet private, 2020	91
Tabela 64:	Realizimi i aktiviteteve në pyjet private, 2020	91
Tabela 65:	Kallëzimet apo fletëparaqitjet, 2020	92
Tabela 66:	Konfiskimi i materialit drunor.....	92
Tabela 67:	Numri i rasteve të zjarreve pyjore dhe sipërfaqja, 2020	92
Tabela 68:	Prodhimtaria e fidanëve, 2020	93
Tabela 69:	Pyllëzimet vjeshtore, 2020	94
Tabela 70:	Eksporti-Importi i përgjithshëm.....	96
Tabela 71:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore.....	96
Tabela 72:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve, 2020.....	98
Tabela 73:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s	99
Tabela 74:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore në vendet CEFTA-s, në '000 €.....	100
Tabela 75:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore me vendet e BE-së.....	101
Tabela 76:	Eksporti sipas vendeve të BE-së në '000 € (majtas) dhe Eksporti sipas vendeve të BE-së në % (djathtas).....	102
Tabela 77:	Importi sipas vendeve të BE-së, në '000 € (majtas) dhe Importi sipas vendeve të BE-së në % (djathtas)	102
Tabela 78:	Importi dhe Importi nga Vendet e Treta	103

Tabela 79:	Eksporti i produkteve bujqësore 2016-2020, në '000 €	104
Tabela 80:	Importi i produkteve bujqësore 2016-2020, në '000 €	105
Tabela 81:	Objekte të aprovuara të ushqimit me prejardhje shtazore dhe aktiviteti i tyre.....	108
Tabela 82:	Regjistrimi i bizneseve të ushqimit me prejardhje jo shtazore	109
Tabela 83:	Realizimi i programeve dhe aktiviteteve të vaksinimit.....	109
Tabela 84:	Marrja e mostrave të gjakut dhe dërgimi në laboratorin e AUV-se.....	109
Tabela 85:	Asgjësimi i kafshëve të cilat kanë rezultuar pozitiv në sëmundjet infektive.....	109
Tabela 86:	Numri i lejeve të lëshuara nga shëndeti i kafshëve	110
Tabela 87:	Licencimi i subjekteve afariste sipas kërkesave të parashtruara	110
Tabela 88:	Raportimi i therjeve, importi dhe lëvizja e kafshëve	110
Tabela 89:	Numri i inspektimeve dhe mostrave të marra nga Drejtoria e Inspektoratit	111
Tabela 90:	Numri i mostrave të pranuar, parametrave të testuar, lëshimi i raporteve të testimit nga LUV, 2020	111
Tabela 91:	Rezultatet e cilësisë së qumështit ngarkesa bakteriale	111
Tabela 92:	Klasifikimi i qumështit sipas qelizave somatike, 2020	112
Tabela 93:	Emetimet e përgjithshme të gazrave të serrës në Kosovë sipas sektorëve, 2019	112
Tabela 94:	Burimet kryesore të emetimeve të gazrave serrë në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokave sipas sektorëve dhe nën sektorëve për vitin 2019	114
Tabela 95:	Buxheti për pagesa direkte për njësi të subvencionuar duke përfshirë edhe PRE, 2020.....	117
Tabela 96:	Pagesat direkte 2016-2020, në €	118
Tabela 97:	Pagesat direkte sipas sektorëve, 2016-2020.....	121
Tabela 98:	Pagesat direkte sipas sektorëve, 2016-2020.....	125
Tabela 99:	Pagesat direkte për fidanë sipas regjionit, 2020	127
Tabela 100:	Agrokreditë 2016 – 2020	129
Tabela 101:	Shpërndarja rajonale e kredive të miratuara	134
Tabela 102:	Buxheti i paraparë i PZHR-së, 2020-2021	141
Tabela 103:	Numri i aplikacioneve, vlera e aplikuar e miratuar dhe autorizuar për masën 101.....	142
Tabela 104:	Numri i aplikacioneve, vlera e aplikuar e miratuar dhe autorizuar për masën 103.....	142
Tabela 105:	Numri i aplikacioneve, vlera e aplikuar e miratuar dhe autorizuar për masën 302.....	143
Tabela 106:	Pjesëmarrja në trajnime	144
Tabela 107:	Aktivitetet e zhvilluara në qendrat këshilluese komunale	145
Tabela 108:	Aktivitetet e zhvilluara në terren nga këshilltarët	146
Tabela 109:	Licencimi i kompanive për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural	147
Tabela 110:	Reshjet mesatare për vit sipas zonave klimatike, (mm, l/m ²)	149
Tabela 111:	Pyjet e Kosovës sipas llojit dhe pronësisë	149
Tabela 112:	Përdorimi i internetit sipas grup-moshave, %.....	150
Tabela 113:	Treguesit e zgjedhur makroekonomikë.....	150

Lista e figurave

Figura 1:	Pjesëmarrja e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor 2010-2020, (në %)	13
Figura 2:	Indikatorët kryesor të tregut të punës, 2017-2020 (%)	16
Figura 3:	Prodhimet bimore dhe blegtorale në mil. €, 2016-2020	17
Figura 4:	Pjesëmarrja e kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor, 2020.....	17
Figura 5:	Shitja e mishit sipas kategorisë (majtas) dhe e produkteve blegtorale (djathtas),2020	18
Figura 6:	Prodhimet bimore në mil. €, 2016-2020	18
Figura 7:	Blegtoria në mil. €, 2016-2020.....	19
Figura 8:	Produktet blegtorale në mil. €, 2016-2020	19
Figura 9:	Prodhimi bujqësor, konsumi i ndërmjetëm dhe bruto vlera e shtuar në mil. €, 2016-2020	20
Figura 10:	Të hyrat e agreguara në bujqësi në mil. €, 2016-2020.....	20
Figura 11:	Struktura e konsumit të ndërmjetëm, 2020	21
Figura 12:	Inputet në bujqësi sipas kategorive, 2020.....	22
Figura 13:	Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2015-2020, (2015=100).....	23
Figura 14:	Vlera e shtuar neto e fermës për njësi vjetore të punës si mesatare për fermë , 2019.....	34
Figura 15:	Gjithsej outputi sipas llojit të fermës në € si mesatare për fermë, 2019	34
Figura 16:	Raporti i gjithsej outputit/inputeve sipas llojit të fermës, 2019	35
Figura 17:	Fuqia punëtore e paguar dhe e papaguar sipas llojit të fermës, 2019.....	35
Figura 18:	Sipërfaqja e shitur e tokave bujqësore dhe vlera totale e shitjeve, 2005-2020.....	39
Figura 19:	Shitja e tokave bujqësore në ha, 2005-2020.....	39
Figura 20:	Çmimi mesatar i shitjes sipas regjioneve, €/ha	40
Figura 21:	Numri më i madh i ha të shitur të tokës bujqësore sipas komunave, ha	42
Figura 22:	Çmimi më i lartë i shitjes sipas komunave, në €	42
Figura 23:	Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2016-2020.....	43
Figura 24:	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari (%), ndaj aktiviteteve tjera ekonomike, në vitin 2020.....	44
Figura 25:	Qarkullimi monetar i ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari, 2016-2020, ('000 €).....	45
Figura 26:	Numri i të punësuarve në agrobiznese, 2016-2020	45
Figura 27:	Numri i bizneseve aktive, 2016-2020	46
Figura 28:	Qarkullimi ('000 €), sipas aktiviteteve bujqësore, 2020	47
Figura 29:	Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve bujqësore, 2020.....	47
Figura 30:	Numri i bizneseve aktive në vitin, 2020	48
Figura 31:	Qarkullimi, numri i te punësuarve dhe numri i bizneseve aktive në sektorin e bujqësisë sipas regjioneve (%), 2020	49
Figura 32:	Tokë e punëshme-ara (duke përjashtuar perimet) dhe Livadhe e kullosa	51
Figura 33:	Perime, kopshte dhe fidanishte, plantacione të pemëve dhe vreshtave	51
Figura 34:	Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, 2020	52
Figura 35:	Madhësia e fermës sipas sipërfaqes 2020, në %	53
Figura 36:	Numri i ekonomive bujqësore sipas madhësisë së fermës 2020, (%).	53
Figura 37:	Sipërfaqja e vreshtave në ha, 2016-2020.....	70

Figura 38:	Prodhimtaria e rrushit në tonë, 2016-2020	71
Figura 39:	Prodhimi i verës 2016-2020, '000 litra	74
Figura 40:	Eksporti i bimëve mjekuese aromatike në vlerë dhe sasi, (2015-2020)	79
Figura 41:	Klasat e përdorimit të tokës në Kosovë (% nga sipërfaqja totale e tokës)	86
Figura 42:	Eksport, Importi dhe Bilanci tregtar i produkteve bujqësore (1-24), në '000.....	97
Figura 43:	Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm (majtas), Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm (djathtas).....	97
Figura 44:	Eksporti sipas grupeve të shteteve (majtas), Importi sipas grupeve të shteteve (djathtas), 2020	98
Figura 45:	Pjesëmarrja e bujqësisë në eksportin e përgjithshëm (majtas), Pjesëmarrja e bujqësisë në importin e përgjithshëm (djathtas)	99
Figura 46:	Eksporti sipas vendeve të CEFTA-s (majtas), Importi sipas vendeve të CEFTA-s (djathtas), 2020....	100
Figura 47:	Pjesëmarrja e bujqësisë në eksportin e përgjithshëm (majtas), Pjesëmarrja e bujqësisë në importin e përgjithshëm (djathtas)	101
Figura 48:	Eksporti në Vendet e Treta, (majtas) dhe Importi nga vendet e Treta, në % (djathtas).....	103
Figura 49:	Emetimi i GHG sipas sektorëve, 2019 (%).....	113
Figura 50:	Trendi i emetimeve totale të gazrave të serrës nga sektori i bujqësisë 2007-2019.....	114
Figura 51:	Pagesat direkte 2016-2020, në 1000 €.....	119
Figura 52:	Pagesat direkte sipas sektorëve 2020, në mil. €	119
Figura 53:	Numri i përfituesve dhe të refuzuarve në vitin 2020.....	120
Figura 54:	Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2020	123
Figura 55:	Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2020.....	123
Figura 56:	Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2020	126
Figura 57:	Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2020.....	127
Figura 58:	Shuma totale dhe numri i agrokredive të disbursuara (mil. € dhe '000).....	129
Figura 59:	Shuma e agrokredive nga Bankat dhe IMF, mil. €	130
Figura 60:	Numri agrokredive nga Bankat dhe IMF, '000 €	131
Figura 61:	Norma e interesit në kredi bujqësore nga Bankat dhe IMF, %	131
Figura 62:	Proporcioni i shpërndarjes së kredive, %	134
Figura 63:	Sipërfaqja totale e siguruar në ha dhe nr. i fermerëve të siguruar	136

Lista e shkurtesave

AEB	Anketa Ekonomive Bujqësore
AFK	Agjencia për Financim në Kosovë
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AME	Agjencia për Menaxhimin Emergjent
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
AZhB	Agjencia për zhvillimin e Bujqësisë
BE	Bashkimi Evropian
BPB	Banka Private për Biznes
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja për tregti të lirë me vendet e Evropës Qendrore
DAESB	Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore
DCA	Autoriteti për Zhvillim të Kredisë
DK	Drejtoritë Koordinuese
DMKE	Drejtoria për menaxhimin me kafshët e egra dhe Ekoturizmi
DP	Departamenti i Pyjeve
DPBT	Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve
DPZhr	Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural
DShKT	Departamenti i Shërbimeve Këshillimore Teknike
EC	Komisioni Evropian
FADN	Rrjeti i Kontabilitetit të të dhënave në Fermë
FAO	Organizata për Ushqim dhe Bujqësi
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GLV	Grupe Lokale të Veprimit
I&R	Identifikimi dhe Regjistrimi
IBK	Instituti Bujqësor i Kosovës
IFP	Institucione Financiare Partnere
IJPShESh	Institucionet Jo përfituese në Shërbim të Ekonomive Shtëpiake
IKShPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë
IMF	Institucionet Mikro Financiare
ISO	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim
KBO	Komisioni për Bujqësi Organike
KE	Komisioni Evropian
KEP	Programi i Ndërmarrjeve të Kosovës
KRK	Kreditimi Rural i Kosovës
LUV	Laboratori i Ushqimit dhe Veterinës
LIEB	Llogaritë Ekonomike për Bujqësi
MAD	Murtaja Afrikane e Derrave
MBPZhr	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MINT	Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asociim
NSH	Ndërmarrja Shoqërore
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
NjB	Njësi Blegtorale
NjM	Njësia menaxhuese me pyje
NjVP	Njësia Vjetore e Punës
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OBU	Objektet Bujqësore Ushqimore/ Operatorët e Biznesit me Ushqim
OJQ	Organizata jo Qeveritare
PBZHR	Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
PCB	Procredit Bank
PKPR	Plani Kombëtar për Pyllëzime dhe Ripyllëzime
PM	Plane Menaxhuese
PMB	Produktet e Mbrojtjes së Bimëve
PRE	Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike
QKI	Qendra Këshilluese Informative
QS	Qelizave Somatike
RBKO	Raiffeisen Bank
RSB	Regjistri Statistikor i Bizneseve
SBSH	Sipërfaqja Bujqësore e Shfrytëzuar
SE	Variablat në FADN
SO	Standardi Output
SZhL	Strategjia Zhvillimore Lokale
TAIEX	Asistencë Teknike dhe Shërbim i Informacioneve
TBC	Sëmundja e Tuberkulozit
TEB	Banka Ekonomike Turke
UA	Udhëzim Administrativ
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

1 Mjedisi i përgjithshëm ekonomik

Gjatë vitit 2020 përhapja e pandemisë Covid-19 ka rritur ndjeshëm rreziqet ndaj stabilitetit financiar. Goditja ekonomike e nxitur nga përhapja e pandemisë ishte më e larta ndonjëherë në ekonominë e Kosovës. Masat lehtësuese të ndërmarra nga qeveria si dhe Banka Qendrore, në linjë me masat e ndërmarra në nivel global, kanë zbutur bartjen e efektit të menjëhershëm të pandemisë në sistemin financiar. Kjo situatë ka ndikuar, që në një periudhë afatmesme dobësitë ndaj stabilitetit financiar janë rritur si pasojë e dobësimit të aftësisë paguese të sektorit privat, përkatësisht rënies së qarkullimit të ndërmarrjeve dhe nivelit të ardhurave të ekonomive familjare, dinamika që priten të reflektohen në rrezik të shtuar kreditor është e lartë. Masat e ndërmarra për parandalimin e përhapjes së pandemisë kanë ndikuar në rënie të ndjeshme të aktivitetit ekonomik në vitin 2020, në të gjitha vendet anëtare të Eurozonës dhe në ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ekonomia e Eurozonës, partnerët kryesor tregtar të Kosovës dhe vendet me origjinën më të lartë të remitencave, në vitin 2020 ka shënuar rënie prej mesatarisht 6.6%. Ballkani Perëndimor u karakterizua me rënie mesatare ekonomike prej 5.6%, e cila ishte më e theksuar në shtetet si Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina. Ekonomia e Kosovës, e cila ka varësi të lartë nga diaspora dhe eksporti i shërbimeve të udhëtimit nga vizitat e diasporës në Kosovë, u ndikua konsiderueshëm nga përhapja e pandemisë. Rënia e investimeve si dhe rënia e shërbimeve të eksportit ishin komponentët dominues me ndikim në rënien prej 3.9% të aktivitetit ekonomik në vitin 2020.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat e rishikuara të Bruto Produktit Vendor (BPV) sipas dy qasjeve (sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve), me çmime aktuale dhe çmime të vitit paraprak për periudhën 2008-2020, bazuar në ESA 2010. Bruto Produkti Vendor (BPV) është treguesi më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtar e që paraqet performancën e ekonomisë së një shteti për një periudhë kohore. Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale në vitin 2020 ishte 6,771.6 mil. €. Rënia reale në vitin 2020, në krahasim me vitin 2019 ishte (-5.34%). BPV për kokë banori për vitin 2020 ishte 3,772 €. Ndërkaq, rritje reale për vitin 2020 kishte në këto aktivitete ekonomike: Furnizim me energji elektrike dhe me gaz (10.5%); Shëndetësi dhe aktivitete të punës sociale (9.0%); Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike (7.9%); Shërbime të tjera (6.9%); Aktivitete financiare dhe të sigurimit (2.0%); Administrim publik dhe të mbrojtjes, sigurim të detyrueshëm social (1.6%); Industri përpunuese (1.2%); Afarizëm me pasuri të patundshme (0.9%); dhe në Industri nxjerrëse (0.5%). Kurse, rënie kishte në këto aktivitete: Hotele dhe restorante (-29.8%); Art, zbavitje dhe rekreacion (-27.1%); Transport dhe magazinim (-23.8%); Ndërtimtari (-9.0%); Furnizim me ujë (-7.4%); Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i automjeteve dhe motoçikletave (-6.4%); Bujqësi, gjueti, pylltari dhe peshkim (-5.8%); Edukim (-5.5%); Aktivitete administrative dhe mbështetëse (-5.1%); Informim dhe komunikim (-1.2%).

Rritja reale sipas komponentëve kryesorë të BPV-së me qasjen e shpenzimeve për vitin 2020 ishte siç vijon: Eksporti i mallrave (21.7%); Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake (2.5%); Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (2.1%). Rënie kishte në këta komponentë: Eksport i shërbimeve (-41.0%); Importi i shërbimeve (-16.2%); Formim i bruto kapitalit (-7.1%).


Tabela 1: Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale (në '000 €)

Aktivitetet ekonomike	2016	2017	2018	2019	2020
A Bujqësia, gjuetia , pylltaria dhe peshkimi	493,337	470,932	435,728	510,773	498,526
B Industria nxjerrëse	135,359	140,949	145,613	141,292	134,574
C Industria përpunuese	788,181	812,663	875,803	907,614	904,149
D Furnizimi me energji elektrike, me gaz	211,821	230,777	233,085	238,927	264,917
E Furnizimi me ujë	43,732	47,710	47,734	46,478	43,089
F Ndërtimtaria	442,423	517,679	559,677	577,092	519,420
G Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve	742,828	797,251	833,724	900,211	867,439
H Transporti dhe magazinimi	268,472	283,367	298,045	309,376	262,999
I Hotelet dhe restorantet	96,659	116,839	129,050	146,705	110,855
J Informimi dhe komunikimi	107,708	113,331	124,441	130,784	134,577
K Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	182,379	196,229	237,273	272,558	277,337
L Afarizmi me pasuri të patundshme	441,547	456,679	474,820	490,441	493,438
M Aktivitetet profesional, shkencore dhe teknike	94,390	96,606	97,762	99,929	107,358
N Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	41,739	45,070	49,338	52,125	49,589
O Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	341,553	355,515	386,556	419,183	444,284
P Edukimi	242,071	244,820	254,655	258,019	257,380
Q Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	124,904	129,496	143,698	154,599	180,459
R Art, zbavitje dhe rekreacion	25,840	27,157	28,855	17,284	13,228
S Shërbime tjera	22,253	22,904	23,935	25,245	26,905
T Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës					
BVSH me çmime bazë	4,847,198	5,105,974	5,379,793	5,698,635	5,590,522
Tatimet në produkte	1,220,098	1,300,192	1,341,373	1,419,039	1,278,134
Subvencionet ne produkte	(30,023)	(49,710)	(49,644)	(61,502)	(97,055)
Bruto Produkti Vendor	6,037,273	6,356,456	6,671,522	7,056,172	6,771,601

Burimi: ASK - Bruto Produkti Vendor 2016-2020

Bazuar në publikimin e përgatitur nga ASK “Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2008 – 2020”, vërejmë se pjesëmarrja e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor ishte në vitin 2010 (9.5%), pasuar nga viti 2013 që ishte 8.4%, ndërsa pjesëmarrje më e ulët paraqitet në vitin 2018 me 6.5%. Në vitin 2020 kjo pjesëmarrje ishte 7.4%

Figura 1: Pjesëmarrja e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor 2010-2020, (në %)



Burimi: ASK - Bruto Produkti Vendor 2016-2020

1.1 Niveli i zhvillimit socio-ekonomik

Niveli i zhvillimit rural është procesi i përmirësimit të cilësisë së jetës dhe mirëqenies ekonomike të njerëzve që jetojnë në zonat rurale, përmes shfrytëzimit të burimeve natyrore, si bujqësia dhe pylltaria. Përdorimi i qëndrueshëm i resurseve në këtë rast tokës bujqësore bën të mundur rritjen e prodhimeve bujqësore, e cila ndikon në rritjen e të ardhurave rurale, nxit konsumin më të lartë dhe ka efekte të rëndësishme në të gjithë ekonominë e vendit. Duke pasur parasysh rritjen e kërkesës globale për ushqim, sektori i bujqësisë ofron mundësi të pashfrytëzuara punësimi. Në zhvillimin e bujqësisë në zonat rurale ekzistojnë disa pengesa që ndër të tjera mund të numërohen: mungesa e infrastrukturës, barrierat gjeografike, qasje e pamjaftueshme në tregje, aplikimi jo i mjaftueshëm i teknologjisë dhe cilësia e arsimit dhe shërbimit social. Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2020 ishte 420,210 ha, ku pjesëmarrje më të madhe kanë drithërat (30%), kulturat foragjere (9%), perimet (3.3%), pemët (2.4%), vreshtat (0.8%), ndërsa pjesën tjetër prej 51.7% e përbëjnë livadhet, kullosat dhe toka e përbashkët. Fermat e Kosovës në përgjithësi karakterizohen me madhësi mesatare të vogël, ku rreth 90% të fermave në Kosovë kanë sipërfaqe më të vogël se 5 ha, gjë që ndikon në prodhimtari të ulët dhe rrit e koston e prodhimit.

Bazuar në rëndësinë e bujqësisë, politikat bujqësore janë bërë gjithnjë e më shumë çështje kryesore në politikat zhvillimore në vendin tonë, duke marr për bazë rëndësinë dhe pjesëmarrjen e bujqësisë në bruto produktin vendor, në vitin 2020 ka pasur pjesëmarrje prej 7.4%.

Në kuadër të politikave bujqësore MBPZhR përgatit Programin vjetor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në të cilin janë caktuar objektivat dhe përparësitë për bujqësi dhe zhvillim rural, që synojnë një përafrim gradual të politikave tona bujqësore me Politika të Përbashkëta Bujqësore të BE-së.

Buxheti i alokuar në sektorin e bujqësisë në vitin 2020, u rrit në 69 mil. €, krahasuar me vitin 2019 ishte 54 mil. €. Buxheti i planifikuar për shtyllën e parë të PBZhR-së për pagesa direkte ishte 23,998 mil. €, ndërsa, për implementimin e programit të zhvillimit rural apo shtylla e dytë e programit-grantet investive, buxheti i planifikuar ishte 19,358 mil. €.

Bujqësia edhe pse ka një rol të madh në sigurimin e ushqimit për popullsinë vendore me aktivitetet e shumta që kryen njeriu ndikon po ashtu edhe në ndotjen e ambientit duke marrë pjesë në emetimin të gazrave serrë. Emetimi i gazrave serrë nga sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokave, ka pjesëmarrje rreth 8% të emetimit të përgjithshëm të gazeve serrë në Kosovë. Në vitin 2019, janë regjistruar rreth 706 Gg CO₂ eq., përkatësisht 706 mijë ton CO₂ eq.

Bujqësia vazhdon të ketë qasje të ulët në financimin e përgjithshëm bankar. Normat e interesit të kredive bankare për prodhuesit bujqësor janë mjaft të larta dhe aspak të favorshme. Afati i dhënies së kredive bujqësore ndryshon nga 18 deri 42 muaj, varësisht prej destinimit të kredisë, shumës dhe afatit të kthimit. Norma e interesit ndryshon nga 6.4% deri në 28.4%.

Në vitin 2020 vlera e eksportit të produkteve bujqësore të eksportuara ishte 78.1 mil. €. dhe ky vit paraqet vlerën më të madhe të eksportit për këtë periudhë kohore, dhe nëse e krahasojmë me vlerën e eksportit të vitit 2019 del të jetë një rritje prej 19.2%.

Vlera e importit të produkteve bujqësore (01-24) në vitin 2020 ishte 765.4 mil. €, që paraqet rritje për 0.7%, krahasuar me vitin 2019, dhe gjithashtu rritjen më të ulët në vlerë të importit për periudhën 2014-2020. Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm në vitin 2020 është 16.4%, përderisa pjesëmarrja e importit është 23.2%.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës ka bërë realizimin e kontrolleve zyrtare sipas planeve nacionale, tek operatorët e biznesit me ushqim me veprimtari prodhuese, përpunuese, deponuese, distribuese dhe tek afarizmi me ushqim në nivelin me pakicë, gjithashtu edhe menaxhimi, koordinimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve me inspektorate, në mbikëqyrje të zbatimit të masave Anti COVID-19.

1.2 Puna dhe punësimi

Të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore të vitit 2020, ofrojnë të dhëna statistikore mbi indikatorët statistikorë të tregut të punës dhe mundëson krahasimin e tyre me vitet paraprake dhe gjithashtu paraqesin një përmbledhje të gjendjes së tregut të punës të popullsisë së Kosovës sa i përket ofertës së tregut të punës, që do të thotë klasifikimi i tregut të punës për popullsinë e Kosovës në vitin 2020.

Indikatorët kryesor të paraqitur në tabelën në vijim janë: shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore që sipas kësaj ankete është përqindja e popullsisë së një vendi në moshë pune

(moshës 15 deri 64 vjeçare), që angazhohet në mënyrë aktive në tregun e punës (të punësuar apo të papunësuar).

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ndryshon nga viti në vit. Në vitin 2017 kjo pjesëmarrje arriti në 42.8%, ndërsa në vitin 2020 ishte 38.3%.

Tabela 2: Indikatorët kryesor të tregut të punës sipas variablave, 2017-2020 (%)

Indikatorët kryesorë të tregut të punës sipas variablave	2017	2018	2019	2020
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	42.8	40.9	40.5	38.3
Shkalla e jo aktivitetit	57.2	59.1	59.5	61.7
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	29.8	28.8	30.1	28.4
Shkalla e papunësisë	30.5	29.6	25.7	25.9
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	52.7	55.4	49.4	49.1
Përqindja e të rinjve (NEET) në popullsinë e të rinjve (15-24 vjeç)	27.4	30.1	32.7	33.6
Përqindja e punësimit të paqëndrueshëm ndaj punësimit të përgjithshëm	23.1	19.6	18.8	17

Burimi: ASK - Anketa e Fuqisë Punëtore, '17, '18, '19, '20

Indikator tjetër për tregun e punës është shkalla e jo aktivitetit që paraqet përqindjen e popullsisë në moshë pune të një vendi, që nuk bënë pjesë në fuqinë punëtore (as të punësuar as të papunë) në vitin 2020 ishte 61.7%.

Raporti i punësimit ndaj popullsisë (shkalla e punësimit), 28.4% (347,071 persona) janë të punësuar. Kur flasim për shkallën e punësimit, përqindje më e lartë e punësimit paraqitet në vitin 2019 me 30.1%, ndërsa më e ulët paraqitet në vitin 2020 që ishte 28.4%. Krahësuar me vitin e kaluar (2019) të AFP-së në Kosovë, kemi rënie të shkallës së punësimit me 1.7%, ku kjo rënie të meshkujt ishte 3.4% përderisa të femrat kemi rritje për 0.2%.


Nga 38.3% (468,451 persona) e popullsisë, që është ekonomikisht aktive, 25.9 % (121,379 persona) janë të papunë. Shkalla e papunësisë më e madhe ishte në vitin 2017 me përqindje prej 30.5%, ndërsa në vitin 2019 ishte 25.7% që njëkohësisht paraqet shkallën më të ulët të papunësisë për këto 4 vite.

Shkalla e papunësisë së të rinjve të moshës 15-24, edhe këtë vit është mjaft e lartë, kështu që të rinjtë e kësaj kategorie e kanë të vështirë gjetjen e një vendi të punës që ata e kërkojnë. Në vitin 2020 shkalla e papunësisë paraqitet me 49.1%, që është shkallë e përafërt me atë të vitit 2019 (49.4%)

Kur flasim për përqindjen e pjesëmarrjes së të rinjve NEET ku përfshihet kategoria e të rinjve të moshës 15-24 vjeç, që nuk janë as të punësuar, nuk ndjekin trajnim as shkollim është mjaft e lartë dhe ka pasur rritje të vazhdueshme në këto 4 vite. Në vitin 2017 kjo përqindje ishte 27.4%, duke vazhduar me rritje deri sa në vitin 2020 ishte 33.6%.

Punësimi i paqëndrueshëm i referohet personave të vetëpunësuar, që nuk kanë të punësuar ose punëtorëve të papaguar familjar. Kjo kategori e të punësuarve kanë më pak gjasa të kenë marrëveshje formale pune dhe kjo përqindje ka pasur luhatje më të mëdha ndër vite.

Figura 2: Indikatorët kryesor të tregut të punës, 2017-2020 (%)



Burimi: ASK - Anketa e Fuqisë Punëtore, '17, '18, '19, '20

Pagat neto të shumicës së punonjësve ishin midis 400 € deri 500 € në muaj. Janë vërejtur dallime gjinore me 0.1% më e lartë tek meshkujt se sa tek femrat.


1.3 Llogaritë ekonomike në bujqësi

Llogaritë Ekonomike për Bujqësi (LLEB) ofrojnë një pasqyrë të detajuar sa i përket të ardhurave nga aktivitetet bujqësore. Ato paraqesin një gamë të gjerë të indikatorëve lidhur me aktivitetet ekonomike në sektorin bujqësor dhe kanë për qëllim analizimin e procesit të prodhimit të industrisë bujqësore dhe të ardhurave primare të gjeneruara nga ky prodhim. Të dhënat nga LLEB, kanë për qëllim të nxjerrin në pah zhvillimin ekonomik në sektorin kombëtar të bujqësisë dhe mund të përdoret si bazë për vlerësimin e ndryshimeve të politikave bujqësore të sektorit bujqësor. Llogaritë Ekonomike për Bujqësi me çmimet bazë përfshijnë pagesat direkte (subvencionet), të cilat nuk përfshihen në Llogaritë Ekonomike për Bujqësi me çmimet e prodhimit. Të dhënat e LLEB janë hartuar sipas metodologjisë së përcaktuar nga Eurostat: Udhëzuesi i Llogarive Ekonomike për Bujqësi dhe Pylltari EAA/EAF 97 (Rev.1.1) dhe Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 306/2005.

1.3.1 Prodhimet bujqësore

Figura e mëposhtme paraqet vlerën e prodhimeve bimore dhe blegtorale me çmime aktuale për periudhën 2016-2020. Siç shihet në këtë figurë, vlera e prodhimeve bimore dhe blegtorale është rritur vazhdimisht nga viti 2018. Viti 2020 karakterizohet me vlerën më të lartë të prodhimeve bimore dhe blegtorale gjatë periudhës në fjalë. Nëse e krahasojmë me vitin paraprak, rezulton se rritja ishte 8% për prodhime bimore dhe 3% për prodhime blegtorale.


Figura 3: Prodhimet bimore dhe blegtorale në mil. €, 2016-2020



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '16,'17,'18,'19, '20, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Në figurën në vijim është paraqitur pjesëmarrja e kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor për vitin 2020. Krahësuar me vitin 2019, në vitin 2020 bimët foragjere prijnë me përqindjen më të lartë, pasuar nga drithërat, perimet, pemët dhe të tjera.


Figura 4: Pjesëmarrja e kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor, 2020



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2020, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Figura e mëposhtme përmban të dhëna lidhur me shitjen e mishit nga gjedhet, derrat, delet, dhitë, shpezët dhe kafshët tjera si dhe të dhënat për produktet blegtorale siç janë qumështi dhe vezët dhe të tjera me vlerë shumë më të vogël. Krahësuar me vitin 2019, në vitin 2020 është zvogëluar shitja e mishit të gjedheve ndërsa është rritur për dele dhe dhi, derra, dhe shpezë. Sa i përket produkteve blegtorale, krahësuar me vitin paraprak, në vitin 2020 nuk ka pasur ndryshime.


Figura 5: Shitja e mishit sipas kategorisë (majtas) dhe e produkteve blegtorale (djathtas),2020



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2020, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Nëse analizojmë prodhimet bimore për periudhën 2016-2020, vërejmë se ka pasur luhatje të vlerës së tyre gjatë këtyre viteve. Megjithatë, në vitin 2020 shumica e kategorive shënuan rritje përveç perimeve të cilat krahasuar me vitin paraprak, pësuan rënie për 11%. Drithërat shënuan vlerën më të lartë në vitin 2020 gjatë periudhës në fjalë. Krahasuar me vitin 2019, drithërat shënuan rritje të vlerës për 20%, bimët foragjere për 6%, patatet për 13%, pemët për 27%, kurse kategoria prodhimet tjera bimore nuk pati ndryshime.


Figura 6: Prodhimet bimore në mil. €, 2016-2020



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '16,'17,'18,'19,'20, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Sa i përket prodhimeve blegtorale, ashtu si ato bimore, krahasuar me vitin 2019 në vitin 2020 shumica e kategorive shënuan rritje, përveç gjedheve të cilat pësuan rënie për 25%. Delet dhe dhitë shënuan rritje për 17%, shpezët për 41%, derrat për 29%, dhe kafshët tjera për 42%.


Figura 7: Blegtoria në mil. €, 2016-2020



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '16/'17/'18/'19/'20, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Në figurën në vijim është paraqitur vlera e produkteve blegtorale. Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2020, qumështi dhe vezët shënuan njëjtë rritje për 7%.

Figura 8: Produktet blegtorale në mil. €, 2016-2020



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '16/'17/'18/'19/'20, përpunuar nga DAESB - MBPZhR


1.3.2 Të ardhurat sipërmarrëse

Në figurën në vijim janë të paraqitura të dhënat për prodhimet e industrisë bujqësore, konsumin e ndërmjetëm dhe vlerën e shtuar bruto për periudhën 2016-2020. Vlera e prodhimit të industrisë bujqësore në vitin 2020 ishte më e larta gjatë periudhës në fjalë, e në krahasim me vitin paraprak, shënoi rritje për 6%. Sa i përket konsumit të ndërmjetëm, në vitin 2020 shënoi rritje për vetëm 4%.

Vlera e shtuar bruto e cila paraqet ndryshimin në mes të vlerës së prodhimit të industrisë bujqësore dhe vlerës së konsumit të ndërmjetëm, në vitin 2020 kishte vlerën 512 mil. €, ku

krahasuar me vitin paraprak shënoi rritje për 7%. Në vitin 2020, vlera e shtuar bruto ishte e barabartë me 62% të vlerës së prodhimit.

Figura 9: Prodhimi bujqësor, konsumi i ndërmjetëm dhe bruto vlera e shtuar në mil. €, 2016-2020




Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '16,'17,'18,'19,'20, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Figura në vijim përmban të dhëna për vlerën e shtuar bruto, vlerën e shtuar neto si dhe të ardhurat sipërmarrëse. Vlera e shtuar neto paraqet prodhimin e përgjithshëm të industrisë bujqësore minus shpenzimet e konsumit të ndërmjetëm dhe konsumi i kapitalit fiks. Të ardhurat sipërmarrëse paraqesin shumën e vlerës së shtuar neto plus subvencionet në prodhim, minus kompensimi për punëtorët, taksat mbi prodhimin, qiratë dhe interesi i kredive.

Vlera më e lartë e të hyrave në bujqësi ishte në vitin 2020 ku të ardhurat sipërmarrëse ishin 9% më të larta se në vitin paraprak. Vlera e shtuar bruto dhe vlera e shtuar neto shënuan rritje për 7% dhe 9% respektivisht.

Figura 10: Të hyrat e agreguara në bujqësi në mil. €, 2016-2020




Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '16,'17,'18,'19,'20, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.3.3 Inputet në bujqësi

Figura në vijim përmban të dhëna lidhur me strukturën e konsumit të ndërmjetëm bujqësor për vitin 2020. Sipas kësaj figure, kategoria e ushqimit të kafshëve e cila përfshinë materialin ushqyes të cilin fermeri e blen nga fermerët tjerë apo lëndën e parë dhe ushqimin për kafshë që fermeri e prodhon në fermë, kontribuon me 48%, që paraqet pothuajse gati gjysmën e konsumit të ndërmjetëm. Plehrat, përmirësuesit e tokës kanë pjesëmarrje prej 11% në konsumin e ndërmjetëm, shërbimet bujqësore 10%, mallrat dhe shërbimet tjera 9%, shpenzimet e energjisë 8%, farërat dhe materiali mbëltues 5%, shpenzimet veterinare 4%, mirëmbajtja e materialeve 3%, ndërsa produktet për mbrojtjen e bimëve, pesticidet dhe mirëmbajtja e ndërtesave janë me pjesëmarrje më të ulët.


Figura 11: Struktura e konsumit të ndërmjetëm, 2020



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2020, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

Sa i përket inputeve në bujqësi, sipas figurës së mëposhtme, në vitin 2020, konsumi i ndërmjetëm është kategoria kryesore me pjesëmarrje prej 70%, pasuar nga konsumi i kapitalit fiks me 27%, ndërsa kompensimi i punëtorëve, qiratë dhe shpenzimet tjera të patundshmërisë dhe interesi i paguar kanë pjesëmarrje shumë më të ulët.

Figura 12: Inputet në bujqësi sipas kategorive, 2020



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2020, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

1.4 Çmimet e inputeve dhe prodhimeve bujqësore

1.4.1 Çmimet e inputeve bujqësore


Indekset e çmimeve të inputeve bujqësore matin ndryshimet e çmimeve në kostot aktuale të prodhimit brenda ekonomisë. Përkatësisht, një indeks i çmimeve të inputeve matë ndryshimet në koston e shportës së blerjeve që hyjnë si inpute në procesin e prodhimit, por këtu nuk hyjnë inputet primare si toka, puna dhe kapitali.

Tabela e mëposhtme e indeksit vjetor të çmimeve të inputeve bujqësore përfshin të dhëna për indeksin e çmimeve në Kosovë për periudhën 2015-2020. Çmimet e inputeve bujqësore janë mbledhur nga ASK në barnatore bujqësore, barnatore veterinerë, nga kompanitë, tregjet dhe vendet tjera ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. Disa çmime të inputeve bujqësore janë marrë nga çmimet e konsumit nga ASK.

Produktet që përbëjnë bazën e indeksit të çmimeve të inputeve marrin pjesë në njërin nga dy grupet kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (konsumi i ndërmjetëm) si dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (formimi i kapitalit). Nga të gjitha kategoritë e paraqitura në tabelën në vijim, kategoria me më së shumti rritje të çmimit në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 është ajo e lëndëve të përbëra ushqimi brenda kategorisë Lëndë për ushqim kafshësh për 11% dhe lubrifikantët brenda kategorisë “Energjia: Lubrifikantët” për 7%. Rënie më të dukshme të çmimit në vitin 2020 ka pasur tek lëndët djegëse brenda kategorisë “Energjia: Lubrifikantët” për 18% dhe produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet për 3%.

Indeksi vjetor i inputeve në vitin 2020 ka pësuar rënie për 3.2% për Input 1 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, ndërsa indeksi për Input 2 kishte rritje për 1.5%. Indeksi i çmimeve të inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) krahasuar me vitin e 2019, në vitin 2020 ka rënë për 1%.

Figura 13: Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2015-2020, (2015=100)



Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2015-2020, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tabela 3: Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2015-2020, (2015=100)

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 në %
Mallrat dhe shërbimet e konsumuara aktualisht në bujqësi (Input 1)	100	98.1	95.4	94.0	95.8	92.7	-3.2
Farërat dhe materiali mbëltues	100	98.9	87.2	78.1	83.7	84.2	0.5
Energji; lubrifikant	100	93.7	100.9	106.5	106.3	92.0	-13.5
-Energjia elektrike	100	98.8	106.1	97.6	95.7	95.7	0.0
-Lëndë djegëse	100	92.3	100.2	109.9	110.2	90.5	-17.9
-Lubrifikant	100	93.8	92.6	92.6	92.8	99.0	6.7
Plehrat dhe përmirësuesit e tokës	100	97.6	89.5	85.9	88.5	87.3	-1.3
-Plehrat e thjeshtë	100	93.9	87.7	83.5	85.1	84.2	-1.1
-Plehrat e përbëra	100	99.7	90.6	87.3	90.5	89.2	-1.4
Produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet	100	104.2	103.8	105.4	106.3	103.5	-2.7
Shpenzimet veterinare	100	98.7	98.0	97.5	99.3	98.0	-1.3
Lëndë për ushqim kafshësh	100	109.5	103.7	103.2	107.6	110.1	2.4
-Lëndë të thjeshta ushqimi	100	111.5	103.4	103.0	107.9	108.9	0.9
-Lëndë të përbëra ushqimi	100	97.9	104.9	104.7	105.7	117.0	10.8
Mirëmbajtja e materialeve	100	100.1	99.9	99.8	99.5	99.2	-0.3
Mirëmbajtja e ndërtesave	100	98.2	98.8	98.6	99.3	101.5	2.3
Mallrat dhe shërbimet tjera	100	100.0	100.8	100.9	101.4	101.3	-0.1
Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (Input 2)	100	102.5	103.5	102.6	109.9	111.5	1.5
Traktor	100	106.9	107.7	105.2	119.0	120.8	1.6
Tjera	100	98.5	99.8	100.3	101.8	103.3	1.5
Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)	100	100.1	99.0	97.8	102.1	101.1	-0.9

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2015-2020, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tabela në vijim përmban të dhëna lidhur me çmimet vjetore të energjisë elektrike dhe naftës për periudhën 2016-2020. Sa i përket çmimit të energjisë elektrike, nuk ka pasur fare ndryshim nga viti 2019, ndërsa çmimi i naftës ka rënë për 19%.

Tabela 4: Çmimet vjetore për energji elektrike dhe naftë në €, 2016-2020

Energjia dhe Lubrifikantët	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 në %
Energjia elektrike çmimi për 100 kwh	6.1	6.4	5.8	5.6	5.6	0.0
Nafta - çmimi për 100 litra	93.5	102.1	112.7	114.9	92.6	-19.4

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2016-2020

1.4.2 Çmimet e prodhimeve bujqësore

Në vendin tonë prodhimtaria vendore në bujqësi nuk po arrin t'i plotësoj gjitha nevojat për konsum. Nisur nga ky fakt, për plotësimin e nevojave për konsum pjesa më e madhe e prodhimeve po importohen, ani pse çdo vit eksporti po shënon rritje dhe sasia e lartë e importit vazhdon të ndikoj negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

Për të ngritur zhvillimin ekonomik të sektorit MBPZhR, vazhdon të përkrah përmes granteve dhe subvencioneve rritjen e prodhimtarisë dhe të kualitetit si dhe reduktimin e importit, i cilin ndikon direkt në çmimet e prodhimeve vendore.

MBPZhR, për mbledhjen e çmimeve të prodhimeve bujqësore për vite me radhë ka të angazhuar kompaninë OJQ "Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime - SIT".

Në vijim, janë paraqitur çmimet e disa prodhimeve bujqësore dhe është bërë një paraqitje e çmimeve të prodhuesit, çmimeve të konsumit me shumicë dhe pakicë, çmimeve të importit, vlerës për njësi të produkteve të importuara, për periudhën 2017-2020.

Çmimet e fermës të prodhimeve bujqësore

Në vijim, janë paraqitur çmimet vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë. Bazuar në të dhënat nga tabela e mëposhtme, çmimet në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, kanë pasur mjaft luhatje. Ndryshime të dukshme të çmimit në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 kanë pësuar misri, domatja, trangulli, speci, qepa, etj., ndërsa rritje më të madhe kanë shënuar kumbulla, lakra, fasulja, mjalta, etj.

Tabela 5: Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, €/kg

Prodhime	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 (%)
Grurë	0.21	0.23	0.18	0.19	6
Misër	0.13	0.16	0.14	0.08	-43
Domate	0.54	0.62	0.57	0.33	-42
Fasule	2.29	2.27	2.03	2.31	14
Kungull*	0.94	0.90	0.81	0.24	-
Kungull misiri*	0.71	0.84	0.81	0.22	-
Lakër	0.19	0.4	0.19	0.23	21
Patate	0.3	0.33	0.28	0.28	0
Qepë	0.32	0.37	0.46	0.37	-20
Shalqi	0.1	0.23	0.19	0.17	-11
Spec	0.59	0.91	0.76	0.54	-29
Spinaq	0.71	0.94	0.94	0.91	-3
Trangull	0.42	0.46	0.48	0.32	-33
Arrë	2.64	2.72	2.16	2.06	-5
Dardhë	0.8	0.79	0.81	0.72	-11
Dredhëz	1.08	1.03	1.12	1.15	3
Kumbull	0.7	0.73	0.51	0.68	33
Mjedër	2.94	1.67	1.77	1.73	-2
Mollë	0.49	0.4	0.39	0.32	-18
Rrush tryeze	0.74	0.78	0.68	0.65	-4
Mëzet dhe Mëshqerra	1.88	2.14	1.97	2.23	13
Pulë ferme	1.47	1.8	1.68	1.73	3
Qumësht	0.27	0.25	0.21	0.23	10
Vezë**	2.45	2.1	2.07	2.26	9
Mjaltë	7.1	9.2	11.85	13.50	14

Burimi: DAESB - MBPZHR; *Çmimi për kungull dhe kungull misiri në vitin 2020 paraqitet për kg, ndërsa 2017-2019 është paraqitë çmimi për copë; ** njësia 30 copë

Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore

Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore janë prezantuar përmes çmimeve vjetore të tregut me shumicë dhe pakicë për vitet 2017-2020.

Bazuar në çmimet vjetore të tregut me shumicë të cilat janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme për disa prodhime bujqësore vërejmë se gjatë vitit 2020 ka pasur luhatje në çmime krahasuar me vitin 2019, përpos tek qumështi, lakra, mëzet dhe mëshqerrat, spinaqi, domatja.

Tabela 6: Çmimet mesatare vjetore të tregut me shumicë, €/kg

Prodhime	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 (%)
Grurë	0.22	0.24	0.23	0.33	43
Misër	0.15	0.17	0.19	0.22	16
Domate	0.58	0.67	0.66	0.65	-2
Fasule	2.33	2.42	2.35	2.44	4
Kungull*	0.84	0.96	0.95	0.31	-
Kungull misiri*	1.06	0.96	1.15	0.38	-
Lakër	0.25	0.43	0.46	0.39	-15
Patate	0.31	0.35	0.39	0.39	0
Qepë	0.34	0.38	0.53	0.54	2
Shalqi	0.14	0.34	0.23	0.37	61
Spec	0.71	0.97	0.92	0.97	5
Spinaq	0.78	1.02	1.01	0.95	-6
Trangull	0.46	0.49	0.55	0.57	4
Arrë	2.71	2.79	2.33	2.38	2
Dardhë	1.12	0.83	0.96	1.20	25
Dredhëz	1.81	1.64	1.33	1.82	37
Kumbull	0.75	0.78	0.59	0.69	17
Mjedër	3.09	2.09	2.17	2.07	-5
Mollë	0.53	0.44	0.49	0.64	31
Rrush tryeze	0.96	0.89	0.79	0.99	25
Mëzet dhe Mëshqerra	3.2	3.25	3.31	2.93	-11
Pulë ferme	1.76	1.91	1.93	1.91	-1
Qumësht	0.41	0.45	0.43	0.29	-33
Vezë**	2.52	2.26	2.19	2.36	8
Mjaltë	7.52	6.95	6.85	13.97	104

Burimi: DAESB - MBPZhR; *Çmimi për kungull dhe kungull misiri në vitin 2020 paraqitet për kg, ndërsa 2017-2019 është paraqitë çmimi për copë; ** njësia 30 copë

Lidhur me çmimet vjetore të tregut me pakicë vërehet që ka pas zvogëlim tek shumica e prodhimeve bujqësore gjatë vitit 2020, dukshëm ka pas zvogëlim tek misri, lakra, etj., ndërsa mjalti, shalqiri, dredhëza, molla, pasuar nga kultura tjera kanë shënuar rritje.

Tabela 7: Çmimet mesatare vjetore të tregut me pakicë, €/kg

Prodhimi	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 (%)
Grurë	0.26	0.28	0.36	0.38	6
Misër	0.18	0.23	0.38	0.22	-42
Domate	0.71	0.84	0.8	0.77	-4
Fasule	2.56	2.64	2.66	2.60	-2
Kungull*	1.10	1.19	1.16	0.42	-
Kungull misiri*	1.38	1.26	1.22	0.45	-
Lakër	0.32	0.59	0.55	0.47	-15
Patate	0.38	0.43	0.5	0.48	-4
Qepë	0.41	0.47	0.65	0.64	-2
Shalqi	0.19	0.4	0.3	0.45	50
Spec	0.89	1.17	1.06	1.08	2
Spinaq	0.84	1.12	1.18	1.07	-9
Trangull	0.56	0.61	0.67	0.65	-3
Arrë	2.92	2.89	2.61	2.56	-2
Dardhë	1.24	0.94	1.13	1.35	19
Dredhëz	2.02	1.89	1.49	1.97	32
Kumbull	0.9	0.84	0.75	0.79	5
Mjedër	3.48	2.6	2.44	2.26	-7
Mollë	0.63	0.53	0.6	0.74	23
Rrush tryeze	1.1	1.09	0.98	1.09	11
Mëzet dhe Mëshqerra	3.7	3.8	3.75	3.02	-19
Pulë ferme	2.26	2.37	2.33	2.13	-9
Qumësht	0.47	0.49	0.51	0.48	-6
Vezë**	2.58	2.45	2.5	2.61	4
Mjaltë	8.39	7.5	7.4	16.55	124

Burimi: DAESB - MBPZhR; *Çmimi për kungull dhe kungull misiri në vitin 2020 paraqitet për kg, ndërsa 2017-2019 është paraqitë çmimi për copë; ** njësia 30 copë

Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore

Në Kosovë zakonisht jashtë sezonës së prodhimeve vendore bujqësore në tregun tonë hasim në prodhime të importuara tek të cilat edhe çmimet ndryshojnë dukshëm.

Çmimet e shitjes me shumicë, në të shumtën e rasteve janë më të larta se çmimet e prodhimit kurse në rastin e çmimeve të importit, për prodhimet me pjesëmarrje të lartë të importeve, kjo rregull mund të mos vlejë sepse disa produkte kanë kosto të lartë të prodhimit në vend dhe si rrjedhojë çmimet e prodhimit në fermë mund të jenë më të larta sesa ato të importit.

Më poshtë janë të paraqitura çmimet e importit të prodhimeve bujqësore ku çmimet të cilat kanë pësuar rënie në raport me vitin paraprak janë shalqiri, kumbulla, rrushi i tryezës, spinaqi, etj. rritje më të dukshme në çmim kanë shënuar patatja, domatja, qepa, trangulli, etj.

Tabela 8: Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, €/kg

Prodhime	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 (%)
Grurë	0.24	0.31	0.38	0.38	0
Misër	0.18	0.18	0.25	0.22	-12
Domate	0.9	0.91	0.97	1.19	23
Fasule	2.32	2.03	1.97	2.01	2
Kungull*	0.97	1.18	1.12	0.28	-
Kungull misiri*	1.14	1.50	0.90	0.46	-
Lakër	0.33	0.39	0.56	0.64	14
Patate	0.77	0.66	0.55	0.84	53
Qepë	0.36	0.39	0.52	0.61	17
Shalqi	1.03	0.96	1.61	0.85	-47
Spec	1.28	1.18	1.46	1.50	3
Spinaq	1.14	1.15	1.49	1.19	-20
Trangull	1.06	0.94	1.08	1.21	12
Arrë	2.38	2.44	2.4	2.06	-14
Dardhë	1.3	1.28	1.34	1.47	10
Dredhëz	4.33	2.96	2.69	2.94	9
Kumbull	2.92	2.83	3.49	2.34	-33
Mjedër	-	-	1.7	-	-
Mollë	0.68	0.83	0.78	0.82	5
Rrush tryeze	2.66	2.45	2.66	1.97	-26
Mëzet dhe Mëshqerra	2.77	2.9	3.05	2.87	-6
Pulë ferme	1.9	2.6	2.35	2.21	-6
Qumësht	-	-	-	-	-
Vezë**	2.25	2.1	2.35	2.15	-9
Mjaltë	8.85	8.6	7.85	8.6	10

Burimi: DAESB - MBPZhR; *Çmimi për kungull dhe kungull misiri në vitin 2020 paraqitet për kg, ndërsa 2017-2019 është paraqitë çmimi për copë; ** njësia 30 copë

Tabela e mëposhtme paraqet vlerën për njësi të importit të prodhimeve bujqësore. Rritje më të dukshme krahasuar me vitin 2019 ka shënuar mjedra, pasuar nga kungulli dhe kungulli i misirit, patatja, etj., ndërsa shumica e prodhimeve kanë shënuar zvogëlim krahasuar me vitin 2019, si lakra, trangulli, qepa, etj.

Si në vitet paraprake edhe këtë vit vazhdon trendi i njëjtë, prodhimet bujqësore të importuara ishin në dispozicion me çmime më të ulëta se çmimi i prodhimeve vendore në Kosovë, kjo mund të jetë si rezultat i dallimeve në cilësi, afatit të liferimit dhe politikave të shteteve dhe kompanive eksportuese.

Tabela 9: Vlera për njësi e prodhimeve bujqësore të importuara, €/kg

Prodhimi	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 (%)
Grurë	0.17	0.18	0.20	0.19	-5
Misër	0.16	0.16	0.17	0.16	-6
Domate	0.34	0.36	0.38	0.35	-8
Fasule	0.86	0.86	0.88	0.93	6
Kungull dhe Kungull misiri*	0.56	0.47	0.47	0.52	11
Lakër	0.16	0.18	0.26	0.16	-38
Patate	0.26	0.27	0.30	0.33	10
Qepë	0.42	0.38	0.55	0.47	-15
Shalqi	0.13	0.17	0.16	0.15	-6
Spec	0.43	0.46	0.54	0.46	-15
Spinaq	0.42	0.41	0.48	0.50	4
Trangull	0.35	0.35	0.35	0.29	-17
Arrë	1.43	1.85	1.42	1.52	7
Dardhë	0.68	0.68	0.68	0.67	-1
Dredhëz	1.01	0.72	0.68	0.69	1
Kumbull	0.38	0.37	0.33	0.31	-6
Mjedër	0.93	1.49	0.51	2.21	333
Mollë	0.35	0.38	0.35	0.32	-9
Rrush tryeze	0.51	0.49	0.50	0.46	-8
Mëzet dhe Mëshqerra	0.83	1.24	1.33	1.32	-1
Pulë ferme	2.00	2.00	1.99	1.99	0
Qumësht	0.52	0.54	0.57	0.55	-4
Vezë**	-	3.11	-	1.11	-
Mjaltë	5.63	5.20	4.83	4.98	3

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB – MBPZHR; * Në të dhënat doganore, kungull dhe kungull misiri janë të përfshira në një kod doganor; ** njësia 30 copë

Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së

Krahasimin e çmimeve të disa vendeve të Bashkimit Evropian dhe Kosovës, mund ta shohim në tabelën e mëposhtme, ku janë të paraqitura çmimet e prodhimeve bujqësore për disa kultura siç janë gruri, misri, patatja, lakra, molla, vezët dhe mjalti. Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme mund të themi se Kosova ka çmime relativisht të larta në krahasim me vendet e tjera të BE-së, prodhimet ku Kosova dominon me çmime më të larta janë gruri dhe mjalti, prodhimet tjera variojnë prej vendeve ndërsa çmimi i misrit është më i ulëti në raport me vendet tjera kurse lakra, patatja molla dhe vezët janë aftësisht të përputhshme me vendet tjera. Arsyeja e ndryshimit të çmimeve është si rezultat i sasisë së ulët të prodhimit vendor, kostos së lartë të prodhimit dhe pjesëmarrjes së lartë të importit.

Pasi që importi në Kosovë vazhdon të jetë shumë i lartë, ndryshimet e çmimeve në tregun ndërkombëtar dhe në vendet e regjionit kanë ndikim në çmimet e tregut në vendin tonë.

Duke marrë parasysh të ardhurat e ulëta, rritja e çmimeve sidomos të prodhimeve bazike, ndikon negativisht në standardin jetësor të popullatës së Kosovës.

Tabela 10: Çmimet e disa prodhimeve në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2020, €/kg

Shtetet	Grurë	Misër	Patate	Lakër	Mollë	Vezë*	Mjaltë
Bullgaria	0.17	0.15	0.21	0.17	0.29	2.01	3.11
Çekia	0.16	0.15	0.20	0.24	0.55	2.05	-
Greqia	0.20	0.21	0.47	0.36	0.65	5.54	5.95
Hungaria	0.15	0.14	0.23	0.30	0.44	1.70	2.62
Austria	-	0.13	0.17	-	0.81	4.43	9.60
Rumania	0.16	0.17	0.40	0.35	0.66	2.23	3.48
Kosova	0.19	0.08	0.28	0.23	0.32	2.26	13.50

Burimi: Eurostat; DAESB - MBPZhR, * njësia për 30 copë

Si përfundim duke parë çmimet e paraqitura më lartë mund të themi se Kosova, si treg i vogël me prodhim të ulët vendor është shumë e varur nga importi e si rezultat edhe çmimet diktohen nga importi dhe vazhdojnë të mbesin të larta duke pasur parasysh standardin e jetesës. Vendit tonë i duhet që gjatë hartimit të politikave bujqësore të punojë mbështetje dhe promovim të prodhimeve vendore, të cilat mundësojnë rritje të prodhimtarisë vendore, përmirësim të cilësisë, rritje të aftësive konkurruese dhe përmirësim të eksportit.

1.5 FADN - Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit në fermë

Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit në fermë (FADN), është një sistem përmes të cilit mbledhen të dhënat vjetore për rezultatet ekonomike të fermave. Gjatë viteve të fundit, Bashkimi Evropian ka zhvilluar një gamë instrumentesh për vlerësimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë. Një nga instrumentet që i ka ndihmuar BE-së në mbledhjen e informatave në lidhje me të hyrat dhe performancën ekonomike është FADN-ja.

FADN-ja në Kosovë ka filluar me një pilot projekt në vitin 2004 ku ishin të përfshira 50 ferma. Ky rrjet u zgjerua në 159 ferma në vitin 2005, duke vazhduar me rritjen e numrit të fermave në 402 në vitet 2013 dhe 2014. Nga viti 2015, mostra e FADN-së është rritur në 1,250 ferma, e kjo mostër është reprezentative dhe përbën afër 2% të fermave të fushës së observimit.



Të dhënat të cilat grumbullohen përmes këtij instrumenti përfshijnë, por nuk janë të limituara në: vlerë të prodhimit të të korrurave, shitje dhe blerje, kosto të prodhimit, pasuri, detyrime, subvencione dhe grante. Këto të dhëna i mundësojnë MBPZhR-së që të hartojë rekomandime që kontribuojnë në krijimin e politikave të favorshme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Koncepti i FADN-së fillimisht është përdorur në vitin 1965. Në atë vit, Rregullorja e Këshillit 79/65 ka hyrë në fuqi për të krijuar bazën ligjore për themelimin e rrjetit të kontabilitetit në bujqësi. Që nga ajo kohë, legjislacioni është adaptuar konstant në mënyrë që të adresoj zhvillimet e reja në vende anëtare të BE-së. Ndonëse ka një metodologji universale të FADN-së, secili vend e modifikon atë duke marrë parasysh specifikat e vendit të tyre. Thënë këtë, njësitë bujqësore që bëhen pjesë e rrjetit, selektohen në bazë të një plani të mostrimit që përcaktohet nga natyra e sektorit të bujqësisë.

Fermat e FADN-së në Kosovë janë të klasifikuara sipas madhësisë ekonomike dhe llojit të fermës, në përputhje me rregulloren e BE-së. Tabela në vijim paraqet tipin apo llojin e fermës si dhe madhësitë ekonomike sipas të cilave klasifikohen fermat në FADN. Gjithsej janë 8 lloje të fermave dhe 7 madhësi ekonomike.

Tabela 11: Lloji dhe madhësia e fermës

Nr.	Lloji i fermës	Nr.	Madhësia e fermës (SO ¹ në €)
1	Të specializuara në kultura lavërtare	1	2,000 - < 4,000
2	Të specializuara në hortikulturë (serra)	2	4,000 - < 8,000
3	Të specializuara në kultura shumëvjeçare	3	8,000 - < 25,000
4	Të specializuara në bagëti që kullosin	4	25,000 - < 50,000
5	Të specializuara me granivore ²	5	50,000 - < 100,000
6	Kultura të përziera	6	100,000 - < 500,000
7	Ferma të përziera blegtorale	7	≥ 500,000
8	Ferma të përziera me kultura dhe bagëti		

Burimi: FADN, DAESB - MBPZhR

1.5.1 Rezultatet Standarde të FADN-së në Kosovë

Në tabelën në vijim paraqiten të dhënat lidhur me strukturën, prodhimin, kostot dhe të ardhurat e fermës sipas madhësisë ekonomike si dhe mesatarja e peshuar për gjithsej madhësitë në nivel vendi për vitin 2019. Nga kjo tabelë, mund të vërejmë se sa më e madhe madhësia ekonomike, aq më e madhe është edhe sipërfaqja e tokës, njësitë blegtorale, gjithsej outputi, gjithsej inputet, të ardhurat në fermë, etj.

¹ SO: Standardi output është gjithsej vlera e prodhimeve të fermës brenda një viti kontabël, e cila llogaritet në bazë të sipërfaqes dhe numrit të krerëve blegtoral duke i shumëzuar me koeficientët e parallogaritur.

² Granivore: Sipas Rregullores së KE-së, Nr. 1242/2008 (8 Dhjetor 2008), lidhur me përcaktimin e tipologjisë së fermave, fermat e specializuara në granivore janë fermat të cilat janë të specializuara në derrari, shpezëtari dhe të tjera të kombinuara.

Sa i përket sipërfaqes së shfrytëzuar bujqësore, mesatarja e peshuar për vitin 2019 ishte 3.5 ha kurse njësitë blegtorale si mesatare në nivel vendi për fermë ishin 3 njb (njësia blegtorale është një njësi standarde e matjes, që mundëson agregimin e kategorive të ndryshme të kafshëve, përmes përdorimit të koeficientëve specifik bazuar në rregullore të BE-së).

Nëse analizojmë të ardhurat në fermë për vitin 2019, vërejmë se gjithsej vlera e outputit (prodhimit) si mesatare për fermë ishte 9,712 €, të ardhurat neto në fermë 2,438 € dhe vlera e shtuar neto e fermës për njësi vjetore të punës ishte 1,608 €. Sa i përket kostove, në vitin 2019 inputet kishin vlerën 7,633 €, konsumi i ndërmjetëm 5,810 €, dhe zhvlerësimi 1,270. Raporti midis outputit dhe inputit ishte 1.27.

Tabela 12: Rezultatet standarde si mesatare për fermë, 2019

Variabla	Njësia	Madhësia Ekonomike ('000)						Gjithsej
		2 - <4	4 - <8	8 - <25	25 - <50	50 - <100	≥100	
Struktura e mostrës	%	11	19	34	17	12	7	100
Njësiti blegtorale (SE080)	njb	1.21	2.06	4.45	9.95	7.79	77.16	2.98
Sipërfaqja e shfrytëzuar bujqësore (SE025)	ha	1.73	3.02	5.41	9.49	11.02	28.46	3.52
Outputi (SE131)	€	3,809	6,930	14,565	27,183	63,555	123,912	9,712
Outputi i prodhimeve bimore (SE135)	€	1,068	2,059	4,905	10,431	22,457	37,391	3,156
Outputi i prodhimeve shtazore (SE206)	€	2,240	4,135	7,822	14,068	11,793	78,471	5,001
Outputet tjera (SE256)	€	501	737	1,838	2,684	29,306	8,050	1,555
Inputet (SE270)	€	3,542	5,970	10,977	21,728	34,422	98,104	7,633
Konsumi i ndërmjetëm (SE275)	€	2,486	4,483	8,628	16,329	27,695	81,851	5,810
Shpenzimet specifike totale (SE281)	€	2,001	3,759	7,469	13,684	24,208	71,746	4,918
Zhvlerësimi (SE360)	€	904	1,226	1,450	3,239	2,735	4,956	1,270
Të ardhurat bruto të fermës (SE410)	€	1,364	2,595	6,515	12,316	38,169	47,887	4,219
Vlera e shtuar neto e fermës (SE415)	€	459	1,369	5,064	9,077	35,434	42,931	2,949
Të ardhurat neto në fermë (SE420)	€	307	1,109	4,257	7,087	32,136	32,005	2,438
Vlera e shtuar neto e fermës/NJVP (SE425)	€/njvp*	318	771	2,233	3,240	9,777	8,071	1,608
Asetet (SE436)	€	121,125	171,599	233,287	243,619	473,471	540,571	173,583
Detyrimet (SE485)	€	199	105	450	2,402	2,784	4,086	389
Ekuiteti (SE501)	€	120,926	171,494	232,837	241,217	470,687	536,485	173,194


Burimi: FADN, DAESB - MBPZhR

* njvp=Njësia Vjetore e Punës është e barabartë me 1,800 orë pune në vit të një punonjësi me orar të plotë

**Mesatarja e peshuar në bazë të numrit të fermave në secilën madhësi ekonomike

Figura e mëposhtme paraqet vlerën e shtuar neto të fermës për njësi vjetore të punës si mesatare për fermë sipas llojit të fermës, për vitin 2019. Sipas kësaj figure, vërejmë se hortikultura dhe fermat që merren me bagëti që kullosin kanë vlerën e shtuar për njvp më të lartën. Pas tyre renditen fermat me granivore, kulturat shumëvjeçare, etj.


Figura 14: Vlera e shtuar neto e fermës për njësi vjetore të punës si mesatare për fermë , 2019



Burimi: FADN, DAESB - MBPZhR

Në figurën e mëposhtme shfaqen të dhënat lidhur me gjithsej outputin varësisht prej llojit të fermës. Fermat e specializuara në bagëtitë që kullosin prijnë me outputin më të lartë, pasuar nga hortikultura, granivoret, të përziera blegtorale, etj.


Figura 15: Gjithsej outputi sipas llojit të fermës në € si mesatare për fermë, 2019



Burimi: FADN, DAESB - MBPZhR

Në vijim paraqiten të dhënat lidhur me produktivitetin e fermave sipas llojit të tyre. Sipas kësaj figure rezulton se fermat e specializuara në hortikulturë janë më efikente kur outputi është më i lartë se inputi, pasuar nga bagëtitë që kullosin, kulturat shumëvjeçare, të përziera blegtorale, etj.


Figura 16: Raporti i gjithsej outputit/inputs sipas llojit të fermës, 2019



Burimi: FADN, DAESB - MBPZhR

Figura e mëposhtme paraqet të dhënat lidhur me fuqinë punëtore të paguar dhe papaguar sipas llojit të fermës për vitin 2019. Fermat e specializuara në hortikulturë, kultura shumëvjeçare dhe kultura të përziera kanë përqindje më të lartë të fuqisë punëtore të paguar, pasuar me granivore dhe të tjera.

Figura 17: Fuqia punëtore e paguar dhe e papaguar sipas llojit të fermës, 2019



Burimi: FADN, DAESB - MBPZhR

Tabela në vijim përmban të dhëna lidhur me strukturën e fermës sipas llojit. SBSH-në më të lartë e kanë fermat e specializuara në kultura lavërtare, pastaj bagëtitë që kullosin dhe fermat e përziera me kultura dhe bagëti, etj. Sa i përket njësive vjetore të punës për fermë, fermat e specializuara në hortikulturë kanë njësi vjetore të punës më të lartë, pasuar me bagëtitë që kullosin dhe të tjerat me radhë. Njësi blegtorale për fermë më së shumti kanë fermat e specializuara në granivore, pastaj bagëtitë që kullosin, etj.

Tabela 13: Lloji dhe struktura e fermës, 2019

Lloji i fermës	Struktura e mostrës	Sipërfaqja e shfrytëzuar bujqësore (SE025)	Njësiti vjetore të punës për fermë (SE010)	Njësiti blegtorale për fermë (SE080)
Kultura lavërtare	28%	4.2	1.66	0.75
Hortikulturë (serra)	2%	1.7	2.81	0.37
Kultura shumëvjeçare	7%	2.5	1.66	0.36
Bagëtitë që kullosin	21%	4.0	2.05	5.82
Granivore	4%	1.1	1.38	13.23
Kulturat e përziera	6%	2.8	1.77	0.93
Të përziera blegtorale	6%	3.2	2.03	4.23
Të përziera me kultura dhe bagëti	27%	3.5	1.84	2.66

Burimi: FADN, DAESB - MBPZhR

Nëse i analizojmë të dhënat sipas regjioneve, në tabelën e mëposhtme vërejmë se regjioni i Mitrovicës në përgjithësi ka të ardhurat më të larta, ndërsa në mesin e regjioneve dallohen edhe Gjakova, Peja, Prizreni dhe Gjilani me të ardhura më të larta. Sa i përket vlerës së shtuar neto të fermës për njvp, më e larta është në regjionin e Mitrovicës, pasuar me Ferizajin, Prizrenin, etj.

Tabela 14: Rezultatet standarde sipas regjioneve në €, 2019

Regjioni	Outputi total SE131	Të ardhurat bruto të fermës (SE410)	Vlera e shtuar neto e fermës (SE415)	Të ardhurat neto të fermës (SE420)	Vlera e shtuar neto e fermës/NJVP (SE425)
Ferizaj	8,760	4,002	2,897	2,491	1,882
Gjakovë	10,621	3,846	2,684	2,153	997
Gjilan	8,847	4,063	2,954	2,549	1,249
Mitrovicë	13,091	7,605	6,397	5,815	1,754
Pejë	9,997	4,194	2,378	1,700	746
Prishtinë	8,450	3,388	2,186	1,655	1,384
Prizren	9,051	3,745	2,708	2,463	1,669
Kosovë	9,712	4,219	2,949	2,438	1,608

Burimi: FADN, DAESB - MBPZhR

1.5.2 Krahassimi me vendet e BE-së

Në Bashkimin Evropian, FADN aktualisht është duke mbledhur të dhëna nga më shumë se 80 mijë ferma që përfaqësojnë rreth 5 milion biznese në 28 shtete anëtare. Mostra e FADN-së përfaqëson rreth 90% të sipërfaqes së shfrytëzuar bujqësore dhe të prodhimit bujqësor në këto vende.

Tabelat e mëposhtme shërbejnë si tabela krahasuese mes të dhënave të FADN-së në Kosovë dhe vendeve të BE-së. Për shkak të numrit shumë të madh të fermave të vogla, Kosova ka

pragun minimal në vlerë prej 2,000 €, ashtu sikurse Rumania si dhe disa vende të tjera të rajonit që karakterizohen me numër të madh të fermave të vogla.

Tabela 15: Pragu minimal i madhësisë ekonomike dhe numri i fermave

Shtetet	Pragu minimal i madhësisë ekonomike (SO)	Numri i fermave në mostër
Austria	15,000	1,800
Italia	8,000	11,106
Bullgaria	4,000	2,202
Kroacia	4,000	1,251
Estonia	4,000	658
Polonia	4,000	12,100
Sllovenia	4,000	908
Hungaria	4,000	1,900
Rumania	2,000	6,000
Kosova	2,000	1,250

Burimi: FADN – Komisioni Evropian; FADN, DAESB - MBPZhR

Tabela në vijim paraqet të dhëna lidhur me strukturën e fermës dhe të ardhurat në fermë. Nëse e krahasojmë Kosovën me disa nga vendet e BE-së, Kosova ka sipërfaqe bujqësore të shfrytëzuar shumë më të vogël se vendet e BE-së e po ashtu edhe numri i njësive blegtorale, outputi dhe vlera e shtuar neto për njësi vjetore të punës janë shumë më të ulëta se vendet tjera në BE. Nëse ishin marrë parasysh të dhënat e vendeve të rajonit, ato janë më të përafërta me Kosovën, mirëpo për shkak të mungesës së të dhënave të publikuara për ato shtete, në tabelë janë paraqitur vetëm të dhënat për shtetet e BE-së.

Tabela 16: Rezultatet standarde në Kosovë dhe disa vende të Bashkimit Evropian

Shtetet	Gjithsej fuqia punëtore (SE010)	SBSH e përgjithshme (SE025)	Numri i njësive blegtorale (SE080)	Gjithsej outputi (SE131)	Raporti output/input (SE132)	Vlera e shtuar neto e fermës/njvp (SE425)
Estonia	1.83	139.82	36.96	145,931	0.92	25,602
Austria	1.48	33.29	30.08	101,584	1.11	28,317
Hungaria	1.43	44.38	18.12	77,490	1.09	24,540
Italia	1.33	21.32	18.11	70,879	1.48	31,276
Bullgaria	2.9	69.13	20.51	74,059	0.96	14,453
Polonia	1.53	19.64	11.93	33,813	1.17	8,809
Sllovenia	1.24	10.68	10.94	30,727	1.02	6,405
Kroacia	1.59	15.92	8.31	27,759	1.2	9,188
Rumania	1.37	17.67	7.78	21,710	1.27	8,368
Kosova	1.83	3.52	2.98	9,712	1.27	1,608

Burimi: FADN – Komisioni Evropian; FADN, DAESB - MBPZhR

1.6 Privatizimi i tokave bujqësore

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik dhe ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-034 mbi AKP-në. AKP bënë privatizimin e pronës shoqërore në territorin e Kosovës dhe ky mandat rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës. Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe aseteve të tyre, zhvillohet sipas Ligjit të AKP-së në gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe ka të shtrirë autoritetin e vet në gjithë vendin përmes pesë zyrave të saja regjionale (Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë dhe Mitrovicë), si dhe dy zyrave satelitore të hapura dhe funksionale në vendbanime me shumicë serbe në Shtërpçë e Leposaviq.

Bazuar në objektivat e planit të punës për vitin 2020, AKP ka vazhduar me procesin e privatizimit të tokave dhe pronave shoqërore.

Krahasuar me vitin 2019 në vitin 2020, kishte rritje të shitjeve për 10%. Rritje më të madhe të shitjeve ka pasur në regjionin e Prishtinës për 13%, Pejës 7%, Prizrenit 8%, Gjilanit 8%, dhe Mitrovicës 2%.


Sipërfaqja e shitur e tokave bujqësore në vitin 2020 ishte 30,809 ha. Sipërfaqja më e madhe e tokave të shitura ishte në regjionin e Pejës (11,683 ha), me pjesëmarrje në tokat e përgjithshme të privatizuara prej 38%, Prizreni (6,670 ha) 22%, Mitrovica (6,346 ha) apo 21%, Gjilani (3,263 ha) 11% dhe Prishtina (2,848 ha) që kishte pjesëmarrje prej 9%.

Tabela 17: Shitjet e tokave bujqësore në Kosovë, sipas regjioneve, 2005-2020

Regjioni	Sipërfaqja në Ari	Sipërfaqja në ha	Sipërfaqet e shitura (%)	Çmimi mesatar i shitjes €/Ari	Çmimi mesatar i shitjes €/ha	Vlera totale e shitjeve €/ha	Vlera e shitjes (%)
Prishtinë	284,752	2,848	9	248	24,806	70,636,296	45
Pejë	1,168,260	11,683	38	25	2,494	29,137,616	18
Prizren	666,969	6,670	22	47	4,691	31,285,148	20
Gjilan	326,271	3,263	11	55	5,515	17,994,522	11
Mitrovicë	634,627	6,346	21	15	1,506	9,556,656	6
Gjithsej	3,080,879	30,810	100	52	5,148	158,610,238	100

Burimi: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)


Figura 18: Sipërfaqja e shitur e tokave bujqësore dhe vlera totale e shitjeve, 2005-2020



Burimi: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Në vitin 2005 janë privatizuar 1,436 ha të tokës bujqësore apo 4.8% të gjithsej tokave bujqësore privatizuar. Në vitin 2006 dhe 2007 numri i hektarëve të tokës së privatizuar ishte 5,372 ha dhe 5,440 ha, respektivisht, me pjesëmarrje prej 18% secila. Një shitje më e madhe e tokave bujqësore është realizuar në vitin 2009, ku u privatizuan 6,790 ha, me një pjesëmarrje më të madhe krahasuar me vitet tjera. Nga viti 2010, kur shitja e tokave bujqësore nga AKP-ja, ishte 2,318 ha, vitet ne vijim ka pasur më pak shitje të tokave bujqësorë. Në vitin 2020 u privatizuan 592 ha apo 2% nga totali i tokave bujqësore të shitura nga AKP.


Figura 19: Shitja e tokave bujqësore në ha, 2005-2020



Burimi: Departamenti i Koordinimit Rajonal - AKP

Vlera totale e shitjeve për gjithsejtë sipërfaqet e privatizuara bujqësore që nga viti 2005-2020 ishte 158.6 mil. €. Çmimi mesatar i shitjes në vitin 2020, për një hektar të tokës bujqësore në pesë regionet e Kosovës ishte si në vijim: në regionin e Prishtinës (24,806 €/ha), pasuar nga regionin i Gjilanit (5,515 €), ai i Prizrenit (4,691 €), Pejës (2,494 €) dhe Mitrovicës (1,506 €). Në përgjithësi, në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 ka pasur rritje të çmimit për hektar të tokës bujqësore të shitur nga AKP.

Figura 20: Çmimi mesatar i shitjes sipas regjioneve, €/ha



Burimi: Departamenti i Koordinimit Rajonal – AKP

Në tabelën në vijim janë paraqitur komunat që kanë pasur shitje të pronave bujqësore nga AKP, numri i ha të shitur, gjithsej çmimi i shitjes dhe çmimi për ha në komunë.

Tabela 18: Shitja e tokave bujqësore në Kosovë, 2005-2020


Komuna	Numri i shitjeve	Nr. i hektarë të shitur	Gjithsej çmimi i shitjes	Çmimi për hektar
Deçan	17	731	2,019,523	2,763
Glllogoc	14	1,140	6,039,488	5,298
Ferizaj	52	1,238	8,429,503	6,809
Fushë Kosovë	19	566	4,431,496	7,831
Gjakovë	42	2,349	8,523,566	3,629
Gjilan	29	613	3,979,606	6,493
Graçanicë	64	299	17,299,734	57,923
Istog	58	1,944	6,243,055	3,211
Junik	3	360	1,494,545	4,152
Kaçanik	24	513	2,146,816	4,181
Kamenicë	11	258	540,953	2,100
Klinë	52	4,538	6,918,356	1,524
Klllokot	2	25	635,555	25,361
Lipjan	22	682	5,183,300	7,602
Malishevë	8	1,590	2,101,913	1,322
Mamushë	2	47	896,111	19,038
Mitrovica e Jugut	17	2,836	1,230,283	434
Novobërdë	1	3	505,555	202,222
Obiliq	22	477	3,334,518	6,989
Pejë	29	1,761	3,936,072	2,236
Podujevë	25	284	1,267,282	4,469
Prishtinë	86	393	38,145,247	97,002
Prizren	83	886	14,136,966	15,951
Rahovec	46	2,338	6,076,354	2,599
Shtërpçë	15	94	695,660	7,393
Shtime	7	444	1,797,199	4,045
Skenderaj	30	1,935	1,575,316	814
Suharekë	33	1,384	6,424,098	4,642
Viti	28	647	1,890,601	2,921
Vushtrri	23	436	711,569	1,633
Gjithsej	864	30,810	158,610,238	

Burimi: Departamenti i Koordinimit Rajonal – AKP

Sa i përket çmimit të tokave bujqësore ka pasur ndryshime të shumta, ku një ndër faktorët kryesor përcaktues ka qenë boniteti i tokës bujqësore, pozita, burimet ujore afër saj dhe infrastruktura rrugore.


Komunat ku ka pasur më shumë tokë bujqësore të privatizuar ishin: Klina (4,538 ha) Mitrovica e Jugut (2,836 ha), Gjakova 2,349 si dhe Rahoveci me nga 2,338 ha tokë bujqësore të privatizuar. Ndërsa, sipërfaqe më e vogël e tokës bujqësore e privatizuar ishte në komunën e Novobërdës 3 ha, Klllokotit ku janë privatizuar 25 ha, Mamushës 47 ha dhe Shtërpçë 75 ha.

Figura 21: Numri më i madh i ha të shitur të tokës bujqësore sipas komunave, ha



Burimi: Departamenti i Koordinimit Rajonal – AKP

Figura 22: Çmimi më i lartë i shitjes sipas komunave, në €



Burimi: Departamenti i Koordinimit Rajonal – AKP

1.7 Bizneset bujqësore – Agroindustria

Zhvillimi i agroindustrisë zë një vend të veçantë në politikat zhvillimore të vendit tonë, duke e konsideruar si një sektor që siguron ushqim të sigurt në aspektin sasior dhe po ashtu në anën e sigurisë ushqimore e gjithashtu duke bërë të mundur edhe lidhjen e drejtpërdrejtë të fermerit me industrinë e përpunimit. Me zgjerimin e këtij sektori krijohen vende të reja pune, nga ku varen drejtpërdrejtë ose në mënyrë indirekte numër i madh i të punësuarve.

Të dhënat për ndërmarrjet e regjistruara janë marrë nga Regjistri Statistikor i Bizneseve që është pjesë e ASK-së i cili përmban informacionet themelore për të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitetin ekonomik në territorin e Republikës së Kosovës dhe si i tillë shërben për statistika dhe analiza të demografisë së bizneseve, përgatitjen e mostrave dhe ngritjen e rezultateve në nivel vendi për të gjitha anketat që realizohen me bizneset. RSB po ashtu shërben si burim i rëndësishëm i informacioneve për llogaritjen e Bruto Produktit Vendor.

Ndërmarrjet e regjistruara në bujqësi, pylltari dhe peshkatari shkallë të pjesëmarrjes më të madhe në gjithsej ndërmarrjet e regjistruara sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike kishin në vitin 2016 në pjesëmarrje prej 10.4%, ndërsa pjesëmarrje shumë të vogël krahasuar me vitet tjera, ka pasur në vitin 2019 me vetëm 1.21% ndërsa, në vitin 2020 kjo pjesëmarrje ishte 4%.


Tabela 19: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2016-2020

Viti	Ndërmarrjet e regjistruara në bujqësi, pylltari dhe peshkatari	Gjithsej ndërmarrjet e regjistruara sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike	Pjesëmarrja (%)
2016	1,090	10,424	10.4
2017	822	9,223	8.9
2018	626	9,805	6.4
2019	121	10,004	1.2
2020	397	9,805	4.0

Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Sa i përket numrit të ndërmarrjeve që kanë si aktivitet bujqësinë, rritje më e hovshme ishte në vitin 2016 ku ishin të regjistruara 1,090 ndërmarrje derisa, numër shumë i vogël i krahasuar me vitet tjera paraqitet në vitin 2019 me vetëm 121 ndërmarrje të regjistruara brenda vitit. Në vitin 2020 numri i ndërmarrjeve ishte 397, që paraqet rritje prej 30% apo 276 ndërmarrje më shumë krahasuar me vitin 2019.


Figura 23: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2016-2020



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në seksionin e aktiviteteve ekonomike të bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë në vitin 2020, ishin të regjistruara 397 ndërmarrje, ndërsa gjithsej ndërmarrje të regjistruara sipas seksioneve dhe aktiviteteve tjera ishin 9,805. Aktivitetet e regjistruara nga bujqësia kishin pjesëmarrje 4% në totalin e përgjithshëm të aktiviteteve tjera ekonomike të regjistruara gjatë këtij viti, ndërsa 96% ishin aktivitetet tjera ekonomike.

Figura 24: Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari (%), ndaj aktiviteteve tjera ekonomike, në vitin 2020



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tabela në vijim paraqet të dhënat për ndërmarrjet e regjistruara të agrobizneseve për periudhën 2016-2020, mbi qarkullimin monetar vjetor, numrin e të punësuarve si dhe numrin e bizneseve aktive


Tabela 20: Ndërmarrjet e regjistruara të agrobizneseve, 2016-2020

Viti	Qarkullimi ('000 €)	Numri i të Punësuarve	Numri bizneseve Aktive
2016	360,536	10,024	2,314
2017	432,301	10,449	2,398
2018	461,626	13,156	2,942
2019	499,821	12,467	2,405
2020	562,980	14,996	2,780

Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Qarkullimi në vitin 2016 ishte 360.5 mil. €, duke vazhduar me rritje nga viti në vit, kështu që në vitin 2020 qarkullimi në këtë sektor ishte 563 mil. €, që në krahasim me vitin 2019 kishte rritje për 12.6%.


Figura 25: Qarkullimi monetar i ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari, 2016-2020, ('000 €)



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Numri i të punësuarve në biznese bujqësore në periudhën 2016 - 2019 ka shënuar rritje të vazhdueshme. Në vitin 2020, numri i të punësuarve në agrobiznese ishte gjithsej 14,996 apo 20.3% krahasuar me vitin 2019, ku gjithsej numri i të punësuarve ishte 12,467.


Figura 26: Numri i të punësuarve në agrobiznese, 2016-2020



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Numri i bizneseve aktive që merren me aktivitete bujqësore ose që kanë si lëndë të parë produktet bujqësore dhe ato pyjore kanë pasur rënie dhe ngritje të lehtë ndër vite, por që ka qenë numër i përafërt i të punësuarve. Numër më i madh i bizneseve aktive ishte në vitin 2018 ku paraqiten aktive 2,942 biznese, ndërsa numër më i vogël ishte në vitin 2016 (2,314) biznese. Në vitin 2020 numri i bizneseve ka shënuar rritje për 16% krahasuar me vitin 2019.

Figura 27: Numri i bizneseve aktive, 2016-2020



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në kuadër të aktiviteteve të bizneseve bujqësore në vitin 2020, qarkullim më të madh ka pasur në përpunimin e produkteve ushqimore me vlerë prej 306.0 mil. €, vijuar nga degët tjera të agro-industrisë që janë të prezantuara në tabelë, siç janë prodhimi i pijeve që ka pasur qarkullim prej 106.2 mil. €, pasuar nga prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to, që kishin qarkullim prej 60.1mil. €. Me vlerë të përafërt të qarkullimit ishte edhe industria e drurit dhe produkteve të drurit me qarkullim vjetor prej 43.1 mil. €.


Tabela 21: Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari, 2020

Aktivitetet	Qarkullimi ('000 €)	Numri i të Punësuarve	Numri i bizneseve aktive
Prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to	60,129	1,971	736
Pylltaria dhe prerja e drunjve	7,362	115	36
Peshkimi dhe Akuakultura	680	56	15
Përpunimi i produkteve ushqimore	305,958	8,004	1,316
Prodhimi i pijeve	106,230	2,120	80
Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës	5,642	415	42
Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie	43,161	1,719	455
Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	33,817	596	100
Gjithsej	562,980	14,996	2,780

Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Qarkullim më i vogël u karakterizua tek prodhimi i letrës dhe produkteve të letrës me 33.8 mil. €, prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës me 5.6 mil. €, ndërsa pylltaria dhe prerja e drunjve me 7.4 mil. €. Qarkullim shumë më i vogël, vërehet tek aktiviteti ekonomik i peshkimit dhe akuakulturës që ishte 680 mijë €.


Figura 28: Qarkullimi ('000 €), sipas aktiviteteve bujqësore, 2020



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Numri i të punësuarve në aktivitetet bujqësore në vitin 2020 ishte 14,996. Nga ky numër në sektorin e përpunimit të produkteve ushqimore ishin të angazhuar 8,004 punëtor, pastaj radhitet sektori i prodhimit të pijeve 2,120 punëtor, vijuar nga prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet të lidhura me to me 1,971 punëtor, si dhe prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit me 1,719 të punësuar. Aktivitete tjera shfaqen me numër më të vogël të punësuarve.


Figura 29: Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve bujqësore, 2020



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Numri i bizneseve aktive në vitin 2020 ishte 2,780, nga gjithsej këto biznese në numër më të madh paraqiten biznese që merren me përpunimin e produkteve ushqimore 1,316 sosh, prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to 736 si dhe prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit 455 biznese aktive. Numër më i vogël i bizneseve aktive ishte edhe në aktivitete tjera të paraqitura në figurën në vijim.

Figura 30: Numri i bizneseve aktive në vitin, 2020




Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Qarkullimi më i madh nga industria agro-ushqimore në vitin 2020 ishte në regjionin e Prishtinës me pjesëmarrje prej 25%, Prizrenit 24%, Pejës 16% si dhe pjesëmarrja nga regjionet tjera.

Numër më i madh i të punësuarve në këtë sektor del të jetë në regjionin e Prishtinës 25%, Prizrenit 24%, Gjakovës 10%, ndërsa regjioni i Ferizajit, Gjilanit dhe Mitrovicës kanë pjesëmarrje në punësim në këtë sektor me 9%.

Numri i bizneseve aktive në vitin 2020 më i larti ishte në regjionin e Prishtinës 24%, Prizrenit 20% dhe Gjakovës 13% si dhe pjesëmarrja e regjioneve tjera që kishin pjesëmarrje më të vogël.

Figura 31: Qarkullimi, numri i te punësuarve dhe numri i bizneseve aktive në sektorin e bujqësisë sipas regjioneve (%), 2020



Burimi: ASK-Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

2 Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij

2.1 Përdorimi i tokës bujqësore

Ekzistojnë dy kategori kryesore të përdorimit të tokës bujqësore: tokë e punueshme (e cila është tokë e dedikuar për rritjen e kulturave bujqësore) dhe kullotat që përfshin livadhet dhe kullotat e përdorura për kullotjen e bagëtive. Në përgjithësi toka bujqësore, si dhe kullotat kanë ndryshuar gradualisht, fermat janë fragmentuar dhe madhësia mesatare e fermës është ulur për shkak të rritjes së shpejtë të popullsisë rurale. Faktorët tjerë që po ndikojnë në këto ndryshime janë ndryshimet në dendësinë e popullsisë, industrializimi, urbanizimi etj.

Të dhënat për përdorimin e tokës bujqësore merren nga Anketa e Ekonomive Bujqësore, dhe bazuar në të dhënat e kësaj ankete gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ka pasur një trend të përafërt të shfrytëzimit për këtë periudhë kohore. Në vitin 2020 gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420,210 ha, që ishte ngjashëm me sipërfaqen e vitit 2019.

Tabela 22: Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive

	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi '20/'19 në %	Pjesëmarrja në % 2020
Tokë e punueshme – ara	187,223	186,954	188,359	188,365	188,372	0.0	44.8
-Nga e cila me perime në fushë të hapur (kulturë e parë)	7,864	8,033	7,818	8,319	8,435	1.4	-
-Nga e cila me perime në serra (kulturë e parë)	457	467	468	518	547	5.5	-
Kopsht	994	1,199	1,003	1,122	1,133	1.0	0.3
Plantacione të pemëve	5,493	6,247	7,687	9,244	10,029	8.5	2.4
Plantacione të vreshtave	3,112	3,199	3,272	3,367	3,437	2.1	0.8
Fidanishte	196	159	109	111	137	23.1	0.0
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	218,808	218,314	218,152	217,932	217,102	-0.4	51.7
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	415,826	416,072	418,582	420,141	420,210	0.0	100


Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('16/'17/'18/'19/'20)

*Statistikat e prezantuara në këtë tabelë paraqiten në bazë të grupimit si në AEB të ASK-së dhe ka ndryshime me të dhënat e prezantuara në nënkapitujt 2.3.2 dhe 2.3.3 për arsye të ndryshimit në grupim (p.sh dredhëza tek nënkapitulli 2.1 sipas grupimit të ASK-së është e kategorizuar në perime ndërsa tek nënkapitulli 2.3.3 është e paraqitur tek pemët).

Sipërfaqe më të madhe të tokës së shfrytëzuar zënë livadhet dhe kullosat (përfshirë tokën e përbashkët) që përbën 51.7% të gjithsej sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore dhe vërehet se nuk ka pasur ndryshime të theksuara. Në vitin 2020 kjo sipërfaqe ishte 217,102 ha, që paraqet një rënie në krahasim me vitin 2019 për 0.4%.

Pas livadheve dhe kullosave sipërfaqe më të madhe ashtu si edhe në vitet tjera edhe në vitin 2020 ka kategoria e tokës së punueshme–ara, me pjesëmarrje prej 44.8%, që paraqet sipërfaqen prej 188,372 ha, ku përfshihet edhe sipërfaqja e perimeve në fushë të hapur (kulturë e parë) dhe e serrave (kulturë e parë).

Figura 32: Tokë e punueshme-ara (duke përfshirë perimet) dhe Livadhe e kullosa




Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('16,'17,'18,'19,'20)

Në kuadër të sipërfaqes së tokës së punueshme-arave hyjnë edhe perimet në fushë të hapur si kulturë e parë (8,435 ha) dhe perimet në serra po ashtu si kulturë e parë (547 ha). Në vitin 2020 sipërfaqja e perimeve ka shënuar rritje në krahasim me vitet tjera, kështu që në krahasim me vitin 2019 kjo sipërfaqe është rritur për 1.4%. Edhe tek sipërfaqja me serra ka pasur rritje të sipërfaqes për 5.5% në krahasim me vitin 2019. Kopshtet paraqiten me sipërfaqe prej 1,133 ha me rritje për 1% krahasuar me vitin 2019.

Sipërfaqja e plantacioneve të pemëve në vitin 2020 ishte 10,029 ha, ku shfaqet një rritje për dallim nga viti 2019 për 8.5%. Sa i përket sipërfaqes së vreshtave nuk kemi ndryshime të theksuara në periudhën 2016-2020. Në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 ka pasur rritje të sipërfaqeve të vreshtave për 2.1%.


Figura 33: Perime, kopshte dhe fidanishte, plantacione të pemëve dhe vreshtave



Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('16,'17,'18,'19,'20)

Shfrytëzimin i tokës bujqësore në vitin 2020 sipas kategorive ka këtë shpërndarje: Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët) me pjesëmarrje prej 52%, Tokë e punueshme-ara 43%, Perime (në fushë të hapur dhe serra si kulturë e parë), kopshte dhe fidanishte 2%, Plantacione të pemëve 2% si dhe Plantacione të vreshtave 1%.

Figura 34: Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, 2020



Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('16,'17,'18,'19,'20)

2.2 Madhësia e fermës

Sipërfaqja e tokës së punueshme e shfrytëzuar i referohet sipërfaqes kryesore gjatë një viti të prodhimit bujqësor. Në vitin 2020, gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420,210 ha, nga kjo sipërfaqe gjithsej toka e punueshme-ara ishin 186,389 ha apo 44% ku janë të përfshira 103,723 ekonomi bujqësore.

Tabela 23: Madhësia e ekonomive sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2020

Madhësia e fermës	Sipërfaqja (ha)	Pjesëmarrja (%)	Nr. i Ekonomive Bujqësore	Pjesëmarrja (%)
0 dhe më pak se 0.5	6,453	3.5	31,290	30.2
0.5 deri më pak se 1	11,999	6.4	17,560	16.9
1 deri më pak se 2	29,005	15.6	22,560	21.8
2 deri më pak se 5	38,665	20.7	23,383	22.5
5 deri më pak se 10	64,819	34.8	7,063	6.8
10 deri më pak se 20	16,800	9.0	1,429	1.4
20 deri më pak se 30	5,255	2.8	240	0.2
30 e më shumë	13,393	7.2	198	0.2
Gjithsej*	186,389	100%	103,723	100%


Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2020

*Nuk janë përfshirë EB të komunave veriore

Në Kosovë madhësia e fermës prej 5 deri më pak se 10 ha përfaqëson 35% të gjithsej sipërfaqes së tokave të punueshme arave, pasuar nga madhësia e fermave prej 2 deri më pak

se 5 ha (21%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (16%) dhe madhësitë e tjera me më pak pjesëmarrje ku madhësia me sipërfaqen më të vogël është ajo prej 0 deri më pak se 0.5 ha.


Figura 35: Madhësia e fermës sipas sipërfaqes 2020, në %



Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2020

Numri më i madh i ekonomive bujqësore në Kosovë posedojnë kryesisht ferma që për nga madhësia dominojnë fermat me madhësi të vogël të sipërfaqes. Kështu që fermat me madhësi nga 0 deri më pak se 0.5 ha posedojnë 30% të ekonomive bujqësore, pasuar nga madhësia 2 deri më pak se 5 ha (23%), madhësia 1 deri më pak se 2 ha (22%) dhe grupet e tjera që kanë pjesëmarrje më të vogël. Numri më i vogël i ekonomive bujqësore apo 0.2% kishin ferma me madhësi 20 deri më pak se 30 ha dhe 30 e më shumë ha paraqiten vetëm 0.2% e ekonomive bujqësore.

Figura 36: Numri i ekonomive bujqësore sipas madhësisë së fermës 2020, (%)



Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore 2020

2.3 Prodhimtaria bimore

2.3.1 Drithërat

Sipërfaqja e kultivuar me drithëra në vitin 2020, përbën 66% të tokës së punueshme-arave. Kulturat që zënë përqindjen më të madhe të tokës së kultivuar me drithëra janë gruri me 64.5% dhe misri me 31.8%, ndërsa pjesa tjetër është e kultivuar me tërshërë, elb, thekër dhe drithëra tjera. Në vitin 2020, të gjitha kulturat në grupin e drithërave shënuan rritje në sipërfaqe, rritje kjo e cila varioi nga 0.2% tek gruri deri në 3.7% tek drithërat e tjera kokërr.

Përderisa rritja në gjithsej sipërfaqen e drithërave ishte vetëm 0.4%, prodhimtaria totale e drithërave u rrit për 15.2%, e kjo si rezultat i rritjes së rendimenteve tek të gjitha kulturat, duke filluar me grurin me rritje prej 19.6% e duke përfunduar me misrin me rritje prej 6% që ishte e vetmja kulturë në grupin e drithërave që kishte rritje një shifrore.

Tabela 24: Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i drithërave, 2016-2020

Kultura	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 në %
Sipërfaqja	ha					
Drithëra	134,571	120,746	123,869	124,199	124,714	0.4
Grurë	89,122	80,519	81,123	80,273	80,473	0.2
Misër	41,524	35,951	38,453	39,441	39,684	0.6
Elb	1,196	1,605	1,948	1,954	1,982	1.4
Thekër	415	318	434	420	425	1.2
Tërshërë	2,156	2,320	1,797	1,975	2,009	1.7
Drithëra të tjera kokërr	157	33	113	136	141	3.7
Prodhimtaria	t					
Drithëra	562,899	477,880	441,757	459,404	529,112	15.2
Grurë	365,651	320,136	280,616	284,999	341,818	19.9
Misër	186,592	147,200	151,921	163,930	175,180	6.9
Elb	3,669	4,687	5,124	5,159	5,764	11.7
Thekër	991	866	1,049	1,010	1,153	14.1
Tërshërë	5,428	4,862	2,751	3,954	4,769	20.6
Drithëra të tjera kokërr	568	129	296	352	427	21.4
Rendimenti	t/ha					
Grurë	4.10	3.98	3.46	3.55	4.25	19.6
Misër	4.49	4.09	3.95	4.16	4.41	6.2
Elb	3.07	2.92	2.63	2.64	2.91	10.2
Thekër	2.39	2.72	2.41	2.41	2.71	12.8
Tërshërë	2.52	2.10	1.53	2.00	2.37	18.6
Drithëra të tjera kokërr	3.62	3.87	2.62	2.59	3.03	17.0

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('16,'17,'18,'19,'20)

Në vitin 2020, nga sipërfaqja e përgjithshme e mbjellë me drithëra, 64.5% është e mbjellë me grurë. Me sipërfaqe prej 80,473 ha, prodhimtaria e grurit është 341,818 tonë, dhe me këtë prodhimtari Kosova arrin t'i mbuloj rreth 73% të nevojave për konsum, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga importi.

Vlera e prodhimit ishte 64.9 mil. €, që është 8.5% më e lartë se në vitin 2019, për shkak të rendimentit më të lartë edhe pse çmimi ishte më i ulët. Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ. Sasia e grurit të importuar duke përfshirë edhe produktet e grurit është më e ulët në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 për 40%.

Tabela 25: Bilanci i furnizimit për grurin, 2016-2020

	Njësia	2016	2017	2018	2019	2020
Sipërfaqja me drithëra	ha	134,571	120,746	123,869	124,199	124,714
Sipërfaqja me grurë	ha	89,122	80,519	81,123	80,273	80,473
Pjesëmarrja e grurit	%	65.5	66.7	65.5	64.6	64.5
Rendimenti	t/ha	4.10	3.98	3.46	3.55	4.25
Prodhimtaria	t	365,651	320,136	280,616	284,999	341,818
Importi i grurit dhe eku. të grurit	t	188,497	179,593	175,252	220,208	132,952
Furnizimi	t	554,148	499,729	455,868	505,207	474,770
Eksporti i grurit dhe eku. të grurit	t	30,806	22,700	10,326	5,093	8,364
Përdorimi vendor	t	523,342	477,030	445,542	500,114	466,406
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	69.9	67.1	63.0	57.0	73.3
Farë gruri	t	26,437	24,156	24,337	24,082	24,142
Humbjet	t	10,970	9,604	8,418	8,550	10,255
Ushqimi për kafshë	t	58,833	51,510	45,151	45,856	54,999
Përdorimi industrial	t	10,737	8,895	7,914	8,371	10,182
Procesimi	t	233,830	231,652	225,176	270,938	193,729
Konsumi njerëzor	t	182,535	151,213	134,546	142,316	173,100
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.17	0.16	0.16	0.21	0.19
Vlera e prodhimit	mil. EUR	62.2	51.2	44.9	59.8	64.9
Bilanci tregtar i grurit	mil. EUR	-68.2	-72.8	-73.1	-81.0	-70.6

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('16,'17,'18,'19,'20); ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB - MBPZhR

Misri është kultura e dytë më e kultivuar në grupin e drithërave. Në vitin 2020, 31.8% e sipërfaqes së përgjithshme të mbjellë me drithëra është e mbjellë me misër. Në vitin 2020 sipërfaqja me misër ishte për 0.6% më e lartë sesa në vitin 2019, ndërsa prodhimtaria është rritur vetëm 6.9% pasi që rendimenti kishte rritje për 6.2%.

Me këtë sasi të prodhimit Kosova plotësoi 75% të nevojave të vendit, ku pjesa më e madhe përdoret si ushqim i kafshëve. Për të përmbushur nevojat e përgjithshme Kosova gjithashtu importon misër dhe bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ dhe në vitin 2020 ka vlerë prej 13.2 mil. €, e që është më i lartë për 14% krahasuar me vitin 2019.

Tabela 26: Bilanci i furnizimit për misrin, 2016-2020

	Njësia	2016	2017	2018	2019	2020
Sipërfaqja me drithëra	ha	134,571	120,746	123,869	124,199	124,714
Sipërfaqja me misër	ha	41,524	35,951	38,453	39,441	39,684
Pjesëmarrja e misrit	%	30.9	29.8	31.0	31.8	31.8
Rendimenti	t/ha	4.49	4.09	3.95	4.16	4.41
Prodhimtaria	t	186,592	147,200	151,921	163,930	175,180
Importi i misrit dhe eku. të misrit	t	55,044	58,329	54,071	55,498	58,741
Furnizimi	t	241,636	205,529	205,992	219,428	233,921
Eksporti i misrit dhe eku. të misrit	t	275	277	303	328	555
Përdorimi vendor	t	241,362	205,252	205,689	219,100	233,366
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	77.3	71.7	73.9	74.8	75.1
Farë misri	t	830	719	769	789	794
Humbjet	t	5,598	4,416	4,558	4,918	5,255
Ushqimi për kafshë	t	144,131	113,652	117,275	126,579	135,305
Përdorimi industrial	t	3,002	3,110	2,904	2,990	3,157
Procesimi	t	16,734	13,201	13,749	15,145	16,065
Konsumi njerëzor	t	71,067	70,154	66,434	68,679	72,790
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.24	0.23	0.25	0.24	0.25
Vlera e prodhimit	mil. EUR	44.8	33.9	38.0	39.3	43.8
Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('16,'17,'18,'19,'20); *DAESB - MBPZhR ('16-'20)

Në vitin 2020, prodhimi i vezëve në fermat komerciale vlerësohet të jetë rreth 258 mil. vezë ndërsa në kuadër të ekonomive familjare prodhohen edhe rreth 108 mil. copë që rezulton me një prodhimtari totale 366 mil. vezë. Në vitin 2020, janë importuar rreth 4.9 mil. vezë në vlerë prej 438.5 mijë €. Maqedonia është vendi nga i cili janë importuar 49.5% e vezëve në vitin 2020 pasuar nga Shqipëria me 38.6%, Bullgaria me 11% dhe vendet tjera si Austri, Francë, Holanda dhe Itali me më pak se 1% gjithsej. Ndërsa eksport nuk ka pasur në vitin 2020. Konsumi mesatar për kokë banori llogaritet të jetë 206 vezë/vit dhe mund të themi se Kosova plotëson rreth 99% të nevojave për konsum të vezëve.

Në vitin 2020, prodhimi i mishit të pulës vlerësohet të jetë rreth 2,671 tonë duke marr parasysh faktin se sektori i shpezëtarisë është i orientuar kryesisht në prodhimtarinë e vezëve për konsum dhe prodhimin e zogëzave, kurse prodhimtaria e mishit të zogut është në fazë më të ulët të zhvillimit. Në vitin 2020 importi i mishit të pulës ka qenë rreth 34,884 tonë, nga e cila 29% është importuar nga Brazili, 22% nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 11% nga

Mbretëria e Bashkuar, 9% nga Polonia, 6% nga Gjermania dhe pjesa tjetër prej 23% nga vendet e tjera. Konsumi mesatar për kokë banori në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 20.9 kg/vit. Me prodhimtarinë aktuale Kosova arrin të mbuloj vetëm 7.1% të nevojave për konsum.

2.5.5 Bletaria

Mbështetja e vazhdueshme që i është bërë sektorit të bletarisë ka ndikuar që edhe numri i koshereve të rritet në vazhdimësi. Për herë të parë mbështetja e këtij sektori përmes pagesave direkte është bërë në vitin 2012, duke vazhduar vit pas viti me rritje të numrit të koshereve të subvencionuara, por edhe me rritje të numrit të përgjithshëm të koshereve. Në vitin 2020 numri i koshereve është rritur për 19.4% krahasuar me vitin e paraprak.

Tabela 55: Numri i koshereve të bletëve, 2016-2020

Numri i koshereve	2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 në %
Koshere bletësh	162,355	163,717	182,476	219,831	262,541	19.4


Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('16,'17,'18,'19,'20)

Prodhimtaria e mjaltit në vitin 2020 ishte shumë më e ulët sesa në vitin 2019, e kjo si rezultat i kushteve të papërshtatshme atmosferike që ishin në vitin 2020, e që ndikoi që prodhimtaria të ishte mjaft e ulët. Në vitin 2020 janë importuar 253 tonë mjaltë që në krahasim me vitin 2019, sasia e importuar ishte për 10% më e madhe, ndërsa eksporti i mjaltit ishte vetëm 75 kg dhe kjo sasi është eksportuar në Republikën Çeke. Duke marr parasysh prodhimtarinë vendore si dhe sasinë e importuar, në Kosovë në vitin 2020 janë konsumuar 1,040 tonë mjaltë, pra një banor i Kosovës ka konsumuar 0.6 kg gjatë vitit. Mbulimi i nevojave për konsum nga prodhimtaria vendore ishte 76%. Më së shumti sasi e mjaltit është importuar nga Maqedonia (43%), pasuar nga Turqia (21%), Kroacia (18%), Sllovenia (9%) dhe nga shtetet e tjera 9%.

3 Pylltaria

Mbështetur në Ligjin për pyjet Nr. 2003/3, pyjet konsiderohen pasuri kombëtare me interes të përgjithshëm. Pyjet në mbarë botën kanë një interes shumë dimensional nisur nga fakti se përmbushin rol të rëndësishëm jetësor. Bazuar në këtë, pyjet kanë rëndësi në përmbushjen e qëllimeve në aspektin ekologjik-mjedisor, ekonomik dhe social. Roli social i pyjeve është një nga faktorët tjerë kryesor, i cili sot në mbarë globin trajtohet si qenësor për arsye që ndërlidhen me sigurimin e ushqimit dhe krijimin e vendeve të punës. Prandaj, politikat e ardhshme kombëtare apo ndërkombëtare, përveç qasjes në rolin e pyjeve në aspektin ekologjik-mjedisor dhe atë ekonomik, janë përqendruar së tepërmi në krijimin e vendeve të punës në zonat e thella rurale, me qëllim të mbajtjes së popullatës në këto zona, bazë për sigurimin e ushqimit, përmes shumë dimensionimit të vlerave. Mbështetur në statistikën e nxjerra nga Inventarizimi Kombëtar të Pyjeve/IKP të vitit 2012, Kosova është e mbuluar me 45% me pyje, e që konsiderohet një potencial i qëndrueshëm për zhvillim të vendit, nga të cilat rreth 62% janë pyje publike ndërsa rreth 38% konsiderohen si pyje private. Bazuar në inventarin e pyjeve, zonat e mbrojtura apo pyjet shtrihen në rreth 12% të sipërfaqes të përgjithshme të tyre dhe në vete ngërthejnë rreth 36% të volumit të përgjithshëm. Ndikimi apo impakti për qasje ekonomike është i madh, bazuar në faktin e mësipërm të përmblendhjes në vëllim, por edhe në faktin se pyjet me vlera më të mëdha ekonomike (pyjet e larta-trungishtet) gjenden brenda dy parqeve kombëtare: “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”.

Figura 41: Klasat e përdorimit të tokës në Kosovë (% nga sipërfaqja totale e tokës)



Burimi: Inventarizimi Nacional i Pyjeve, INP 2012

Pyjet e Kosovës janë të dominuar nga pyjet fletore, duke mbuluar 93% (449,400 ha) të sipërfaqeve pyjore, ku më shumë se gjysma janë një-moshare, ndërsa 5% (23,800 ha) e sipërfaqeve pyjore mbulohet nga pyjet halore të cilat janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në mes të klasave të ndryshme të strukturës. Plantacionet e pishave kontribuojnë në sipërfaqet një-moshare. Në total, 50% e sipërfaqes pyjore është konsideruar një-moshare.

Tabela 56: Sipërfaqja pyjore sipas përbërjes dhe strukturës së grumbullit, (ha)

Përbërja pyjeve	Rigjenerimi	Një-moshar	Dy-katësh	Shumë-moshar	Totali
Halorë	2,200	6,600	6,200	8,800	23,800
Përzier	0	400	3,200	4,200	7,800
Fletorë	45,400	236,000	123,600	44,400	449,400
Totali	47,600	243,000	133,000	57,400	481,000

Burimi: Inventarizimi Nacional i Pyjeve, INP 2012

Aktivitetet në politikat pyjore

Zhvillimi i legjislacionit dhe politikave, është një nga çështjet themelore në shtyrjen drejtë përcaktimit të objektivave dhe marrjes të masave për përmbushjen e tyre nga institucionet, duke synuar njëkohësisht harmonizimin me standarde ndërkombëtare, në lidhje me përdorimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore në përgjithësi. Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, konsiderohet një platformë për të ndihmuar në ndryshimet klimatike, me këtë rast përmirësimi i cilësisë së ajrit, ujit, ruajtja e biodiversitetit dhe rritja e cilësisë së jetës, janë disa nga objektivat e përcaktuara globalisht, dhe mbeten synimet kryesore të departamentit të pylltarisë për tu përmbushur në të ardhmen. Gjithashtu, në kuadër të kompetencave Departamenti zhvillon programe të ndryshme në ngritjen e kapaciteteve institucionale duke organizuar trajnime, këshillime lidhur me avancimin e sektorit pyjor në përgjithësi. Departamenti është institucion që bën koordinimin për zhvillimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndër institucional, me donator të ndryshëm të brendshëm dhe ndërkombëtar. Veprimtaria e këtij Departamenti, ndërlidhet ngushtë me përmbushjen e misionit lidhur me zbatimin e standardeve profesionale për ndërmarrje të ndryshme, që kryejnë aktivitete në pyje dhe toka pyjore. Kjo ndihmon në zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe profesionalizimin e tyre në fushën e projektimit, hulumtimit, shfrytëzimit të pyjeve, kultivimit, grumbullimit dhe përpunimit të prodhimeve pyjore, rregullimit të sektorit të gjuetisë në komuna etj.

Gjuetia

Gjuetia është një nga sektorët e pylltarisë i cili është në organizim e sipër. Shumë nga komunat në Kosovë tashmë kanë të themeluar vend gjuetie të përbashkëta, mirëpo akoma mungon qasja e duhur për dhënie në menaxhim dhe mbulimi me plane menaxhuese 10 vjeçare dhe vjetore. Kjo në fakt nxjerr probleme të shumta në menaxhimin e qëndrueshëm me kafshë të egra dhe zbatimin e vendimit për mbylljen dhe hapjen e sezonit të gjuetisë.

Lidhur me zbatimin e Ligjit për Gjuetinë Nr. 02/L-53, personeli i Departamentit të Pylltarisë ka realizuar një varg takimeshe me institucionin e Federatës së gjahtarëve për mirë organizimin e sektorit të gjuetisë, me komunat e ndryshme që kanë ngecur në themelimin e vend gjuetive dhe dhënien e tyre në menaxhim. Mund të veçojmë, angazhimin e Komisionit për dhënien ose refuzimin e pëlqimit për themelimin apo dhënien në menaxhim të vend gjuetive të përbashkëta dhe shqyrtimin e kërkesave për aprovimin e planeve menaxhuese afatgjate, i cili për periudhën e raportimit ka organizuar dhe mbajtur 6 takime të ndryshme

për themelim të vend gjuetive të përbashkëta në komunat e ndryshme si: Deçani, Vitia Dragashi dhe Gmica, dhënien në menaxhim të tre (3) vend gjuetive në Prizren, Fushë Kosovë, Ferizaj dhe shqyrtimin e kërkesave për Miratimin e Planeve menaxhuese afatgjata për komunat: Graçanicë, Hani i Elezit, Mitrovicë dhe Obiliq.

Tabela 57: Pëlqimet për themelim, dhënia në menaxhim dhe PM

Nr	Emri i vend gjuetisë	Statusi	Komuna	Sip.ha
1	Lozja	Miratuar	Deçan	8,157
2	Kopilaqa	Miratuar	Viti (rithemelim)	23,120
3	Sharr	Plotësim	Dragash (rithemelim)	10,131
4	Gmica	Refuzim	Kamnicë	Rreth 16
Dhënie në menaxhim				
5	Ferizaj	Miratuar	Ferizaj	27,865
6	Bjeshka	Miratuar	Fushë Kosovë	4,725
7	Sharri 1 dhe 2	Refuzuar	Prizren	10,702
8	Pashtriku	Refuzuar		13,649
9	Koretniku dhe Rrfashi	Refuzuar		22,373
Planet menaxhuese 10 vjeçare				
10	Shala 2020-2030	Miratuar	Mitrovicë	25,465
11	Graçanica 2020-2030	Miratuar	Graçanicë	9,627
12	Kroni i ftohtë 2020/21-2029/30	Plotësim	Hani i Elezit	5,821
13	Qvgavica 2021-2031	Refuzim	Obiliq	10,482

Burimi: Departamenti i Pyjeve

Për zbatimin e kornizës ligjore për gjuetinë dhe përmbushjen e obligimeve me rastin e dhënies në menaxhim me qira të vend gjuetive nga komunat, ka pasur një vazhdimësi të diskutimit të akteve, planeve dhe programeve të ndryshme. Në kuadër të këtij aktiviteti janë diskutuar 4 PM për periudha të ndryshme kohore, nga të cilat dy janë miratuar, një është kthyer në plotësim dhe një është refuzuar. Hartimi dhe harmonizimi i këtyre PM me bazën ligjore për gjueti është çështja thelbësore për miratimin e tyre. Një nga kushtet tjera është se këto PM duhet të hartohen nga kompanitë e licencuara siç është Federata e Gjahtarëve të Kosovës, deri më tani i vetmi subjekt i licencuar në përputhje me UA. Nr. 23/2008 nga Departamenti i Pylltarisë. Natyrisht, miratimi i këtyre PM, ishte një sfidë e re dhe njëkohësisht një përgjegjësi për Departamentin, duke ditur faktin se nga koha e pas luftës janë hapat e parë për krijimin e PM dhe miratimit të tyre.

Politikat dhe strategjitë

Gjatë vitit 2020, duke pas parasysh vështirësitë në funksionimin e institucioneve për shkak të pandemisë të COVID 19, zhvillimit të punës me staf esencial, Departamenti i Pylltarisë ka pasur angazhime në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në dokumente strategjike, politike, programeve etj. Vlen të përmendim, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë, Strategjinë për Gjueti, Strategjinë për Ruajtjen e Biodiversitetit, Programin për Pyllëzime dhe Ripyllëzime, Programin për Shëndetin Pyjor, Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve 2012/2013, Inventarizimi i Prodhimeve Pyjore jo drunore dhe përcaktimi i kuotave të vjeljes, etj. Zbatimi i këtyre dokumenteve zyrtare është

ndërlidhur me shumë nga institucionet dhe donatorët vendor dhe ndërkombëtar, por mund të veçojmë bashkëpunimin me organizatat donatore në sektorin e pylltarisë si Komisioni European, Sida, FAO, CNVP etj., me synimin e zbatimit dhe përmbushjes të objektivave të përcaktuara.

Publikimet

Për shkak të shkurtimeve buxhetore nuk janë zhvilluar aktivitete për zhvillimin e fushatave dhe publikime të ndryshme. Ky boshllëk, është përmbushur nga aktivitetet e zhvilluara nga organizata që janë duke financuar projektet në pylltari si SIDA, FAO, etj.

Aktivitetet për licencim

Gjatë vitit 2020 procesi i licencimit është zhvilluar bazuar në kërkesat e subjekteve të ndryshme që kanë shprehur interesim. Si aktivitete më të shënuara për periudhën në fjalë përmendim vazhdimin e licencave ekzistuese të rreth 26 sosh, ndërsa 11 janë të evidentuara si licenca të reja etj. Këto licenca kanë mbuluar kryesisht fushat e shfrytëzimit të qëndrueshëm, grumbullimit të prodhimeve jo drunore dhe përpunimit të drurit. Aktivitetet e licencimit janë ndjekur nga Komisioni i Departamentit të Pylltarisë, përmes shqyrtimit të kërkesave, vizitave në teren të subjekteve dhe zhvillimit të procedurës për lëshimin e licencave.

Tabela 58: Tabela mbi licencat

Nr	Emërtimi	Numri i licencave të lëshuara
1	Për shfrytëzim të qëndrueshëm të pyjeve	13
2	Për grumbullim të prodhimeve jo drunore (fruta malore)	11
3	Për përpunim të drurit	9
4	Pyllëzime	3
5	Për projekte në fushën e pylltarisë	0
Gjithsej		40

Burimi: Departamenti i Pyjeve

Aktivitetet në Menaxhimin e pyjeve

Me Strategjinë për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020, janë identifikuar fushat me ndikim në të cilat është e nevojshme të ndërhyhet me qëllim të përmbushjes së synimeve rreth menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe burimeve pyjore. Gjatë vitit 2020 janë mbuluar me plane afatgjate pesë njësi menaxhuese në katër Komuna të Kosovës, ku janë monitoruar dhe kontrolluar gjatë gjithë kohës së mbledhjes së shënimeve taksative në terrene si dhe është raportuar në tri faza për punët e kryera: faza I - krijimi i databazës dhe dixhitalizimi i njësisë menaxhuese, faza II - mbledhja e shënimeve të detajuara në terrene, faza III - përpunimi i të dhënave bazuar në shënimet si pjesa tekstuale, tabelare dhe hartografike. Planet Menaxhuese për Njësi Menaxhuese (NJM) të cilat përfaqësojnë rreth 10,768 ha sipërfaqe pyjore.

Tabela 59: Hartimi i Planeve Menaxhuese, 2020

Njësia menaxhuese	Komuna	Sipërfaqja në ha
Lugu i Butë	Istog	3,446
Ahishta	Kaçanik	823
Goshtcë	Viti	2,310
Bredhiku	Dragash	1,262
Opojë	Dragash	2,927
Gjithsej		10,768

Burimi: APK

Në tabelat e mëposhtme është paraqitur plani vjetor i shfrytëzimit dhe realizimit të tij për pyjet në pronën shtetërore në vitin 2020.

Tabela 60: Planifikimi vjetor në pyjet shtetërore, m³

Asortimentet	Vëllimi m ³
Dru teknik	7,868
Dru zjarri	55,443
Neto masa drusore	63,310
Mbeturina	4,203
Bruto masa drusore	67,513

Burimi: APK

Tabela 61: Realizimi i planit në shfrytëzim në pyjet shtetërore, m³

Lloji i prodhimit	Nj. matëse	Plani 2020	Realizimi 2020	Indexi %
Trupa ahu	m3	6,546	1,061	16
Dru teknik -breu	m3	1,321	1,318	99
Dru zjarri	m3	55,443	23,634	43
Dega, mbeturina etj.	m3	4,203	216	5
Gjithsej	m3	67,513	26,229	39

Burimi: APK

Vëllimi drusor në pyje shtetërore i planifikuar për shfrytëzim në vitin 2020 ishte 67,513.55 m³, ndërsa sasia e shfrytëzuar ishte vetëm 25,947.49 m³ (38.43% e planit). Ky plan parasheh realizimin e masës drusore sipas asortimenteve drusore.

Tabela 62: Realizimi i shfrytëzimit të pyjeve shtetërore

Drejtoritë	Dru teknik halorë	Dru teknik fletorë	Dru zjarri	Mbeturina	Gjithsej m ³
Prishtinë	0	4	984	83.22	1,071
Mitrovicë	0	0	0	0	0
Pejë	243	0	5,054	0	5,298
Prizren	61	304	2,420	117	2,902
Ferizaj	114	753	5,150	0.50	6,018
Gjilan	899	0.50	7,774	0	8,674
DMKE	0	0	2,252	15	2,267
Gjithsej	1,318	1,062	23,634	216	26,229

Burimi: APK

Aktivitetet në pyjet private

Agjencia Pyjore dhe Autoritetet Pyjore Komunale, në kuadër të zbatimit të ligjit mbi pyjet lidhur me decentralizimin e përgjegjësi në planifikimin vjetor në pyjet private, kanë të

bëjnë me rregullimin e pyjeve private nëpërmjet shërbimeve tekniko-profesionale që kryhen nga APK-ja në realizimin e planifikimit dhe damkosjes. Nga niveli komunal bëhet dhënia e lejeve për prerjet drusore në pyjet private si dhe kryerjen e shërbimeve për transport të materialit drusor (lëshimi i fletë damkosjeve, lejeve për prerje, fletë-përcjellëseve, etj.).

Tabela 63: Plani në pyjet private, 2020

Kultivimi dhe Shfrytëzimi i Pyjeve	Njësia	Gjithsej
Ngritja e pyjeve të reja - pyllëzime	ha	84
Përtëritja e pyjeve - meliorim	ha	13
Kultivimi i pyjeve	ha	3,379
Shfrytëzimi i pyjeve	ha	4,780
Punët tekniko-profesionale		
Kërkesa të parashtruara	copë	4,975
Planifikimi i prerjeve në pyjet private	m ³	200,180
Dru Zjarri	m ³	192,960
Dru teknik	m ³	7,220

Burimi: APK

Në bashkëpunim me Asociacionin e Pronarëve të Pyjeve private, Agjencia e Pyjeve ka arritur që në planin e kultivimit të pyjeve të realizoj mbështetjen tekniko-profesionale në rregullimin e pyjeve në pronësi private, mbështetur në kërkesat e pronarëve janë planifikuar për shfrytëzim 4,780 ha sipërfaqe pyjore.

Aktivitetet në pyje private janë po ashtu të përfshira në trajtime profesionale, ku janë kryer shërbime tekniko-profesionale në damkimin e masës drusore për pyjet private, lidhur me përmbushjen e nevojave për dru zjarri dhe dru teknik, autoritetet Komunale në bashkëveprim me APK për vitin 2020, kanë realizuar shfrytëzimin-prerjen të 131,742 m³ material drusor.

Tabela 64: Realizimi i aktiviteteve në pyjet private, 2020

DKR-APK	Nj. matëse	Plani 2020	Realizimi PP 2020	%
Prishtinë	m ³	43,540	25,842	59
Mitrovicë	m ³	72,230	41,622	58
Pejë	m ³	10,400	2,348	23
Prizren	m ³	4,190	2,297	55
Ferizaj	m ³	10,900	5,773	53
Gjilan	m ³	58,260	53,576	92
DMKE	m ³	750	283	38
Gjithsej	m³	200,180	131,742	66

Burimi: APK

Aktivitetet në mbrojtjen e pyjeve

Janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, si ngritje të procedurave për kundërvajtje dhe penale, kontrolle në terrene pyjore, tregje, dhe rrugët pyjore.

Autoritetet komunale gjatë vitit në fjalë, kanë raportuar se janë ngritur rreth 3,374 kallëzime penale dhe kundërvajtje, nga të cilat 610 penale dhe 2,764 kundërvajtje. Sasia e materialit

drusor të raportuar si dëm pyjor është llogaritur të jetë rreth 7,397.92 m³ në vlerë rreth 912,808.54 €. Në aspektin e mbrojtjes së pyjeve nga prerjet e parregullta është aplikuar masa e konfiskimit të materialit drusor i cili është prerë dhe transportuar në mënyrë të parregullt. Në kuadër të kësaj, konstatohet se gjatë vitit që lamë pas janë konfiskuar 1,720.04 m³ lëndë drusore nga e cila janë shitur 1,488.15 m³, ndërsa stoqet e bartura nga viti i kaluar arrijnë sasinë 1,664.34 m³.

Tabela 65: Kallëzimet apo fletëparaqitjet, 2020

Dëmi Pyjor	Copë	m ³	Gjithsej në €
Fletëparaqitje kundërvajtje	2764	4,715	569,551
Fletëparaqitje penale	610	2,683	343,258
Gjithsej	3374	7,398	912,808

Burimi: APK

Tabela 66: Konfiskimi i materialit drunor

Lënda drunore	m ³
Stoqet nga viti 2019	1,728
Sasia e drunore e konfiskuar 2020	1,720
Sasia e shitur	1,488
Gjendja e tanishme e stoqeve	1,664

Burimi: APK

Zjarret pyjore gjatë vitit 2020

Zjarret pyjore paraqesin një nga sfidat e mëdha të institucioneve, sidomos gjatë periudhës të fillimit të pranverës dhe gjatë periudhës së verës. Sipas analizave dhe statistikave të ndryshme mbi 99% e zjarreve në pyje dhe toka pyjore shkaktohen nga faktori njeri, ndërsa vetëm 1% e tyre nga shkaktarë të tjerë abiotik. Gjatë periudhës me thatësira të verës të vitit 2020, numri i rasteve dhe përfshirja e sipërfaqeve pyjore nga zjarret pyjore ka shënuar një rritje të vazhdueshme. Kjo si shkak i temperaturave të larta dhe nga pakujdesia e njerëzve. Sipas raporteve të Drejtorive Koordinuese në terren, Agjencia Pyjore gjatë vitit në fjalë ka evidentuar gjithsej 170 raste të zjarreve në pyje publike dhe private, të cilat përfshijnë një sipërfaqe pyjore rreth 2,404 ha.

Tabela 67: Numri i rasteve të zjarreve pyjore dhe sipërfaqja, 2020

Komuna	Numri i rasteve	Sipërfaqja (ha)		Gjithsej (ha)
		Publike	Private	
Prishtinë	59	121	250	371
Mitrovicë	17	268	350	618
Pejë	6	318	4	322
Prizren	58	721	41	762
Ferizaj	19	84	0.0	84
Gjilan	11	216	30	247
Gjithsej	170	1,728	675	2,404

Burimi: APK

Agjencia Pyjore e Kosovës është duke vazhduar bashkëpunimin me institucione të rendit, emergjencave dhe sigurisë në raste të zjarreve pyjore. Ky bashkëpunim krijon mundësinë për zvogëlimin e mundësive të përhapjes së zjarreve në sipërfaqet e vendbanimeve duke shmangur humbjet në njerëz. Gjatë vitit 2020, APK në bashkëpunim me MPMS në gjashtë regionet angazhuan rreth 290 punëtor sezonal për mbrojtje të pyjeve nga zjarret. Nga APK dhe AME, janë trajnuar dhe certifikuar 240 punëtor për shuarje të zjarreve në pyje. Andaj, edhe zjarret të cilët kanë qenë në pyje, nuk kanë qenë zjarre me përmasa shkatërruese në pyje, por kryesisht kanë qenë zjarre me intensitet të ulët, apo zjarre të ulëta dhe të mesme, si dhe një pjesë e tyre në toka pyjore (kullosa apo sipërfaqe të hapur).

Prodhimtaria e fidanëve pyjor

Fidanishtja e Institutit të Pejës përgjatë vitit 2020, ka ndërmarrë zhvillimin e aktiviteteve në kultivimin e fidanëve pyjor në mënyrë klasike dhe industriale që përdoren për pyllëzimet e tokave pyjore dhe djerrinave. Gjithsej në fidanishten e këtij Instituti janë kultivuar 1,500.000 fidanë pyjor.

Tabela 68: Prodhimtaria e fidanëve, 2020

Lloji i fidanëve	Mënyra e kultivimit	Copë
Halor	Klasik	755,600
Halor	Industrial	549,000
Fletor	Klasik	195,400
Fletor	Industrial	0.0
Halor dhe Fletor		1,500.000

Burimi: APK

Aktivitetet në pyllëzime

Pyllëzimet vjeshtore, janë realizuar në dy pjesë për shkak të situatës me pandemi Covid-19 ku ka pasur numër të kufizuar të punëtorëve si dhe punimet janë kryer me tender dhe me punëtor sezonal, nëpërmjet shpalljes së tenderimit, të ndara me llote dhe të mbikëqyrura nëpërmjet menaxherit të kontratës dhe ndihmëseve të tij, ashtu si përshkruhet në tabelën më poshtë me sipërfaqe 235 ha.

Ndërsa pjesa tjetër e punimeve në pyllëzime janë realizuar me angazhim të punëtorëve sezonal, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit në mes MBPZhR-APK dhe MPMS të cilat janë paraqitur në tabelën me sipërfaqe 145.60 ha.

Mbështetur në planin vjetor të menaxhimit me pyje, pyllëzimet e tokave pyjore janë realizuar në të gjithë territorin e Kosovës, të cilat janë përfshinë 380.60 ha.

Tabela 69: Pyllëzimet vjeshtore, 2020

Regjioni	Sipërfaqja në ha
Prishtinë	58
Mitrovicë	69
Pejë	55
Prizren	65.20
Ferizaj	69.40
Gjilan	64
Gjithsej	380.60

Burimi: APK

Përmbledhje e aktiviteteve të projekteve të FAO-s në Kosovë gjatë vitit 2020

Projekti “Mbështetje për fuqizimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumëqëllimor të pyjeve për të përmirësuar jetesën në vendet rurale dhe për të adresuar ndryshimin klimatik në Kosovë” – GCP/KOS/007/SWE

Në vitin 2020, FAO ka filluar zbatimin e Programit për fuqizimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumëqëllimor të pyjeve 2019-2023. Programi ka për qëllim promovimin e menaxhimit më efikas të resurseve pyjore në Kosovë, përmes qasjes shumëqëllimore dhe me pjesëmarrje e cila është mbështetur në zinxhirin e vlerave që përfshinë barazinë gjinore, ndryshimet klimatike dhe zvogëlimin e varfërisë në zonat rurale. Programi i ka këto tri komponentë:

- Përmirësimi i ligjshmërisë së shfrytëzimit të drurit dhe zbatimin e ligjit në sektorin pyjor
- Rritja e transparencës dhe fuqizimi i kapacitetit institucional në qeverisjen e mirë dhe zbatimin e politikave, strategjive dhe programeve pyjore
- Prezantimi i menaxhimit pyjor shumëqëllimor dhe përfshirja e zinxhirëve gjithëpërfshirës të vlerave pyjore për zbutjen e varfërisë së grave dhe burrave në vende rurale

Programi financohet prej donatorëve dhe për këtë qëllim Qeveria Suedeze ka ndarë 2.5 mil. €, ndërsa BE-ja është zotuar për mbështetje në financimin e zbatimit të këtij programi me 1.5 mil. €. Gjithashtu, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është zotuar se të kontribuoj financiarisht në zbatimin e këtij programi.

Gjatë pjesës së parë të vitit 2020, janë zhvilluar anketa në terren, grumbullim të të dhënave dhe janë vendosur indikatorë për monitorimin shfrytëzimit të pyjeve/drurit në mënyrë të ligjshme dhe vlerësimin e aspektit ekonomik të sektorit pyjor. Janë përcaktuar dhe identifikuar fushat kyçe për hartimin e legjislacionit mbështetës (udhëzimet administrative) për rregullimin e shfrytëzimit të pyjeve dhe produkteve pyjore jo-drunore.

Është përcaktuar fushëveprimi dhe përbërja e Task Forcës për shfrytëzimin e ligjshëm dhe mbrojtjen e pyjeve.

Ekspertët për çështje ligjore kanë finalizuar programin e trajnimit për personelin zyrtar të përfshirë në zbatimin e legjislacionit pyjor (përfshirë Task Forcën) dhe palët tjera të interesit që kanë rol në luftimin e prerjeve ilegale dhe zbatimin e ligjit për sektorin e pylltarisë.

Janë hartuar specifikacionet e pajisjeve që do të shfrytëzohen për trajnime për Trajnerë dhe personelin tjetër të pylltarisë (teknikët, rojet dhe stafi mbështetës). Objektivi i trajnimit është ngritja e kapaciteteve në luftimin edhe parandalimin e aktiviteteve joligjore në sektorin pylltarisë.

Është definuar strategjia dhe mjetet e komunikimit për organizimin e fushatave për rritjen e vetëdijesimit rreth rolit dhe mbrojtjes së pyjeve. Janë shqyrtuar të arriturat për mundësuat vlerësimin e zbatimit të strategjisë për periudhën 2010–2020. Janë angazhuar ekspertë vendor dhe ndërkombëtarë për përgatitjen dhe hartimin e strategjisë së re për sektorin e pylltarisë 2021–2030. Janë hartuar planet operacionale për fillimin e zbatimit të aktiviteteve të Programit Kombëtar për Pyllëzime dhe Ripyllëzime PKPR, janë grumbulluar të dhëna për hartimin e metodologjisë për aplikimin e menaxhimit shumë qëllimor të pyjeve. Metodologjia kjo që mundëson planifikimin me pjesëmarrje për shfrytëzimin e resurseve pyjore dhe produkteve drunore dhe jo drunore. Janë identifikuar pilot zonat – katër njësi menaxhuese pyjore ku do të aplikohet metodologjia e planifikimit të menaxhimit shumëqëllimor, si dhe janë grumbulluar të dhëna dhe janë identifikuar 12 produkte pyjore së bashku me partner lokal dhe që mund të konsiderohen për mbështetje në zhvillimin e vlerave të zinxhirit për ngritje të kontributit në punësim dhe krijimin e të ardhurave për banorë lokal.

Projekti: Gatishmëria për Emergjencën e Murtajës Afrikane të Derrave (MAD) në Kosovë
TCP/KOS/3703

Në kuadër të këtij projekti janë mbajtur punëtori, punëtori online dhe ushtrime për MAD ku janë trajtuar, diagnoza klinike, diagnoza laboratorike, hetimi i shpërthimit të MAD, masa e kontrollit, parandalimi dhe biosiguria dhe MAD-ja në derrin e egër.

Në punëtori kanë qenë rreth 500 pjesëmarrës nga vende të ndryshme të Ballkanit dhe Europës – staf i shërbimeve veterinarë shtetërore, veterinarë privat dhe palët tjera me interes.

4 Tregtia

4.1 Tregtia e përgjithshme

Shkëmbimi tregtar i Kosovës për kapitujt doganor të sistemit të harmonizuar (01-98) për periudhën 2014-2015, ka qenë i përafërt. Në vitin 2020, eksporti ishte në vlerë prej 475.0 mil. €, që kishte rritje të eksportit të përgjithshëm për 23.9% në krahasim me vitin 2019. Vlera e importit në vitin 2016 ishte mbi 2 mld. €, ndërsa në periudhën 2017-2020 kjo vlerë është rritur në mbi 3 mld. €, kështu që në vitin 2020, paraqitet rënie për 6.1% për dallim nga viti 2019.

Tabela 70: Eksporti-Importi i përgjithshëm

Vitet	Eksporti (1-98), në '000 €	Importi (1-98), në '000 €	Bilanci tregtar, në '000 €	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2016	309,627	2,789,491	-2,479,864	11.1
2017	378,010	3,047,018	-2,669,007	12.4
2018	367,500	3,347,007	-2,979,507	11.0
2019	383,491	3,496,431	-3,112,940	11.0
2020	474,959	3,296,323	-2,821,364	14.4

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2 Tregtia e produkteve bujqësore

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore karakterizohet me rritje në vitin 2020. Bilanci tregtar është negativ përkundër rritjes së vlerës së eksportit dhe rënies së importit. Në vitin 2020 vlera e eksportit të produkteve bujqësore të eksportuara ishte 78.1 mil. €, që paraqet rritje për 19.2%, në anën tjetër edhe importi paraqitet me rritje për 0.8% në krahasim me vitin 2019.


Tabela 71: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore

Viti	Eksporti (1-24), në '000 €	Importi (1-24), në '000 €	Bilanci tregtar, në '000 €	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2016	45,205	658,730	-613,525	6.9
2017	61,336	694,517	-633,180	8.8
2018	63,950	712,314	-648,364	9.0
2019	65,510	759,359	-693,849	8.6
2020	78,075	765,356	-687,281	10.2

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Bilanci tregtar ashtu si edhe viteve tjera vazhdon të jetë negativ, në këtë rast në vitin 2020 bilanci negativ është shfaqur në vlerë prej 687,281 mil. €, ndërsa mbulueshmëria e importit me eksport është në shkallë prej 10.2%.

Figura 42: Eksport, Importi dhe Bilanci tregtar i produkteve bujqësore (1-24), në '000




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm ka shënuar rritje të konsiderueshme. Pjesëmarrja më e madhe e eksportit të produkteve bujqësore (01-24) në eksportin e përgjithshëm (1-98) ishte në vitin 2018 (17.4%). Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm në vitin 2020 ishte 16.4%.

Pjesëmarrja më e ulët e importit të produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm ishte në vitin 2018 (21.3%), ndërsa pjesëmarrja më e lartë ishte në vitin 2016 (23.6%). Pjesëmarrja e importit të produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm në vitin 2020 ishte 23.2%.

Figura 43: Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm (majtas), Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2.1 Tregtia sipas grupeve të shteteve

Eksporti i produkteve bujqësore në vitin 2020 kishte vlerë 78.1 mil. € nga e cila 41.1 mil. € ishin nga vendet e CEFTA-s, 30.9 mil. € nga vendet e BE-së dhe 6.1 mil. € nga vendet e tjera. Vlera më e madhe e importit ishte nga vendet e BE-së në vlerë prej 411.2 mil. €, vendet e CEFTA-s 183.3 mil. € dhe vendet e tjera 170.7 mil. €. Gjithsej bilanci tregtar në vitin 2020 ishte -687.3 mil.€, me mbulueshmëri të importit me eksport në shkallë prej 10.2%.


Tabela 72: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve, 2020

	CEFTA	Vendet e BE-së	Vendet tjera	Gjithsej
Eksporti (1-24), në '000 €	41,134	30,866	6,074	78,074
Importi (1-24), në '000 €	183,381	411,233	170,742	765,356
Bilanci tregtar, në '000 €	-142,247	-380,367	-164,668	-687,282
Eksporti/Pjesëmarrja në %	53	40	8	100
Importi/Pjesëmarrja në %	24	54	22	100
Mbulueshmëria e importit me eksport (%)	22	8	4	10

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vijim është paraqitur figura ku shfaqet pjesëmarrja e eksportit dhe importit sipas grupeve të shteteve në vitin 2020. Përqindje më e madhe e eksportit është realizuar në vendet e CEFTA-s me pjesëmarrje prej 52.7%, vendet e BE-së 39.5% dhe vendet tjera 7.8%. Importi më i madh ishte nga vendet e BE-së me pjesëmarrje prej 53.7%, nga vendet e CEFTA-s 24.0% dhe vendet tjera 22.3%.

Figura 44: Eksporti sipas grupeve të shteteve (majtas), Importi sipas grupeve të shteteve (djathtas), 2020



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tregtia me vendet e CEFTA-s

Vlera e eksportit në vendet e CEFTA-s ka pasur një rritje të lehtë për periudhën 2016-2020, kështu që në vitin 2020 u arrit vlerë prej 41.1 mil. €, që për dallim nga viti 2019 kishte rritje për 7.2%. Importi nga viti 2018 ka shënuar rënie në vazhdimësi. Në vitin 2020, importi ishte

183.1 mil. €, ku është shënuar rritje në krahasim me vitin 2019 për 62.2%. Mbulueshmëria e importit me eksport ishte 22.4%.

Tabela 73: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s


Vitet	Eksporti (1-24), në '000 €	Importi (1-24), në '000 €	Bilanci tregtar, në '000 €	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2016	29,258	248,550	-219,292	11.8
2017	36,697	258,444	-221,747	14.2
2018	38,762	239,244	-200,482	16.2
2019	38,386	113,072	-74,686	33.9
2020	41,134	183,381	-142,247	22.4

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Pjesëmarrja më e madhe në përqindje prej 64.7% u paraqit në vitin 2016, ndërsa pjesëmarrja më e vogël e eksportit të produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s ishte në vitin 2020 (52.7%),

Importi nga vendet e CEFTA-s kishte pjesëmarrje të përafërt në periudhën 2016-2017, duke vazhduar me rënie në vitin 2018 në 33.6%. Shkalla e pjesëmarrjes në vitin 2019 ishte 14.9%, që njëherazi konsiderohet edhe pjesëmarrje më e vogël e importit për këto vite nga vendet e CEFTA-s. Në vitin 2020, kjo pjesëmarrje është rritur në shkallë prej 24.0% në vlerën e importit të produkteve bujqësore.

Figura 45: Pjesëmarrja e bujqësisë në eksportin e përgjithshëm (majtas), Pjesëmarrja e bujqësisë në importin e përgjithshëm (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore në vendet e CEFTA-s në vitin 2020 ka pasur ndryshime. Rritje të eksportit ka pasur në Maqedoni të Veriut për 11.8%, Shqipëria 8.9% dhe Serbia 3.3%. Rënie në vlerë të eksportit paraqitet me B. Hercegovinën për 15.9% dhe me Malin e Zi 2.9%.

Në tabelën në vijim vërejmë se vlera e importit nga shtetet e CEFTA-s në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, ka pasur rritje nga B. Hercegovina për 412.9% dhe nga Serbia

5,947% dhe Shqipëria 1.7%. Rënie më të madhe të importit kishte nga Maqedonia e Veriut (-20.2%), pasuar nga Mali i Zi (-19.2%). Vlera e importit të produkteve bujqësore nga vendet e CEFTA-s në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 pati rritje për 62.2%.


Tabela 74: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore në vendet CEFTA-s, në '000 €

Vendet	Eksport			Import		
	2019	2020	Ndryshimi '20/'19, (%)	2019	2020	Ndryshimi '20/'19, (%)
B. Hercegovina	1,632	1,372	-15.93	1,825	9,362	412.99
Mali i Zi	1,549	1,504	-2.91	5,547	4,483	-19.18
Maqedonia e Veriut	8,430	9,427	11.83	76,657	61,206	-20.16
Moldavia	-	-	-	321	324	0.9
Serbia	5,953	6,149	3.3	1,325	80,128	5,947
Shqipëria	20,823	22,680	8.9	27,398	27,856	1.7
Gjithsej	38,386	41,132	7.2	113,072	183,359	62.2

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Pjesëmarrje më të madhe në eksportin e vendeve të CEFTA-s ka pasur Shqipëria me 55.1%, Maqedonia e Veriut 22.9%, Serbia 14.9%, B. Hercegovina 3.3% dhe Mali i Zi 3.7%. Në vlerën e importit të produkteve bujqësore pjesëmarrje më të madhe kishin Maqedonia e Veriut (33.4%), Shqipëria (15.2%), B. Hercegovina (5.1%), Mali i Zi (2.4%), Serbia (43.7%) dhe Moldavia (0.2%).

Figura 46: Eksporti sipas vendeve të CEFTA-s (majtas), Importi sipas vendeve të CEFTA-s (djathtas), 2020



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tregtia me vendet e BE-së

Vërehet një rritje e eksportit në vendet e BE-së, e kjo rritje ka vazhduar edhe në vitin 2020, në të cilin vit u arrit vlera e eksportit prej 30.9 mil. €, që është vlera më e lartë e eksportit në vendet e BE-së për vitet e prezantuara në tabelën në vijim. Në vitin 2020 ka pasur rritje të eksportit në vendet e BE-së për 43.4% në krahasim me vitin 2019.

Në vitin 2020, vlera e importit nga vendet e BE-së ishte 411.2 mil. €, ku vërehet një rënie e vlerës së importit nga vendet e BE-së krahasuar me vitin 2019 për 8.4%.


Tabela 75: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore me vendet e BE-së

Vitet	Eksporti (1-24), në '000 €	Importi (1-24), në '000 €	Bilanci tregtar, në '000 €	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2016	11,910	262,402	-250,492	4.5
2017	20,077	275,846	-255,769	7.3
2018	20,892	301,119	-280,226	6.9
2019	21,532	448,882	-427,350	4.8
2020	30,867	411,233	-380,367	7.51

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Pjesëmarrja më e madhe e eksportit në vendet e BE-së në eksportin e përgjithshëm për kapitujt 01-24 ishte në vitin 2020 (39.5%), ndërsa pjesëmarrja më e vogël ishte në vitin 2016 (26.3%). Pjesëmarrja më e lartë e importit nga vendet e BE-së në importin e përgjithshëm për kapitujt 01-24 ka qenë në vitin 2019 (59.1%), ndërsa ajo më e ulët paraqitet në vitin 2017 (42.3%), sa i përket vitit 2020 pjesëmarrja ishte 53.7%.

Figura 47: Pjesëmarrja e bujqësisë në eksportin e përgjithshëm (majtas), Pjesëmarrja e bujqësisë në importin e përgjithshëm (djathtas)




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Vendet ku vlera e eksportit të produkteve bujqësore ishte më e madhe në vitin 2020, janë të radhitura si në vijim: Gjermania në vlerë prej 11.6 mil. €, pasuar nga Italia 3.1 mil. €, Bullgaria 2.8 mil. €, Holanda 2.6 mil. €, Kroacia 1.9 mil. € dhe Austria 1.3 mil. €, si dhe shtetet tjera që shfaqen me vlerë më të vogël të eksportit që janë prezantuar në tabelë. Sa i përket vlerës së eksportit, Gjermania kishte pjesëmarrje prej 38%, Italia 10%, Bullgaria 9%, Kroacia 6%, Austria dhe Suedia me nga 5%, dhe vendet tjera të BE-së me 27%.

Tabela 76: Eksporti sipas vendeve të BE-së në '000 € (majtas) dhe Eksporti sipas vendeve të BE-së në % (djathtas)

	2019	2020	Ndryshimi '20/'19, (%)	Pjesëmarrja në %
Gjermani	7,573	11,603	53	37.6
Bullgari	1,850	2,758	49	8.9
Kroaci	1,682	1,953	16	6.3
Austri	1,624	1,363	-16	4.4
Rumani	916	1,178	29	3.8
Suedi	1,326	1,653	25	5.4
Itali	1,213	3,140	159	10.2
Holandë	1,499	2,557	71	8.3
Mbr. e Bashkuar	1,155	1,507	30	4.9
Hungari	316	335	6	1.1
Vendet tjera në BE	2,378	2,821	19	9.1
Gjithsej BE- 28	21,532	30,866	43	100




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Vendet prej të cilave Kosova ka importuar më së shumti produkte bujqësore në vitin 2020 nga vendet e BE-së ishin: Gjermania në vlerë prej 56.2 mil. €, pasuar nga Polonia 52.2 mil. €, Italia 48.2 mil. €, Kroacia 50.3 mil. €, Sllovenia 34.2 mil. €, si dhe vendet e tjera që janë të shfaqura në tabelën e mëposhtme. Pjesëmarrje më të madhe në import nga vendet e BE-së ka pasur Gjermania 14%, Polonia 13%, Italia 12%, Kroacia 12%, Sllovenia 8% dhe vendet e tjera të BE-së me 36%.

Tabela 77: Importi sipas vendeve të BE-së, në '000 € (majtas) dhe Importi sipas vendeve të BE-së në % (djathtas)

	2019	2020	Ndryshimi '20/'19	Pjesëmarrja në %
Gjermani	59,227	56,248	19	13.7
Poloni	56,706	52,199	18	12.7
Itali	48,110	48,245	20	11.7
Kroaci	58,668	50,313	95	12.2
Slloveni	36,221	34,295	40	8.3
Austri	22,321	19,628	18	4.8
Bullgari	49,430	36,033	234	8.8
Greqi	19,128	18,819	37	4.6
Holandë	14,754	16,268	19	4.0
Hungari	31,954	28,869	160	7.0
Vendet tjera në BE	52,362	50,316	50	12.2
Gjithsej BE 28	448,882	411,233	49	100



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Tregtia me vendet e treta

Përveç vendeve të BE-së dhe vendeve të CEFTA-s, Kosova ka importuar edhe ka eksportuar produkte bujqësore në vitin 2020 edhe nga vendet e treta në sasi shumë të vogël. Duke shikuar trendin e eksportit dhe importit nga këto vende vërehet se Kosova ka rritje të importit dhe rritje të lehtë edhe të eksportit nga viti në vit.

Tabela 78: Importi dhe Importi nga Vendet e Treta


Viti	Eksport (01/24) në 000 E	Import (01/24) në 000 E	Bilanci tregtar në "000'E	Mbulushnëria e importit në eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2014	3,582.58	139,961.82	-136,379.24	0.03
2015	4,214.17	144,692.02	-140,477.85	0.03
2016	4,037.20	147,778.87	-143,741.67	0.03
2017	4,562.70	160,227.36	-155,664.66	0.03
2018	4,295.88	171,951.74	-167,655.86	0.02
2019	5,591.53	197,404.86	-191,813.34	0.03
2020	6,074.47	170,742.56	-164,668.09	0.04

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Eksporti i produkteve bujqësore në vitin 2020 që ishte i orientuar në vendet e Treta ishte 6.1 mil. €. Shtete me pjesëmarrje më të madhe në eksport ishin Zvicra 40%, Turqia dhe SHBA me nga 15%, Iraku 5% dhe të tjera vende nga ky grupim i shteteve që kishin pjesëmarrje prej 25%.

Importi më i madh i produkteve bujqësore nga vendet e Treta në vitin 2020 ishte nga Turqia në pjesëmarrje prej 34%, pasuar nga Brazili 21%, Ekuadori dhe Sri Lanka me nga 5% dhe të tjera vende nga ky grupim i shteteve që kishin pjesëmarrje 35%.

Figura 48: Eksporti në Vendet e Treta, (majtas) dhe Importi nga vendet e Treta, në % (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2.2 Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)

Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)

Eksporti i produkteve bujqësore për kapitujt 01-24 në vitin 2020 ishte 78.1 mil. € dhe për dallim nga viti 2019 kishte një rritje prej 19.2%. Ndryshim më të madh të vlerës së eksportit në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 ka pasur në kapitullin 07 ku përfshihen produktet bujqësore perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve ku paraqitet rritje prej 67%, kapitulli 20 përgatitjet prej perimeve, frutave, arroreve apo pjesëve të tjera të

bimëve kishte rritje për 40% si dhe kapitulli 23 mbetjet nga industritë ushqimore; ushqim foragjer i përgatitur për kafshë ka pasur rritje për 54.2%.

Tabela 79: Eksporti i produkteve bujqësore 2016-2020, në '000 €

Kodi	Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020
01	Kafshët e gjalla	-	-	17	-	-
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	248	183	127	333	337
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore	37	172	110	106	111
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore,	490	492	471	758	841
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	-	-	-	134	4
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	58	165	226	1,170	1,641
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	4,790	4,899	5,636	5,307	8,869
08	Pemët dhe aroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjepit	3,845	8,616	8,781	7,675	9,681
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	2,170	3,677	3,971	4,319	5,890
10	Drithërat	335	262	386	118	513
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	4,172	4,254	2,411	913	1,133
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	1,395	1,558	2,414	3,481	4,064
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale	-	-	-	0	-
14	Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produktet vegjetale të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	8	-	1	5	-
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; yndyrat e ngrënshme të përgatitura; dyllet bimore apo shtazore	9	179	343	1,363	1,433
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jokurrizore ujore	478	618	776	872	1,817
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	804	652	712	696	846
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	2,397	1,909	1,763	1,821	1,449
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pastičerisë	1,904	1,925	1,893	1,785	1,667
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve apo pjesëve të tjera të bimëve	3,757	6,171	4,507	4,556	6,378
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	441	352	612	601	638
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	16,979	24,194	27,565	28,666	29,667
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer i përgatitur për kafshë	888	1,060	1,228	709	1,093
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	-	-	-	122	5
Gjithsej (01-24)		45,205	61,336	63,950	65,510	78,076

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24)

Importi i përgjithshëm i produkteve bujqësore për kapitujt 01-24 ishte në vlerë prej 765.4 mil. €, që krahasuar me vitin 2019 kishte rritje për 0.8%. Rënie të importit ka pasur në kapitujt 02 mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve për 18.2%, kapitulli 07 perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve shënuan rënie për 11.4% dhe kapitulli 13 lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale për 13.6%.

Tabela 80: Importi i produkteve bujqësore 2016-2020, në '000 €

Kodi	Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020
01	Kafshët e gjalla	7,930	10,873	15,502	19,673	30,236
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	57,848	61,986	64,878	74,391	60,824
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore	2,120	2,640	2,999	3,603	4,236
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	41,475	45,069	47,672	49,793	50,800
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	521	915	986	1,313	1,098
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	5,233	4,847	4,566	4,813	5,926
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	23,135	22,934	24,742	28,171	24,957
08	Pemët dhe aroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	32,959	35,069	34,415	36,464	39,185
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	27,467	33,629	31,163	30,051	27,839
10	Drithërat	36,327	31,697	36,434	39,275	41,893
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	12,823	10,822	9,187	10,559	13,689
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	9,661	9,409	10,703	10,434	9,852
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale	305	368	534	447	386
14	Materialet vegjetale që përdoren përthurje; produktet vegjetale të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	10	7	10	8	14
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; yndyrat e ngrënshme të përgatitura; dyllet bimore apo shtazore	27,863	28,362	27,930	30,054	32,135
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jokurrizore ujore	24,844	27,338	26,677	29,853	31,754
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	34,849	35,568	28,296	30,377	30,795
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	22,258	23,485	23,888	24,648	25,509
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pasticerisë apo prej brumërave	60,371	62,925	64,618	66,239	69,975
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve apo pjesëve të tjera të bimëve	24,189	26,373	27,321	28,847	28,130
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	58,796	64,124	68,105	74,635	75,852
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	70,388	75,220	77,152	80,667	76,266
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer i përgatitur për kafshë	19,059	18,736	19,688	16,251	20,903
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	58,301	62,122	64,848	68,793	63,101
Gjithsej (1-24)		658,730	694,517	712,314	759,359	765,357

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

5 Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUV) është autoriteti më i lartë për Ushqim dhe Veterinari i cili është përgjegjës që të mbrojë jetën dhe shëndetin e njerëzve duke siguruar nivel të lartë të sigurisë së ushqimit, përfshirë edhe ushqimin e kafshëve, shëndetin e kafshëve, shëndetin e bimëve, përkujdesjen ndaj kafshëve si dhe cilësinë e ushqimit me prejardhje bimore dhe shtazore. AUV është gjithashtu përgjegjës për të luftuar dhe parandaluar sëmundjet transmetuese midis kafshëve, për të rregulluar praktikën veterinare mjekësore, inspektimin e produkteve me origjinë shtazore, inspektimin e produkteve të importuara, eksportuara, kalimin kalimtar (tranzit) të kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore, të rregullojnë detyrat dhe detyrimet e institucioneve të qeverisjes publike qendrore dhe lokale dhe zyrtarëve të emëruar për të punuar në institucionet e përmendura.

Me miratimin e Ligjit për Ushqimin (seksioni 36), AUV është i lidhur drejtpërdrejtë me Zyrën e Kryeministrit. Në bazë të nenit 38 të këtij ligji, Agjencia është përgjegjëse për të verifikuar dhe inspektuar ushqimin dhe përbërësit e ushqimit në të gjitha nivelet e zinxhirit ushqimor.

Agjencia ka në përbërje pesë Drejtori:

1. Drejtoria e Shëndetit Publik
2. Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve
3. Drejtoria e Inspektoratit (veterinar, fitosanitar dhe sanitar) ku bëjnë pjesë edhe gjashtë zyra regjionale
4. Drejtoria e Laboratorit dhe
5. Drejtoria e Administratës

Institucionet që bashkëveprojnë mbi sigurinë e ushqimit në Kosovë janë: MBPZhR, AUV dhe Ministria e Shëndetësisë (MSh). Brenda MBPZhR-së, Instituti Bujqësor i Kosovës (IBK) dhe DPBT, janë të përfshira edhe në hartimin e politikave të ushqimit. Në kuadër të MSh-së, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP) është i ngarkuar edhe me testimin e ushqimit.

AUV-ë gjatë vitit 2020 ka kryer zbatimin e kontrolleve zyrtare (inspektim, monitorim, survejim, auditim, mostrim), nga ana e inspektoratit veterinar, fitosanitar dhe sanitar sipas legjislacionit nacional i harmonizuar plotësisht me rregulloret, direktivat dhe vendimet e Komunitetit Evropian për fushat përkatëse dhe të cilat janë në funksion të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asoocimit (PKZMSA).

Janë realizuar kontrole zyrtare sipas planeve nacionale, tek operatorët e biznesit me ushqim me veprimtari prodhuese, përpunuese, deponuese, distribuese dhe tek afarizmi me ushqim

në nivelin me pakicë, gjithashtu edhe menaxhimi, koordinimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve me inspektorate, në mbikëqyrje të zbatimit të masave anti COVID-19. Me shfaqjen e Pandemisë COVID-19, AUV ka pasur bashkëpunim dhe koordinim me sektor të niveleve lokale dhe qendrorë të profilit shëndetësor dhe jo shëndetësor, në mbikëqyrje të zbatimit të masave anti COVID-19, janë rritë aktivitetet inspektuese kryesisht të Inspektoratit sanitar. Po ashtu, ka pasur progres edhe implementimi i planit për monitorimin e mbetjeve në ushqim dhe dorëzimi tij në DG Sante, ku më të cilin rast është konstatuar së janë plotësuar pjesa me e madhe e rekomandimeve të Komisionit Evropian, ku janë zbatuar të gjitha rekomandimet e raportit të DG Sante KE, dhe në aspektin tekniko profesional u njoh progresi i madh i AUV-se si një institucion i besueshëm dhe profesional për zbatimin e mandatit dhe radhitet krahas vendeve të treta që i ju lejohet eksporti i produkteve ushqimore me prejardhje shtazore brenda vendeve të Bashkimit Evropian (BE) dhe Zonës Ekonomike Evropiane (EEA).

Në vazhden e aktiviteteve ka qenë implementimi i projektit të Teknologjisë Informative "Mbështetje në përmirësimin dhe operacionalizimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe rritjen e aftësive të tij për zbatimin e qasjes së integruar për sigurinë e ushqimit". Ka vazhduar ndërveprimi i aktiviteteve për ndërtimin Zyrave Regjionale të AUV-së dhe Laboratorit të Nekropsisë, si projekte të financuara nga KE. Bashkëpunimi në Zhvillimin e projektit me përkrahje të Bankës Botërore II Analiza e Riskut Fitosaniatar II, pastaj me përkrahje nga EFSA projekti II SIGMA" dhe projekt rajonal për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve.

Në kuadër të shëndetit publik, ka pasur të arritura edhe në aspektin e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, në zbatim të planit të kontrollit dhe monitorimit të sëmundjeve infektive të kafshëve, sipas programeve paraprake aktive dhe pasive për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e këtyre sëmundjeve përmes programeve të vaksinimit dhe diagnostikimit të sëmundjeve infektive të kafshëve dhe jo vetëm. Aktivitetet të shumta janë kryer edhe tek pjesa e shëndetit të bimëve, duke marr masa adekuate ligjore me veprime në të gjitha Pikat e Kontrollit Kufitar dhe kontrole monitoruese brenda territorit me qëllim të parandalimit të hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm karantinë.

Drejtoria e Shëndetit Publik - ka qenë e përkushtuar në kryerjen e aktiviteteve të saj, në fushën e higjienës së ushqimit me prejardhje shtazore dhe jo shtazore në të gjitha fazat e zinxhirit ushqimor. Janë kryer aktivitete në vlerësimin e infrastrukturës së objekteve ushqimore dhe pajisjeve të punës tek Operatorët e Biznesit me Ushqim (OBU) ka qenë punë e vazhdueshme në kuadër të komisioneve profesionale dhe së bashku me mbikëqyrjen e procedurave të aprovimit dhe regjistrimit. DSHP ka luajtur rolin e saj në drejtim të avancimit të ndërmarrjeve ushqimore, përmirësimin e sistemit të vetëkontrollit duke rritur edhe sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Sektori i Higjienës së Ushqimit me prejardhje Shtazore-ka kryer aktivitete në aprovimin dhe regjistrimin e ndërmarrjeve ushqimore me prejardhje shtazore sipas Rreg.18/2016, ku është punuar në kategorizimin e OBU-ve dhe përditësimin e listës së tyre.

Sipas aktiviteteve që kanë të bëjnë me ruajtjen e ushqimit (depo Ftohëse), përpunimin e mishit përpunimin e qumështit, pika grumbulluese të qumështit, therjen e kafshëve (thertore) dhe për përpunimin e peshkut. Në vijim gjeni tabelën ku është bërë përshkrimi i Objekteve të aprovuara të ushqimit me prejardhje shtazore dhe aktiviteti i tyre.

Tabela 81: Objekte të aprovuara të ushqimit me prejardhje shtazore dhe aktiviteti i tyre

Depo ftohëse	Përpunues mishi	Përpunues qumështi	Grumbullues qumështi	Therrtore	Përpunues peshku
2	7	5	1	8	1
Gjithsej					24

Burimi: AUV

Gjithsej gjatë vitit 2020, janë regjistruar 112 biznese të ushqimit me prejardhje jo shtazore sipas veprimtarisë së ndryshme, siç janë prodhuesit e lëngjeve, prodhuesit e pijeve alkoolike, përpunuesit e pemëve dhe perimeve, prodhuesit e bukës (fabrika dhe furra buke), restorantet (aktivitetet gastronomike), depot ushqimore për ruajtjen e ushqimit dhe depot ftohëse ushqimore, aktivitetet e shitjes së ushqimit me pakicë (maketet), fabrikat e përpunimit të drithërave (mullinjtë), prodhuesit produkteve konditorike dhe të ëmbëlsirave, ri paketuesit e ushqimit si dhe aktivitetet tjera (specifike) të ushqimit me prejardhje jo shtazore.

Tabela 82: Regjistrimi i bizneseve të ushqimit me prejardhje jo shtazore

Objektet e regjistruara	Nr.
Prodhues të lëngjeve	3
Prodhues të pijeve alkoolike	6
Përpunues i pemëve dhe perimeve	30
Furra dhe fabrika të prodhimit të bukës	16
Restorante -aktivitete gastronomike	
Depo ushqimore	5
Depo ftohëse ushqimore	2
Markete ushqimore	28
Mullinjë	9
Prodhues të konditorive dhe ëmbëlsirave	9
Ri paketues të ushqimit	2
Të tjera veprimtari specifike	2
Gjithsej	112

Burimi: AUV

Tabela 83: Realizimi i programeve dhe aktiviteteve të vaksinimit

Lloji i vaksinimit	Emri i vaksinës	Lloji i kafshëve të vaksinuara	Nr. i kafshëve të vaksinuara
Brucelozë	Ocurev /Revl	Dele dhe dhi	48.841 krerë
Tërbim	Biocan/Bioveta	Qen	20.000 qen
MKD/CSF	Pestisen /Bioveta	Derra	10.176 krerë
Anthrax	Romvac	Gjedhe, dele, dhi	1663 krerë
Tërbim - vaksinim nga ajri	Biocan / Bioveta	Kafshët e egra dhelprat	485.000 karem vakcina

Burimi: AUV

Tabela 84: Marrja e mostrave të gjakut dhe dërgimi në laboratorin e AUV-se

Emërtimi i analizave laboratorike	Nr. mostrave
Analizat patologjike	14
Analizat serologjike, plani nacional Bruceloz, Leukoza dhe FMD	8,758
Analizat serologjike, dyshimi për sëmundje të kafshëve në terren	5,677
Analizat bakteriologjike	293
Karantina	380
Gjithsej	15,122

Burimi: AUV

Tabela 85: Asgjësimi i kafshëve të cilat kanë rezultuar pozitiv në sëmundjet infektive

Emërtimi i sëmundjes	Lloji i kafshës	Nr. shpërthimeve -ferma	Të asgjësuar	Gjithsej
Brucela abortus	Gjedhe	27	196	196
Brucela melitensis	Dele	2	98	98
Brucela melitensis	Dhi	2	19	19
Anthrax	Gjedhe	1	1	1
TBC	Gjedhe	24	132	132
Pesta Amerikane	Blete	28	367	367
Gjithsej				813

Burimi: AUV

Sa i përket lëshimit të lejeve të importit për kafshët e gjalla, materialit gjenetik dhe ushqimit për kafshë janë lëshuar gjithsej 522 leje.

Tabela 86: Numri i lejeve të lëshuara nga shëndeti i kafshëve

Emërtimi i lejeve të importit	Nr. i lejeve
Importi i kafshëve të gjalla	197
Importi i ushqimit për kafshë	234
Import i materialit gjenetik	7
Import i gjedheve për reproduksion	20
Import i zogjve një ditor	45
Importi i derrave për therje	2
Import i kuajve për rekreacion	4
Importi qenët zyrtar	2
Importi i viçave për majmëri	11
Gjithsej	522

Burimi: AUV

Aktivitetet e licencimit dhe ri-licencimit të subjekteve, kanë vazhduar sipas procedurave ligjore të vlerësuara nga komisioni profesional, ku për vitin 2020, gjithsej janë licencuar/aprovuar 21 subjekte që janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 87: Licencimi i subjekteve afariste sipas kërkesave të parashtruara

Nr.	Emërtimi i licencave	Nr. i Licencave/aprovimeve
1	Licencimi i ambulantëve veterinarë, vazhdimi i licencave	17
2	Licencimi i depos për grumbullimin e leshit të deleve	1
3	Licencimi i depove të lëkurave	1
4	Licencimi i operatorëve për ushqim për kafshë	2
Gjithsej		21

Burimi: AUV

Në bazën e të dhënave të sektorit I&R janë raportuar 42,302 lëvizje (shitje-blerje) të gjedheve, 57,321 lëvizje të deleve, 6,579 lëvizje të dhive dhe 4,495 lëvizje të derrave. Ndërsa sa i përket therjeve të kafshëve rezulton se numri i therjeve të gjedheve ishte 30,151, dele 60 dhe dhi 54.

Tabela 88: Raportimi i therjeve, importi dhe lëvizja e kafshëve

Lloji i Kafshës	Therje 2020				Import 2020		Lëvizje 2020			
	Gjedhe	Dhi	Dele	Derra	Gjedhe	Dele	Gjedhe	Dhi	Dele	Derra
Gjithsej	30,151	54	60	3,279	57,693		42302	6,579	57,321	4,495

Burimi: AUV

Nga Drejtoria e Inspektoratit raportohet se në vitin 2020 janë kryer gjithsej 65,545 inspektime dhe gjithashtu janë marrë 6,876 mostra.

Tabela 89: Numri i inspektimeve dhe mostrave të marra nga Drejtoria e Inspektoratit

Brendshme		Importi		Gjithsej	
Inspektime	Mostra	Inspektime	Mostra	Inspektime	Mostra
9,879	5,470	55,666	1,406	65,545	6,876

Burimi: AUV

Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë gjatë vitit 2020 ka realizuar aktivitetet laboratorike sipas planit të punës. Janë pranuar 31,268 mostra, ka testuar 31,239 mostra dhe 177,398 parametra të testuar. Në këto mostra përfshihen cilësia e qumështit, mikrobiologjia e ushqimit, kimia e ushqimit, patologjisë, sektori i bakteriologjisë dhe histopatologjia.

Tabela 90: Numri i mostrave të pranuar, parametrave të testuar, lëshimi i raporteve të testimit nga LUV, 2020

Aktiviteti	Cilësia e qumështit	Mikrobiologjia e ushqimit	Kimia e ushqimit	Patologjisë	Spektori i Bakteriologjisë	Patologjia, Histopatologjia	Gjithsej
Mostra të pranuar	17,145	257	656	86	1210	11,914	31,268
Mostrat të testuar	17,145	256	628	86	1210	11,914	31,239
Parametra të testuar	152,530	1435	514			22,919	177,398

Burimi: AUV

Nga ky laborator gjatë vitit 2020 janë pranuar gjithsej 16,521 mostra të qumështit bazuar në përmbajtje, janë testuar 31,239 mostra dhe 177,398 parametra tjerë të testuar. Në këto mostra përfshihen cilësia e qumështit, mikrobiologjia e ushqimit, kimia e ushqimit, patologjisë, sektori i bakteriologjisë dhe histopatologjia.

Tabela 91: Rezultatet e cilësisë së qumështit ngarkesa bakteriale

Klasifikimet NKB, 2020										
Muaji	Klasa Ekstra		Klasa e I		Klasa e II		Klasa e III		Gjithsej mostra	Mostrat e pa analizuara
	≤80.000		≤100.000		≤300.000		≤500.000			
	Nr.i mostrave	%	Nr. i mostrave	%	Nr. i mostrave	%	Nr. i mostrave	%		
Gjithsej	6,999	42.4	525	3.18	2,444	15	6,553	39.7	16,521	624

Burimi: AUV

Tabela 92: Klasifikimi i qumështit sipas qelizave somatike, 2020

Klasifikimi i qumështit QS								Nr. i përgjithshëm i mostrave	Nr. i mostrave të pa analizuara
Muaji	Ekstra ≤ 300.000		Klasa I ≤ 400.000		Klasa II ≤ 500.000		Klasa III ≤ 750.000		
	Nr. i mostrave	%	Nr. i mostrave	%	Nr. i mostrave	%	Nr. i mostrave	%	
Gjithsej	4,741	38.5%	994	8.1%	847	6.9%	5,722	46.5%	12,304

Burimi: AUV, *për shkak të defektit të pajisjes milko-scan ky numër i mostrave është analizuar pas rregullimit të pajisjes

5.1 Emetimi i gazrave serrë në Kosovë

Deri me tani Kosova përmes MMPHI-së, ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të përmbushur nevojën për monitorimin e ndryshimeve klimatike, adaptimin ndaj tyre dhe zbutjen e ndikimeve që vijnë nga këto ndryshime. Në kuadër të legjislacionit shtetëror për ndryshime klimatike, aktualisht është duke u punuar ligji për klimën, ndërsa aspekte që ndërlidhen me ndryshimet klimatike janë përfshirë në legjislacionin mjedisor përkatës duke përfshirë Ligjin e Mjedisit, Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligjin e Ujërave dhe Ligjet tjera relevante.

Sistemi i menaxhimit të gazrave serrë (GHG) udhëhiqet nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe i raporton institucioneve vendore dhe të jashtme, për politikën e zhvillimit dhe politikën e mbikëqyrjes. Në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare, gjithnjë e më sfiduese për zvogëlimin e emetimeve dhe masave për zhvillimin e gjelbërimit është përdorimi i Regjistrit GHG në Kosovë që luan rol kyç në mbështetjen e synimeve të Kosovës për zhvillimin e gjelbërimit dhe kontributin e saj për agjendën ndërkombëtare për mbrojtjen e vendit dhe njëkohësisht edhe botën nga ndryshimet klimatike.


Emetimet e përgjithshme vjetore të gazrave serrë në Kosovë për vitin 2019 janë vlerësuar rreth 9,613 Gg (Giga gram) CO₂ eq, (equivalent) ose rreth 9.6 milion ton CO₂ eq. Burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë është sektori i energjisë me pjesëmarrje prej 86% të totalit të emetimeve. Sektori i dytë është ai i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës me 8%. Sektori i mbeturinave përfaqëson 5% të totalit të emisioneve kurse sektori i proceseve industriale dhe përdorimit të produkteve me rreth 1%.

Tabela 93: Emetimet e përgjithshme të gazrave të serrës në Kosovë sipas sektorëve, 2019

Emetimet e GHG në Kosovë për vitin 2019	Gg CO ₂ eq.
Energjia	8,624
Proceset industriale dhe përdorimi i produkteve	130
Bujqësia, pylltaria dhe përdorimi i tokave	773
Mbeturinat	457
Totali i emetimeve	9,613

Burimi: Raport, Emetimi e Gazrave Serrë në Kosovë 2019

Figura 49: Emetimi i GHG sipas sektorëve, 2019 (%)



Burimi: Raport, Emetimi e Gazrave Serrë në Kosovë 2019

Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokave, përfshin rreth 8% të emetimit të përgjithshëm të gazeve serrë në Kosovë. Në vitin 2019, janë regjistruar rreth 706 Gg CO₂ eq., përkatësisht 706 mijë ton CO₂ eq.

Sektor i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokave i takon kategorisë së tretë (3) të emetimeve të gazrave të serrës sipas IPCC dhe përbëhet nga tri nën sektorë (kategori) tjera. Nën sektori i parë 3A përfshinë emetimin nga bagëtia. Këtu bëjnë pjesë kryesisht emetimet nga fermentimi enterik (procesi digjestiv i kafshëve) dhe emetimet nga menaxhimi i plehrave të kafshëve. Nga ky nën sektor vijnë rreth 545 Gg CO₂ eq. në vit ose 77% e totalit të emetimeve. Emetimet e gazrave serrë për këtë nën-sektorë janë kalkuluar sipas metodologjisë IPCC, duke zbatuar faktorët e emisionit sipas metodologjisë përkatëse.

Nën-sektori i dytë 3B trajton akumulimin e CO₂ nga tokat pyjore dhe tokat tjera, si dhe emetimet që rrjedhin nga konvertimi i tokës nga një kategori tek tjetra. Është i vetmi sektor që bënë reduktimin (akumulimin) e emetimeve të CO₂ me rreth -39 Gg CO₂ të kalkuluar gjatë vitit 2019. Emetimet dhe akumulimet e CO₂ për këtë kategori janë kalkuluar sipas metodologjisë IPCC 2006, duke zbatuar faktorët e emisionit relevant, duke llogaritur ndërrimet në stoqet e karbonit sipas kategorive të shfrytëzimit të tokave, dhe përmes zbatimit të matricës së konvertimit të tokave sipas kategorive.

Nën-sektori 3C trajton emetimet nga fertilizimi i tokës dhe nga djegia e biomasës. Kategoritë më të rëndësishme të këtij nën-sektori janë emetimet indirekte të oksidit të azotit që lidhen me menaxhimin e plehrave dhe fertilizimin e drithërave. Gjithsej, ky nën-sektor emeton rreth 156 Gg CO₂ eq. në vit, ose rreth 22% të totalit të emetimeve. Emetimet e gazrave serrë për këtë sektorë janë kalkuluar sipas metodologjisë IPCC, duke zbatuar faktorët e emisionit sipas metodologjisë përkatëse.

Sipas nën-kategorive, fermentimi enterik (procesi digjestiv i kafshëve), përbën 67% të emetimeve ose 476 Gg CO₂ eq., i pasur nga emetimet direkte të N₂O nga menaxhimi i tokës

(dheut) me 12% (89 Gg CO₂ eq), si dhe emetimet nga menaxhimi i plehut të kafshëve me rreth 10% (69 Gg CO₂ eq.). Në tabelën më poshtë janë dhënë detaje të emetimeve sipas nën-kategorivetë këtij sektori.

Metanit (CH₄) me pjesëmarrje prej rreth 86% të totalit, është gazi kryesor i emetuar që vjen kryesisht nga nën-kategoria e fermentimit enterik, menaxhimi i plehut të kafshëve dhe djegia e biomasës, i pasur nga Oksidi i Dyazotit (N₂O) me 11%, që emetohet nga nën-kategoritë që kanë të bëjnë me menaxhimin e plehut të kafshëve dhe menaxhimi i tokës dhe Dyoksidi i Karbonit (CO₂) me 3%, që emetohet kryesisht nga përdorimi i UREA-s.


Tabela 94: Burimet kryesore të emetimeve të gazrave serrë në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokave sipas sektorëve dhe nën sektorëve për vitin 2019

Kategoritë e emetimeve	Nën kategoritë e emetimeve	CO ₂ Gg eq	%	Gazat e emetuara sipas kategorive		
				CO ₂	CH ₄	N ₂ O
3. A- Bagëtia	Fermentimi Enterik (procesi digjestiv i kafshëve)	476	67	-	+	-
	Menaxhimi i plehut të kafshëve	69	10	-	+	+
3. B-Toka	Tokat pyjore	-39				
	Tokat tjera (bujqësore, kullotat, etj)	5	1	+	-	-
3. C -Burimet e agreguara dhe burimet e emetimit të jo-CO ₂ në tokë	Emisionet direkte të N ₂ O nga menaxhimi i tokës (dheut)	89	12	-	-	+
	Emisionet indirekte të N ₂ O nga menaxhimi i tokës (dheut)	33	5	-	-	+
	Emisionet indirekte të N ₂ O nga menaxhimi i plehut të kafshëve	9	1	-	-	+
	Aplikimi i UREA-s	19,5	3	+	-	-
	Djegia e biomasës	5,5	1	-	+	+
Totali i emetimeve		706	100	3%	86%	11%

Burimi: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Inventari i Emetimeve të Gazrave Serrë në Kosovë

Bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën në vijim vërejmë se trendi i emetimeve për periudhën 2007-2019, ka pasur ndryshime mes periudhave kohore. Prirje e përafërt e rritjes së emetimeve të gazrave të serrës nga sektori i bujqësisë ishte nga viti 2007 deri në vitin 2012, pasuar me një rënie në vitin 2013. Rritje paraqitet nga viti 2014, duke vazhduar me trend të ngjashëm përgjatë periudhës 2014-2019.

Figura 50: Trendi i emetimeve totale të gazrave të serrës nga sektori i bujqësisë 2007-2019



Burimi: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Inventari i Emetimeve të Gazrave Serrë në Kosovë

Burimet kryesore të informatave (të dhënave aktive) për kalkulimin e emisioneve nga sektori i bujqësisë dhe plehërimi i tokave përbëjnë të dhënat për numrin e bagëtive sipas kategorive përkatëse, të dhënat për format e menaxhimit të plehut të stallës, të dhënat për sasi të vjetore të urea-s dhe plehrave të përdorura për plehërim, të dhënat për prodhimin bujqësor, të dhënat për sipërfaqet e djegura sipas kategorive të tokave si dhe disa të dhëna për klimën dhe temperaturën mesatare vjetore.

Burimi kryesor i këtyre të dhënave për kalkulimin e emetimeve të gazrave të serrës nga sektori i Bujqësisë për kategorinë 3A dhe 3C është Anketa e Ekonomive Bujqësore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Mundësitë kryesore për reduktimin e emisioneve nga ky sektor janë zvogëlimi i sipërfaqeve të djegura sipas kategorive të tokave, menaxhimi më efikas i plehut të stallës dhe përdorimi i kontrolluar i plehrave.

Të dhënat kryesore për kalkulimin e akumulimit dhe emetimit të CO₂ nga nën-sektori 3B (tokat pyjore dhe tokat tjera) janë nga inventari i pyjeve të Kosovës, nga mbulueshmëria e tokave (CLC) dhe të dhënat nga Agjencia e Statistikave mbi ndryshimin e destinimit të tokave. Kategoritë e shfrytëzimit të tokave nga këto burime janë përshtatur me kategoritë relevante të shfrytëzimit të tokave sipas IPCC.

Ky sektor konsiderohet si një ndër sektorët më sfidues në inventarit kombëtar të emetimeve, në aspektin e metodologjive, kërkesave të dhënave, burimit dhe pasigurive që lidhen me vlerësimet për emetimet. Problemi kryesor sa i përket të dhënave të nevojshme për përmirësimin e inventarit për këtë sektor është mungesa e të dhënave vjetore specifike për secilën nga kategoritë e të dhënave të përmendura më lart, si dhe mungesa e përvojës në këtë sektor.

Bashkëpunimi ndër institucional, angazhimi i ekspertëve të sektorit dhe realizimi i trajnimeve specifike do të ishin të nevojshme për të përmirësuar inventarin e të dhënave të gazrave serrë nga ky sektor. Mundësitë kryesore për reduktimin e emisioneve nga ky sektor janë zvogëlimi i prerjeve ilegale të pyjeve dhe ruajtja e destinimit të shfrytëzimit të tokave sipas kategorive.

6 Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural

6.1 Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2020 ka vazhduar të mbështes sektorin e bujqësisë bazuar në dy programet e hartuara: Programin e Pagesave Direkte dhe Programin e Zhvillimit Rural. Mbështetja përmes pagesave direkte është bërë për kultura bujqësore (mbështetja bëhet në bazë të hektarëve të kultivuar përveç për mjedrin që mbështetja është bërë në bazë të sasisë), krerë blegtoral (mbështetja bëhet për krerë ndërsa tek qumështi në bazë të kategorisë së cilësisë si dhe mbështetja për therjet e raportuara), inpute (fidanë të prodhuara) si dhe mbështetja për verë të prodhuar dhe sigurim bujqësor për mjedër, mollë, kumbull, rrush, dredhëz dhe spec. Përmes granteve janë mbështetur investimet në sektorin primar, por edhe në industrinë përpunuese dhe zhvillim të turizmit në zona rurale si dhe ujitje të tokave bujqësore.

Duke marr parasysh se në vitin 2020 vendi ynë si edhe çdo vend tjetër u përball me pandeminë Covid-19, në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike është implementuar masa 4A – Dyfishimi i buxhetit për Programin e Pagesave Direkte vetëm për vitin 2020, e që kjo masë kishte një buxhet në vlerë prej 24 mil. €.

Me qëllim të implementimit të masës 4A, në shtator të vitit 2020 Qeveria mori vendimin që implementimi i kësaj mase të bëhet në atë mënyrë që dyfishohen vlerat e pagesave direkte (subvencioneve) për secilën kulturë/masë të paraparë në Programin e Pagesave Direkte për vitin 2020, krahasuar me vlerat e vitit 2019.

Në tabelën e mëposhtme janë të prezantuara pagesat për njësi të subvencionuar në bazë të Programit të Pagesave Direkte 2020 dhe Vendimeve të marr për implementimin e Masës 4A në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike. Në rastin e verës ende nuk është bërë pagesa e dytë në kuadër të PRE dhe kjo do të bëhet në kuadër të Programit të Pagesave Direkte 2021 bazuar në vendimin nr. 07/61 të datës 03.02.2021 andaj edhe pagesa për njësi është 0.04 €/litër e njëjtë si ka qenë në PPD 2020.

Tabela 95: Buxheti për pagesa direkte për njësi të subvencionuar duke përfshirë edhe PRE, 2020

Buxheti për njësi të subvencionuar*		
1	Grurë	300 €/ha
2	Farë gruri	500 €/ha
3	Elb	300 €/ha
4	Thekër	300 €/ha
5	Tërshërë	300 €/ha
6	Misër	300 €/ha
7	Luledielli	300 €/ha
8	Vreshta ekzistuese	2,000 €/ha
9	Verëra	0.04 €/liter
10	Pemishte ekzistuese	800 €/ha
11	Mjedër	0.16 €/kg
12	Fidane	0.40 €/fidanë
		0.30 €/fidanë
		0.20 €/fidanë
13	Perime	Perime në fushë të hapur 600 €/ha
		Perime në serra 600 €/ha
14	Bimë mjekësore dhe aromatike	450 €/ha
15	Bujqësi organike	1,000 €/ha
16	Lopë dhe buallica qumështore	140 €/krerë
17	Dele	30 €/krerë
18	Dhi	30 €/krerë
19	Bletë	30 €/koshere
20	Qumësht	Klasa ekstra - 0.12 €/litër
		Klasa I - 0.08 €/litër
		Klasa II - 0.04 €/litër
21	Pula vojse	1.00 € dhe 0.80 €/pulë vojse
22	Thëllëza	1.00 €/thëllëzë
23	Dosa	40 €/krerë
24	Therje të raportuara të gjedhit	100 €/krerë
25	Akuakulturë	0.40 €/kg
26	Primi i sigurimit bujqësor	100% e primit të sigurimit

Burimi: Programi për Pagesave Direkte 2020; Vendimi 03/33, datë 28.09.2020; Vendimi 06/61 datë 03.02.2021

*Buxheti për njësi të subvencionuar paraqet pagesën për njësi të kalkuluar pas vendimit për zbatim të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike

Në vitin 2020 totali i mbështetjes përmes pagesave direkte ishte 67.05 mil. €. Krahësuar me vitin paraprak mbështetja është rritur më shumë se dyfishi e kjo ka ndodhur për shkak të dyfishimit të pagesave direkte për njësi në kuadër të PRE por edhe asaj se ka pasur rritje të njësive të subvencionuara tek disa sektorë të mbështetur.


Tabela 96: Pagesat direkte 2016-2020, në €

	2016	2017	2018	2019	2020
Grurë	7,526,999	5,781,300	6,550,929	5,292,996	14,079,396
Farë gruri	196,678	122,003	114,204	140,395	434,540
Misër	2,870,969	3,311,579	3,227,784	4,122,464	8,547,885
Elb	25,118	38,662	77,688	73,194	132,645
Thekër	19,977	16,957	29,343	29,423	58,623
Tërshërë	-	-	-	139,161	396,261
Luledielli	1,316	7,946	749	14,621	12,036
Vreshta ekzistuese	2,117,978	2,266,235	2,580,250	2,988,810	6,160,400
Perime	1,981,617	2,244,228	2,693,021	2,488,506	5,525,712
Pemishte ekzistuese	1,112,032	1,599,496	1,905,548	1,656,812	3,805,736
Mjedra	-	-	-	71,883	168,854
Verë	-	55,024	190,774	389,375	228,452
Bimë mjekësore dhe aromatike	-	-	-	-	111,479
Bujqësi organike	14,626	35,373	277,578	524,900	1,672,210
Lopë qumështore	4,609,990	4,777,500	4,746,770	4,373,460	9,421,300
Buallica	-	-	-	17,920	48,580
Dele dhe dhi	1,933,245	2,112,810	2,298,615	2,411,520	5,129,550
Bletë	2,158,770	2,295,555	2,471,085	3,070,950	6,996,810
Pula vojse	346,259	435,035	484,343	537,497	1,165,861
Thëllëza	22,083	29,013	18,280	14,044	23,678
Dosa	14,040	17,180	27,320	28,100	75,080
Qumësht	1,082,829	1,712,609	1,736,944	2,041,145	2,570,392
Therje të raportuara të gjedhit	15,780	18,350	48,900	48,550	62,700
Akuakulturë	-	84,053	86,068	89,598	66,950
Fidane	76,933	68,459	82,046	69,600	155,495
Primi i sigurimit bujqësor	-	-	-	-	1,769
Gjithsej	26,127,237	27,029,367	29,648,239	30,634,922	67,052,392

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në periudhën 2016-2020, subvencionet kanë shënuar rritje të vazhdueshme, e kjo si rezultat i mbështetjes së sektorëve të ri por edhe rritjes në sektorët e mbështetur më parë. Në vitin 2020, përveç pagesave direkte për luledielli, verë dhe akuakulturë të gjitha kategoritë e tjera shënuan ngritje në krahasim me vitin 2019. Në vitin 2020 subvencionet arritën vlerën 67.05 mil. €, prej të cilave rreth 62% kanë qenë për kultura bujqësore duke përfshirë edhe verën, fidanet si dhe primin e sigurimit ndërsa 38% kanë qenë për sektorin e blegtorisë.


Figura 51: Pagesat direkte 2016-2020, në 1000 €



Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në vitin 2020, shpërndarja e pagesave direkte është si në figurën më poshtë. Shuma më e madhe e subvencioneve ishte ndarë për grurin (21%), pasuar nga lopët qumështore (14%), misri (13%), bletë (10%), vreshta (9%) dhe pjesa tjetër prej 33% tek kulturat dhe sektorët e tjerë.

Figura 52: Pagesat direkte sipas sektorëve 2020, në mil. €




Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

6.2 Pagesat direkte/subvencionet

Gjithsej numri i fermerëve aplikues në vitin 2020 ishte 30,702, prej të cilëve ishin 28,489 fermerë përfitues (93%) dhe 2,213 të refuzuar (7%).

Figura 53: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve në vitin 2020



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në skemën e mëposhtme është i paraqitur numri i njësive të subvencionuara përmes pagesave direkte në vitin 2020.



6.2.1 Pagesat direkte për kulturat bujqësore, verë dhe sigurim bujqësor

Në vitin 2020, shuma totale e pagesave direkte për kultura bujqësore duke përfshirë verën dhe sigurimin bujqësor ishte 41.3 mil. €. Pjesëmarrje më të madhe në totalin e pagesa direkte për kultura bujqësore kishin gruri (34%), misri (21%), vreshtat (15%), perimet (13%), pemishtet (9%) ndërsa kulturat e tjera kishin pjesëmarrje prej 8% në totalin e pagesave direkte për kultura bujqësore. Në përgjithësi shikuar njësitë e subvencionuara, të gjithë kulturat dhe sektorët e mbështetur kanë shënuar rritje përveç sipërfaqes me elb dhe luledielli që kanë shënuar ulje si dhe numri i litrave të verës së subvencionuar.

Subvencionimi i bimëve mjekësore dhe aromatike për herë të parë ka filluar në vitin 2020 me nga 450 €/ha dhe në këtë rast nuk ka pasur dyfishim të pagesës me PRE.

Tabela 97: Pagesat direkte sipas sektorëve, 2016-2020


		2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 në %
Grurë	Numri i aplikuesve	11,864	9,709	10,683	8,872	11,044	24
	Numri i përfituesve	11,602	9,216	10,311	8,698	10,729	23
	Numri i ha të paguar	50,180	38,542	43,673	35,287	46,931	33
	Pagesa për ha	150	150	150	150	300	100
	Shuma totale e paguar	7,526,999	5,781,300	6,550,929	5,292,996	14,079,396	166
Farë gruri	Numri i aplikuesve	25	11	11	15	25	67
	Numri i përfituesve	25	11	11	15	24	60
	Numri i ha të paguar	803	508	458	562	869	55
	Pagesa për ha	250	250	250	250	500	100
	Shuma totale e paguar	196,678	122,003	114,204	140,395	434,540	210
Misër	Numri i aplikuesve	7,985	8,598	8,432	9,526	10,020	5
	Numri i përfituesve	7,763	8,231	8,165	9,370	9,808	5
	Numri i ha të paguar	19,140	22,077	21,519	27,483	28,493	4
	Pagesa për ha	150	150	150	150	300	100
	Shuma totale e paguar	2,870,969	3,311,579	3,227,784	4,122,464	8,547,885	107
Elb	Numri i aplikuesve	151	227	316	273	242	-11
	Numri i përfituesve	133	208	306	267	233	-13
	Numri i ha të paguar	251	387	518	488	442	-9
	Pagesa për ha	100	100	150	150	300	100
	Shuma totale e paguar	25,118	38,662	77,688	73,194	132,645	81
Thekër	Numri i aplikuesve	77	78	83	70	59	-16
	Numri i përfituesve	61	67	72	67	56	-16
	Numri i ha të paguar	200	170	196	196	195	0
	Pagesa për ha	100	100	150	150	300	100
	Shuma totale e paguar	19,977	16,957	29,343	29,423	58,623	99
Tërshërë	Numri i aplikuesve	-	-	-	505	569	13
	Numri i përfituesve	-	-	-	485	538	11
	Numri i ha të paguar	-	-	-	928	1,321	42
	Pagesa për ha	-	-	-	150	300	100
	Shuma totale e paguar	-	-	-	139,161	396,261	185

Vreshta	Numri i aplikuesve	2,980	2,969	3,012	2,939	2,919	-1
	Numri i përfituesve	2,881	2,909	2,949	2,900	2,880	-1
	Numri i ha të paguar	2,473	2,508	2,580	2,989	3,080	3
	Pagesa për ha	1,000/400	1,000/500	1,000	1,000	2,000	100
	Shuma totale e paguar	2,117,978	2,266,235	2,580,250	2,988,810	6,160,400	106
Luledielli	Numri i aplikuesve	2	7	5	11	5	-55
	Numri i përfituesve	2	6	4	11	3	-73
	Numri i ha të paguar	9	53	5	97	40	-59
	Pagesa për ha	150	150	150	150	300	100
	Shuma totale e paguar	1,316	7,946	749	14,621	12,036	-18
Perime	Numri i aplikuesve	5,304	5,716	6,664	7,270	4,676	-36
	Numri i përfituesve	5,188	5,550	6,435	7,099	4,481	-37
	Numri i ha të paguar	6,605	7,481	8,977	8,295	9,210	11
	Pagesa për ha	300	300	300	300	600	100
	Shuma totale e paguar	1,981,617	2,244,228	2,693,021	2,488,506	5,525,712	122
Pemishte ekzistuese	Numri i aplikuesve	2,908	4,358	5,278	3,557	3,166	-11
	Numri i përfituesve	2,794	4,110	5,097	3,488	3,034	-13
	Numri i ha të paguar	2,780	3,999	4,764	4,142	4,757	15
	Pagesa për ha	400	400	400	400	800	100
	Shuma totale e paguar	1,112,032	1,599,496	1,905,548	1,656,812	3,805,736	130
Bujqësi organike	Numri i aplikuesve	7	10	37	27	48	78
	Numri i përfituesve	3	6	24	26	38	46
	Numri i ha të paguar	73	118	443	1,050	1,672	59
	Pagesa për ha	200	+300	+500	500	1,000	100
	Shuma totale e paguar	14,626	35,373	277,578	524,900	1,672,210	219
Bimë mjekësore dhe aromatike	Numri i aplikuesve	-	-	-	-	84	-
	Numri i përfituesve	-	-	-	-	70	-
	Numri i ha të paguar	-	-	-	-	248	-
	Pagesa për ha	-	-	-	-	450	-
	Shuma totale e paguar	-	-	-	-	111,479	-
Verë	Numri i aplikuesve	-	18	16	15	18	20
	Numri i përfituesve	-	7	14	15	17	13
	Numri i litrave të paguara	-	1,375,607	4,769,358	9,734,385	5,711,290	-41
	Pagesa për litër	-	0.04	0.04	0.04	0.04	0
	Shuma totale e paguar	-	55,024	190,774	389,375	228,452	-41
Mjedër	Numri i aplikuesve	-	-	-	967	525	-46
	Numri i përfituesve	-	-	-	594	386	-35
	Numri i kg të paguara	-	-	-	898,547	1,055,337	17
	Pagesa për kg	-	-	-	0.08	0.16	100
	Shuma totale e paguar	-	-	-	71,883	168,854	135

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në figurën e mëposhtme është paraqitur shuma mesatare e subvencioneve për një përfitues, ku shihet se mesatare më të lartë kishin përfituesit për bujqësi organike kanë me 44 mijë € pasuar nga përfituesit e farës së grurit me 18 mijë €, verës me 13 mijë €, ndërsa mesatare më të ulët për përfitues, përkatësisht nën 1,000 € kishin misri, tërshëra, elbi dhe mjedra.


Figura 54: Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2020



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në shumicën e rasteve ishte nën 5 ha, me përjashtim të lulediellit, farës së grurit dhe bujqësisë organike ku sipërfaqja mesatare e subvencionuar ishte e lartë sepse numri i përfituesve ishte i vogël ndërsa sipërfaqja e subvencionuar mjaftë e madhe.

Figura 55: Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2020



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Sigurimi bujqësor

Gjatë vitit 2020, MBPZhR vazhdoi subvencionimin e primit të sigurimit për polisat e sigurimit. Krahas mjedrës (ku ky lloj subvencioni u përfshi për herë të parë në Programin e Pagesave Direkte 2019), masa e subvencionimit të primit u zgjerua për të mbuluar edhe 5 produktet e tjera të sigurimit indeks. Produktet e sigurimit indeks që mbulojnë mollën, kumbullën, rrushin, specin dhe dredhëzën janë përfshirë në PPD 2020. Në kuadër të këtij programi, MBPZhR mbuloi pesëdhjetë për qind (50%) të kostos së polisës së sigurimit (primit) për të gjithë fermerët që kanë blerë sigurime bujqësore në vitin 2020 dhe pastaj me vendimin për dyfishim të pagesave direkte në kuadër të masën 4A të PRE, rimbursimi i polisave të sigurimit u bë në masën 100% të kostos së polisës.

Zbatimi i kësaj mase subvencionimi është planifikuar si më poshtë: 1) fermerët blejnë polisat e sigurimit së pari dhe paguajnë vetë çmimin e plotë, 2) më pas ata aplikojnë për skemën e subvencionit për të marrë më vonë kompensimin e kostos së polisës nga MBPZhR.

Në kuadër të kësaj mase kanë përfituar 5 fermerë nga gjithsej 9 sa kanë aplikuar. Këta fermerë kanë marrë një kompensim prej 100% për koston e sigurimit të tyre, ku MBPZhR ka shpërndarë gjithsej 1,769 €. Fermerët morën si subvencion mesatarisht 354 €, duke filluar nga minimumi prej 30 € deri në 1,527 €.

MBPZhR është e përkushtuar të mbështesë të gjithë fermerët që blejnë polisat e sigurimit, si një mënyrë për të zbutur rreziqet e tyre të prodhimit dhe për të siguruar vazhdimësinë e bizneseve bujqësore.

6.2.2 Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht

Shuma e pagesave direkte për sektorin e blegtorisë në vitin 2020 ishte 25.6 mil. €, 102.3% më e lartë sesa në vitin 2019. Nga gjithsej pagesat direkte për blegtori, 37% ishin për lopë qumështore, 27% për bletari, 20% për delet dhe dhitë, 10% për qumësht sipas cilësisë dhe 6% për kategoritë tjera të subvencionimit. Në vitin 2019, pjesëmarrja e pagesave direkte për blegtori në totalin e pagesave direkte është 38%.

Në përgjithësi shikuar njësitë e subvencionuara, të gjithë sektorët e mbështetur kanë shënuar rritje përveç thëllëzave, therjeve të raportuara të gjedhit, akuakulturës dhe qumështit sipas cilësisë që kanë shënuar ulje.

Tabela 98: Pagesat direkte sipas sektorëve, 2016-2020


		2016	2017	2018	2019	2020	Ndryshimi 2020/2019 në %
Lopë qumështore	Numri i aplikuesve	7,981	7,778	7,595	6,775	7,027	4
	Numri i përfituesve	7,650	7,546	7,395	6,606	6,905	5
	Numri i krerëve të paguar	65,857	68,250	67,811	62,478	67,295	8
	Pagesa për krerë	70	70	70	70	140	100
	Shuma totale e paguar	4,609,990	4,777,500	4,746,770	4,373,460	9,421,300	115
Buallica	Numri i aplikuesve	-	-	-	6	5	-17
	Numri i përfituesve	-	-	-	6	4	-33
	Numri i krerëve të paguar	-	-	-	256	347	36
	Pagesa për krerë	-	-	-	70	140	100
	Shuma totale e paguar	-	-	-	17,920	48,580	171
Dele dhe dhi	Numri i aplikuesve	1,325	1,367	1,436	1,380	1,515	10
	Numri i përfituesve	1,273	1,334	1,378	1,355	1,469	8
	Numri i krerëve të paguar	128,883	140,854	153,241	160,768	170,985	6
	Pagesa për krerë	15	15	15	15	30	100
	Shuma totale e paguar	1,933,245	2,112,810	2,298,615	2,411,520	5,129,550	113
Dosa	Numri i aplikuesve	137	151	210	216	251	16
	Numri i përfituesve	121	130	202	211	235	11
	Numri i krerëve të paguar	702	859	1,366	1,405	1,877	34
	Pagesa për krerë	20	20	20	20	40	100
	Shuma totale e paguar	14,040	17,180	27,320	28,100	75,080	167
Bletë	Numri i aplikuesve	2,378	2,595	3,007	3,411	3,941	16
	Numri i përfituesve	2,353	2,467	2,764	3,238	3,634	12
	Numri i koshereve të paguara	143,918	153,037	164,739	204,730	233,227	14
	Pagesa për koshere	15	15	15	15	30	100
	Shuma totale e paguar	2,158,770	2,295,555	2,471,085	3,070,950	6,996,810	128
Pula vojse	Numri i aplikuesve	86	88	88	85	84	-1
	Numri i përfituesve	78	80	81	82	84	2
	Numri i pulave vojse të paguar	783,531	960,955	1,023,671	1,181,829	1,310,235	11
	Pagesa për pulë vojse	0.50/0.40	0.50/0.40	0.50/0.40	0.50/0.40	1.00/ 0.80	-
	Shuma totale e paguar	346,259	435,035	484,343	537,497	1,165,861	117

Thëllëza	Numri i aplikuesve	7	13	13	13	11	-15
	Numri i përfituesve	6	13	13	9	10	11
	Numri i thëllëzave të paguar	22,083	29,013	36,560	28,088	23,678	-16
	Pagesa për thëllëzë	1.00	1.00	0.50	0.50	1.00	100
	Shuma totale e paguar	22,083	29,013	18,280	14,044	23,678	69
Qumësht	Numri i aplikuesve	1,552	2,700	3,116	1,836	1,062	-42
	Numri i përfituesve	1,552	2,700	3,055	1,798	1,060	-41
	Numri i litrave të paguara	-	-	34,522,414	38,664,480	24,464,477	-37
	Pagesa për litër	0.06/0.04/0.02	0.06/0.04/0.02	0.06/0.04/0.02	0.06/0.04/0.02	0.12/0.08/0.04	-
	Shuma totale e paguar	1,082,829	1,712,609	1,736,944	2,041,145	2,570,392	26
Therje të raportuar të gjedhit	Numri i aplikuesve	9	6	28	14	11	-21
	Numri i përfituesve	9	6	24	13	9	-31
	Numri i krerëve të paguar	526	367	978	971	627	-35
	Pagesa për krerë	30	50	50	50	100	100
	Shuma totale e paguar	15,780	18,350	48,900	48,550	62,700	29
Akuakulturë	Numri i aplikuesve	-	4	8	8	4	-50
	Numri i përfituesve	-	4	5	8	3	-63
	Numri i kg të paguar	-	420,264	430,341	447,990	167,376	-63
	Pagesa për kg	-	0.20	0.20	0.20	0.40	100
	Shuma totale e paguar	-	84,053	86,068	89,598	66,950	-25

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në figurën e mëposhtme është paraqitur shuma mesatare e subvencioneve për një përfitues, ku shihet se mesatare më të lartë kishin përfituesit për akuakulturë me 22 mijë € pasuar nga përfituesit për pula vojse me 14 mijë €, për buallica me 12 mijë €, ndërsa mesatare më të ulët për përfitues, përkatësisht nën 5,000 € kishin përfituesit e deleve dhe dhive, qumështit, thëllëzave, bletëve, lopëve qumështore dhe dosave.


Figura 56: Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2020



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues është e paraqitur në figurën e mëposhtme ku shihet se sa i përket krerëve mesatare më e lartë është në rastin e deleve dhe dhive, pasuar nga buallicat, therjet e raportuara të gjedhit, lopët qumështore dhe dosat.

Figura 57: Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2020



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

6.2.3 Mbështetja e inputeve në bujqësi

Mbështetja e fidanëve

Gjithsej shuma e pagesave direkte për fidanë në vitin 2020 ishte rreth 156 mijë €, krahasuar me vitin 2019 është rritur më shumë se dyfishi e kjo për për shkak të dyfishimit të pagesës për njësi por edhe asaj se numri i fidanëve të subvencionuara është rritur.. Numri më i madh i fidanëve të subvencionuar është në regjionin: Gjakovës (48%), Pejës (34%), Gjilanit (14%) dhe Prizreni (4%), ndërsa në regjionet e tjera nuk ka pasur fare aplikues.

Mesatarja e fidanëve për të cilat një fermer ka përfituar ishte rreth 36 mijë fidanë, më e ulëta ishte në regjionin e Gjilanit (17 mijë fidanë), ndërsa më e larta në regjion të Gjakovës (56 mijë fidanë).

Tabela 99: Pagesat direkte për fidanë sipas regjionit, 2020

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr. i fidaneve të subvencionuara	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	-	-	-	-
2	Prizren	1	1	21,000	8,400
3	Pejë	4	4	157,909	60,298
4	Mitrovicë	-	-	-	-
5	Gjakovë	4	4	223,135	59,937
6	Ferizaj	-	-	-	-
7	Gjilan	4	4	67,150	26,860
	Gjithsej	13	13	469,194	155,495

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

6.3 Agro kreditë dhe fondi garantues

6.3.1 Agro Kreditë

Bujqësia moderne është thelbësore për zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Zhvillimi i bujqësisë është i mundur kur fermerëve u mundësohet dhënia e kredive me kushte të favorshme për blerjen e teknologjisë moderne që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e prodhimit bujqësor.

Bujqësia vazhdon të ketë qasje të ulët në financimin e përgjithshëm bankar me vetëm 2.2% për vitin 2020 (0.6 pikë përqindje më e ulët se viti paraprak) pra, sektor që më së paku është kredituar nga institucionet financiare në Kosovë. Te Institucionet Mikrofinanciare (IMF) gjendja është më ndryshe, pjesëmarrja në agrokredi është 12.1% për vitin 2020.

Agro kreditë njihen si kredi joperformuese dhe për këtë arsye kreditimi ka një kosto të lartë nga bankat dhe institucionet mikrofinanciare për fermerët. Ky nivel i ulët i kreditimit vë në pah qasjen konservatore të sistemit bankar kundrejt sektorit të bujqësisë. Mungesa e sistemit adekuat të sigurimeve në bujqësi po ashtu ndikon mjaft në qasjen e fermerëve në kredi, respektivisht në kredi të volitshme.

Me qëllim të shtimit të efektivitetit në fermë, fermerët kanë nevojë të zgjerojnë më shumë nivelin e financimit të investimeve të tyre në: rritjen e fondit të bagëtive, rregullim dhe zgjerim të fermave me standarde evropiane, energji solare, blerje të pajisjeve dhe makinerive bujqësore të teknologjisë së re, blerje të inventarit, blerje të inputeve, krijimi i pikave grumbulluese, depo-frigo ruajtëse dhe shumë pajisje tjera bujqësore. Investimet e tilla në fermë, u mundësojnë fermerëve rritjen e produktivitetit dhe njëkohësisht përgatitjen për sezonin e ri bujqësor. Përmes investimeve të ndryshme në këtë sektor, do të mundësohet përmirësimi i mirëqenies në zonat rurale, shtimi i prodhimit vendor gjë që ndikon në zëvendësimin e produkteve të importit, krijimit të mundësive për eksport si dhe mbajtjen e fuqisë së re punëtore.

Bankat që mbështesin financiarisht me kredi sektorin e bujqësisë në Kosovë janë: Banka për Biznes, Banka Ekonomike, Raiffeisen Bank (RBKO), Procredit Bank (PCB), TEB Bank, NLB Prishtina dhe Banka Kombëtare Tregtare (BKT), ndërsa Institucionet Mikrofinanciare janë: Agjencioni për Financim në Kosovë (AFK), Finca, KosInvest World Vision, KEP Trust, KGMAMF, Kreditimi Rural i Kosovës (KRK), Qelim Kosovë dhe Start Finance.

Lider në shumën e Agrokredive të disbursuara është TEB, PCB, BPB, BKT dhe RBKO, pasuar nga IMF-të: KRK, AFK, Finca, KEP etj. Në tabelë shihet se më së shumti kredi janë disbursuar në vitin 2019. Shuma totale e kredive të disbursuara në vitin 2019 është mbi 115 mil. €. Numri i kredive të dhëna që nga viti 2016 deri në vitin 2020 është mbi 115 mijë kredi me një shumë totale prej 462.4 mil. €. Pra, për këto 5 vite, i bie që çdo muaj janë disbursuar mesatarisht rreth 1,900 kredi, shuma mesatare mujore prej 7.7 mil. €.


Tabela 100: Agrokreditë 2016 – 2020

Agro Kredi 2016 - 2020	Numri i kredive të disbursuara	Shuma totale e kredive të disbursuara (mn €)	Kohëzgjatja e kredisë (muaj)	Norma mesatare e interesit (%)	Pjesëmarrja e Agro Kredive në krahasim me kreditë tjera (%)
2016	19,086	81.4	12 - 42	8.0 - 26.9	0.5 - 60.0
2017	24,940	91.3	17 - 39	7.3 - 26.7	0.3 - 43.0
2018	26,403	91.3	12 - 39	6.0 - 28.5	1.3 - 64.5
2019	21,622	115.1	18 - 42	6.4 - 28.4	0.7 - 43.5
2020	22,958	83.2	18 - 40	5.3 - 28.6	0.5 - 36.7
Gjithsej	115,009	462.4			

Burimi: Bankat komerciale dhe IMF në Kosovë, përpunuar nga DAESB

Nga të dhënat në tabelë dhe figurë, shihet qartë që viti 2019 dhe 2020, dallojnë mjaft me dhënie të kredive (rënie për 27.7%). Nëse krahasohet viti 2020 me vitin 2016, vërehet një rritje mjaft e ulët për vetëm 2.2%.

Figura 58: Shuma totale dhe numri i agrokredive të disbursuara (mil. € dhe '000)



Burimi: Bankat komerciale & IMF në Kosovë, BQK

Afati i dhënies së kredive bujqësore ndryshon nga 18 deri 40 muaj, varësisht prej destinimit të kredisë. Normat e interesit ndryshojnë nga 5.3% deri në 28.4% bazuar në shumën e kredisë dhe afatin e kthimit. Prodhuesit bujqësor vazhdojnë të kenë pakënaqësi për normat e interesit, të cilat nuk ndikojnë në stimulimin e zhvillimit të këtij sektori.

Kolaterali zakonisht nuk kërkohet për shuma të vogla të kredisë. Për shuma mesatare dhe të mëdha, nga bankat dhe IMF-të kërkohet kolateral prej 100% deri në 388% të shumës së kredisë, ndërsa në vitet e fundit ka pasur normalizim të dukshëm. Në përgjithësi si standard për kolateral kërkohet prej huadhënësit nga 100% deri 150% e vlerës së kredisë.


Grejs periudha apo periudha e shtyrjes së pagesës, varion nga 3 deri në 12 muaj, megjithëse në disa publikime figuron 18 muaj, varësisht nga rastet ku grejs periudha është fleksibile. Vlen të theksohet se shlyerja e përqindjes më të madhe të kredive bëhet pas sezonit të korrijës. Ndër vite, vërehet që grejs periudha ishte më e ulët kurse në vitet e fundit ka ngritje të saj.

Pjesëmarrja e kredive në bujqësi në krahasim me kredi të tjera, nëpër Banka dhe IMF dallon shumë. Te Bankat, deklarimi i pjesëmarrjes është nga 0.5% deri në 16.5%, që është shembull i mirë. Te IMF-të, deklarimi i pjesëmarrjes varion nga 4.5% në 36.7%, që si mesatare është mbi 25%.

Huamarrja në banka dhe IMF me norma të interesit ndryshojnë varësisht nga shuma e kredisë dhe maturiteti i saj. Sa më e madhe është shuma dhe sa më e shkurtë është kohëzgjatja e kredisë, aq më e ulët është norma (kamata) e interesit si dhe e kundërta.

Nga figurat e mëposhtme shihen dallimet në shifra mes Bankave komerciale dhe IMF-ve.


Figura 59: Shuma e agrokredive nga Bankat dhe IMF, mil. €



Burimi: Banka & IMF, përpunuar nga DAESB

Bankat karakterizohen me numër më të vogël të kredive por me shuma më të mëdha, që i bie se mesatarja për kredi për vitin 2020 ishte 19,600 €. Te IMF-të, mesatarja për kredi është 1,700 €, rrjedhimisht, numër të madh të kredive por me shuma më të vogla, gjë që arrihet baraspesha e interesave gati për çdo fermer.


Figura 60: Numri agrokredive nga Bankat dhe IMF, '000 €



Burimi: Banka & IMF, përpunuar nga DAESB

Kamatat në kredi dhënie për sektorin bujqësor janë të larta në krahasim me kreditë e sektorëve tjerë dhe me vendet e regjionit, megjithëse viti 2020 u karakterizua me rënie të lehtë të normës së interesit për 0.5 pikë përqindje krahasuar me vitin 2019, e kjo rënie e normës së interesit nuk ndikon si stimulim për fermerët kur dihet që dallimi me kredi biznesi ende është i lartë (2.3 pikë përqindje).

Figura 61: Norma e interesit në kredi bujqësore nga Bankat dhe IMF, %



Burimi: BQK

Kamatat në kredi dhënie për sektorin bujqësor të IMF-ve për vitin 2020, u karakterizuan me rënie të normës së interesit për 1.95 pikë përqindje, krahasuar me vitin paraprak apo për 4.3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2016.

Sa i përket përqindjes së pjesëmarrjes së kredive të këqija tek agrokreditë, mund të themi se janë në nivelin e pranueshëm brenda limiteve të përcaktuara nga shumica e bankave dhe institucioneve financiare. Krahasuar me vendet e rajonit, jemi në një nivel shumë të kënaqshëm.

Ndër vite te Bankat, maksimumi i kredive të këqija ishte rreth 5%, ndërsa te IMF-të është dukshëm më i lartë. Pozicionimet e institucioneve financiare që nga viti 2006 i gjeni në botimet e mëhershme.

6.3.2 Fondi garantues

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural u jep përkrahje investimeve në bujqësi, duke garantuar për kreditë e fermerëve. Në përfundim të vitit 2012, falë bashkëpunimit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim - BERZh (European Bank for Reconstruction and Development – EBRD), me iniciativën e Autoritetit të Zhvillimit të Kredisë - DCA nga USAID-i dhe MBPZhR, që kishin synim uljen e normës së interesit për kredi (rreth 3%) po ashtu, duke garantuar në 50% të vlerës së kredive bujqësore.

Për të ofruar garanci të kredisë në marrëveshje me gjashtë bankat kryesore të Kosovës në lëshimin e kredive dhe njëherit, duke e rritur qasjen për kredi në bujqësi dhe agrobiznese, ky fond kontribuon në vlerë të përgjithshme me 26 mil. \$ (rreth 23.5 mil. €), ku MBPZhR ka pjesëmarrje me 2.5 mil. €. Programi i USAID-it, ka ofruar mundësi të reja në bujqësi për një periudhë katër vjeçare fillimisht, me qëllim të krijimit të kushteve më të volitshme kreditore në sektorin e bujqësisë, zhvillim të qëndrueshëm bujqësor, rritje të eksportit, krijim të vlerës së shtuar dhe krijim të vendeve të reja të punës.

Fermerët, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme bujqësore (NVM) janë përballur me procedura të lehtësuara për marrje të kredive për shkak se DCA, ka siguruar një garanci të rrezikut prej 50% për kreditë e lëshuara nga këto banka me kohëzgjatje 12-60 muaj dhe me shuma nga 5,000 deri në 250,000 € për fermerët dhe agrobizneset e kualifikuara. Programi ishte dizajnuar për rritje të kreditimit në sektorin bujqësor, duke parë vështirësitë në këtë segment.

Për sigurim të kredisë, nga bankat ulen kërkesat për kushtet e kolateralit. Kohëzgjatja e kredisë rritet, ndërsa vërehet dukshëm ulja e normës së interesit mesatarisht për 3 deri 4% nga norma standarde e interesit për kredi në bujqësi.

Aplikimi i DCA-së ishte një hap pozitiv i cili çoj përpara dhe lehtësoj kredi dhënien për zhvillimin e bujqësisë dhe agrobizneseve, duke u nisur nga vet fakti që edhe vendet e rajonin kishin nisur ta aplikojnë këtë model. Sipas të dhënave të fundit që i posedojmë, 5 banka i kanë shfrytëzuar plotësisht këto mjete, me rreth 1,000 kredi pra, 97% e shumës totale e Fondit Garantues të shfrytëzuar.

Për këto vite, vërehet një pasqyrë e re e hua dhënies me zbritje të kamatës nga ana e bankave, por jo edhe nga institucionet mikrofinanciare. Falë angazhimit dhe bashkëpunimit të BQK-

së, MBPZhR-së, USAID-it, etj., është arritur ulje e interesit bankar në kredi dhënie për sektorin bujqësor dhe lehtësime në dhënien e tyre.

Projekti ka arritur në përfundim me 97.2% të shumës së gjithmbarshme të realizuar, me shumë mesatare të disbursuar 24,945 \$, në total me 992 kredi. Nga tërë kjo vërehet efekti pozitiv i projektit ku është pasqyruar rënia e kamatës së kredive bujqësore për këto vite.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore - FKGGK

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është entitet juridik i pavarur me karakter zhvillimor, i cili ofron garanci kreditore për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM), duke ndarë riskun kreditor me institucionet financiare.

Një ndër objektivat më të rëndësishme për FKGGK-në është mbështetja e zhvillimit të sektorit të Bujqësisë përmes garantimit të agro kredi dhënies. Që të ndihmohet në arritjen e këtyre objektiveve dhe të fuqizohet kredi dhënia për fermerë dhe agrobiznese, banka zhvillimore gjermane KfW ka nënshkruar kontratë me FKGGK për rritjen e kapitalit të FKGGK-së që do të përdoret për përkrahjen e këtij sektori duke u fokusuar në të gjitha hallkat e zinxhirit të shtimit të vlerës brenda këtij sektori. Për më tepër kjo përkrahje në rritjen e kapitalit të FKGGK-së duke e fuqizuar Dritaren Agro ka vazhduar edhe më tej.

Duke filluar nga Dhjetori 2018, FKGGK ka nënshkruar marrëveshje me 7 Institucione Financiare Partnere (IFP) të FKGGK-së që janë aktive në agro kredi dhënie për Dritaren Agro që është program i veçantë për këtë sektor me kushte shumë të volitshme të garantimit të kredive agro. Në fund të vitit 2020, ka filluar procesi i regjistrimit edhe të 2 Institucioneve Mikrofinanciare që kreditojnë sektorin e bujqësisë në vend.

Gjatë vitit 2020, janë miratuar gjithsejtë 7,15 mil. € kredi të reja nga IFP-të në sektorin e bujqësisë të cilat janë vënë nën garancionin e FKGGK-së. Kjo paraqet rreth 28 % rënie të volumit të kredive të garantuara krahasuar me vitin paraprak 2019, e cila rënie vjen si rrjedhojë e uljes së kreditimit gjatë periudhës së pandemisë. Vlen të theksohet që në kuartalin e parë të vitit 2020 kur akoma nuk kishte filluar pandemia, volumi i agro kredive të garantuara ishte për 49% më i lartë krahasuar më të njëjtin kuartal të vitit paraprak. Financimi, e si rrjedhojë edhe garantimi i agro kredive u ngadalësua shumë gjatë kuartalit të dytë, për të vazhduar me rritje të garantimit gjatë kuartalit të tretë dhe atij të fundit të vitit 2020.

Shuma mesatare e kredive të garantuara në sektorin e bujqësisë gjatë 2020, ishte rreth 36,000 € me maturitet mesatar 35.7 muaj (rritje nga 32.2 muaj që ishte një vit më herët).


Shpërndarja rajonale e 7.15 mil. € të kredive të lëshuara nga IFP-të dhe të garantuara nga FKGGK, në rajone të ndryshme për sektorin e bujqësisë gjatë vitit 2020 është si në vijim:

Tabela 101: Shpërndarja rajonale e kredive të miratuara

Shpërndarja rajonale	Kreditë e miratuara, €
Prishtinë	4,041,000
Prizren	807,100
Pejë	631,500
Mitrovicë	726,700
Gjakovë	381,000
Gjilan	220,900
Ferizaj	337,000
Gjithsejt	7,145,200

Burimi: FKGGK

Figura 62: Proporcioni i shpërndarjes së kredive, %



Burimi: FKGGK

Gjatë vitit 2020, nga 197 agro kredi të garantuara nga ana e FKGGK-së, IFP-të parashihnin mbi 5.6 mil. € rritje të qarkullimit të klientëve të tyre nga investimet e bëra si dhe 388 vende të reja pune të deklaruara mbi bazën e tanishme.

Përpos garantimit të financimit bujqësor, FKGGK ju mundëson institucioneve financiare edhe përkrahje për një analizë sa më të saktë gjatë financimit bujqësor duke ngushtuar hendekun e asimetrisë së informacionit ndërmjet fermerit, institucionit financiar dhe tregut. Si rezultat i këtij synimi, FKGGK në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ka lansuar në fillim të Tetorit platformën dinamike AgroSoft, e cila është mbështetur nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW). Kjo platformë është zhvilluar nga personeli i FKGGK-së në bashkëpunim me MBPZhR dhe është e lehtë për t'u përdorur, dinamike dhe e qasshme nga pajisje të ndryshme elektronike (desktop, laptop, tablet apo smartfon), si dhe e përditësuar me të dhënat më të reja rreth çmimeve shitëse dhe rendimentit të produkteve bujqësore.

6.4 Sigurimet në fushën e bujqësisë

Pajisja e fermerëve me një polisë sigurimi është një mundësi unike për të ndihmuar zhvillimin e bujqësisë në vend, si dhe për të rritur qasjen në financa për të gjithë fermerët kosovarë dhe për të krijuar mundësi të reja për të tejkaluar rreziqet me të cilat përballen çdo ditë. Sistemi i sigurimeve bujqësore të Kosovës po forcon bazat e tij, duke sjellë praktikën më të mira ndërkombëtare në hartimin e produkteve më të përshtatshme për fermerët kosovarë.

Produktet Indeks të Sigurimit Bujqësor

Viti 2019 ka shënuar një vit shumë të rëndësishëm për sektorin e sigurimeve në Kosovë, pasi që për herë të parë fermerët kosovarë ishin në gjendje të blinin një polisë sigurimi dhe të mbronin prodhimet e tyre nga ngjarjet e pafavorshme të motit. Kultivuesit e mjedres mund të konsiderohen si "pionierët" e sistemit të sigurimeve bujqësore në Kosovë, pasi ata ishin fermerët e parë që blenë sigurime për të mbrojtur pëmishtet e tyre. Në të njëjtën kohë, kjo fazë shërbeu si një fazë testimi për të kontrolluar nëse produkti i zhvilluar dhe sistemi në përgjithësi po funksiononin siç ishte planifikuar. Në përgjithësi, faza pilotuese e skemës së sigurimeve ishte e suksesshme, duke arritur objektivat e saj të para-planifikuara.

Më pas, në vitin 2020 (viti i parë pas fazës pilot të sigurimeve), skemës së sigurimeve iu bashkuan një numër i përgjithshëm prej pesëdhjetë e katër (54) fermerësh. Këto polisa sigurimi u lëshuan për katër produkte të ndryshme sigurimi indeks, mjedër, spec, rrush dhe mollë. Poliset e lëshuara kanë ofruar mbrojtje/sigurim në lokacione të ndryshme të Kosovës, konkretisht në 12 komuna dhe 18 rrjete të ndryshme.

Njëzet e gjashtë (26) fermerë të mjedres blenë sigurime për pëmishtet e tyre. Gjithsej, një sipërfaqe prej 5.24 ha të kultivuara me mjedër ishte siguruar, me sipërfaqe minimale të siguruar prej 0.10 ha dhe maksimale deri në 0.40 ha. Në përgjithësi, në vitin 2020, sipërfaqja mesatare e siguruar me mjedër ishte 0.20 ha. Për të mbrojtur këtë sipërfaqe të kultivimit të mjedres, fermerët e mjedres paguan një çmim mesatar prej 34 € për polisën e sigurimit, duke filluar nga një vlerë minimale prej vetëm 9 € deri në një maksimum prej 164 €. Shuma totale e sigurimit arriti vlerën prej 9,956 €. Krahasuar me vitin 2019, numri i fermerëve që kanë siguruar pëmishtet e tyre me mjedër është dyfishuar, ku sipërfaqja totale e siguruar me mjedër është rritur me 72%, ndërsa shuma totale e sigurimit është rritur me 67%.


Në vitin 2020, për herë të parë kultivuesit e specit blenë poliset e sigurimit indeks për të mbrojtur sipërfaqet e tyre të kultivimit nga reshjet e tepërta. Tetë (8) fermerë, kultivues të specave kanë blerë sigurime, me sipërfaqe mesatare të siguruar prej 0.24 ha, duke filluar me një sipërfaqe minimale prej 0.20 ha deri në 0.54 ha, për të siguruar një sipërfaqe totale prej 1.94 ha. Për të mbrojtur këtë sipërfaqe të kultivimit të specit, fermerët paguan mesatarisht 49 € për polisën e sigurimit, duke filluar nga një çmim minimal prej 27 € deri në 140 €. Shuma totale e sigurimit arriti vlerën prej 5,044 €.

Ngjashëm, në të njëjtën periudhë, nëntëmbëdhjetë (19) fermerë të rrushit blenë për herë të parë polisat e sigurimit indeks për të mbrojtur vreshtat e tyre nga ngricat pranverore. Është siguruar një sipërfaqe e përgjithshme prej 4.63 ha me vreshta, me sipërfaqe minimale të siguruar prej 0.20 ha dhe maksimale deri në 1.03 ha. Në përgjithësi, në vitin 2020, sipërfaqja mesatare e siguruar e vreshtit ishte 0.24 ha. Kultivuesit e vreshtave paguan mesatarisht vetëm 22 € për të mbrojtur sipërfaqet e tyre të kultivimit të rrushit, me çmime që varionin nga minimumi 18 € deri në maksimum 91 €. Shuma totale e sigurimit ka arritur vlerën prej 6,019 €.

Gjatë së njëjtës periudhë, gjithashtu një prodhues mollësh bleu një polisë sigurimi indeks për të mbrojtur pemishten e tij nga ngricat e pranverës për një sipërfaqe prej 4 ha. Ky kultivues mollash ka paguar 1,528 € si premi për një shumë totale të sigurimit prej 12,000 €.

Në përgjithësi, në vitin 2020, 54 fermerë blenë polisat indeks të sigurimit për të mbrojtur një sipërfaqe totale prej 15.81 ha. Sipërfaqja mesatare e siguruar ishte 0.29 ha. Këta fermerë kanë paguar gjithsej 3,221 € si premi, ndërsa shuma totale e sigurimit ka arritur në vlerën prej 33,019 €. Krahasuar me vitin 2019, numri i fermerëve që kanë siguruar sipërfaqet e tyre të kultivimit është katërfishuar, sipërfaqja totale e siguruar është rritur për pesë herë, ndërsa shuma totale e sigurimit është rritur për pesë herë e gjysmë.

Figura 63: Sipërfaqja totale e siguruar në ha dhe nr. i fermerëve të siguruar



Burimi: Sistemi Informativ i Sigurimit Bujqësor (SISB)

Dëmet/humbjet dhe Pagesat e Dëmshpërblimit

Ashtu si në vitin 2019, polisat e sigurimit të mjedrës kishin një periudhë vlefshmërie nga data 1 korrik deri më 31 gusht 2020 - gjithsej 62 ditë mbulim rreziku ndaj temperaturave të larta prej 29°C e lart për 10 ditë rresht. Vera e vitit 2020 në Kosovë u shoqërua me temperatura relativisht të larta. Prandaj, në disa lokacione të Kosovës janë prekur kufijtë e sigurimit (parametrave të motit). Nga 11 rrjete ku janë lëshuar polisat e sigurimit për mjedrën, në 8 rrjete janë aktivizuar/prekur kufijtë e sigurimit. Megjithatë, këta kufijtë ishin të pamjaftueshëm për të marrë pagesa të dëmshpërblimit sepse nuk ishin prekur në 10 ditë rresht.

Polisat e sigurimit për specin kishin një periudhë vlefshmërie nga data 15 maj deri më 10 qershor 2020 - gjithsej 27 ditë mbulim rreziku ndaj reshjeve të tepërta. Nga 4 rrjete ku janë lëshuar polisat e sigurimit të specit, kufijtë e sigurimit nuk janë aktivizuar në asnjërin prej këtyre vendndodhjeve. Prandaj, për këtë vit nuk janë shpërndarë pagesa të dëmshpërblimit për specin.

Për sa i përket vreshtave, polisat e tyre të sigurimit kishin një periudhë vlefshmërie nga data 20 mars deri më 15 maj 2020 - gjithsej 57 ditë mbulim rreziku ndaj ngricave pranverore. Polisat e sigurimit janë lëshuar në një rrjet (komuna e Rahovecit) dhe në këtë lokacion nuk janë aktivizuar kufijtë e sigurimit - rrjedhimisht nuk janë shpërndarë pagesa për dëmshpërblim. Ngjashëm për kultivuesit e mollëve, polisat e tyre të sigurimit kishin një periudhë vlefshmërie nga data 20 mars deri më 15 maj 2020 - gjithsej 57 ditë mbulim rreziku ndaj ngricave pranverore. Polisat e sigurimit janë lëshuar në një rrjet (komuna e Kamenicës) dhe nuk janë shpërndarë pagesa të dëmshpërblimit pasi nuk janë aktivizuar kufijtë.

Krahasuar me vitin e kaluar, ku 33% e fermerëve të siguruar kanë marrë dëmshpërblim për humbjet në pemishtet e tyre, këtë vit, fermerët e siguruar nuk kanë marrë dëmshpërblim pasi nuk janë prekur kufijtë - rrjedhimisht nuk ka pasur humbje nga rreziqet e siguruara.

Produktet Tradicionale të Sigurimit Bujqësor

Në vitin 2019 u përfunduan dy produkte tradicionale të sigurimit (kundër breshërit) duke ofruar mbulim të rrezikut për dy frutat kryesore të kultivuara në Kosovë, Mollën dhe Rrushin. Ndërsa në vitin 2020 u zhvillua një tjetër produkt tradicional (kundër breshërit) - produkt sigurimi kundër breshërit për kultivuesit e specit. Këto tre produkte sigurimesh do të mbrojnë pemishtet e mollëve, vreshtat e rrushit dhe zonat e kultivimit të specit nga breshëri. Mbulimi i sigurimit të breshërit do të ofrojë mbrojtje kundër dëmtimeve fizike nga breshëri, dhe në shumë raste do të përfshijë mbulim edhe për disa sëmundje të cilat rezultojnë si ndikim i breshërit.

Produktet janë dizajnuar për të mbuluar periudhat më kritike kur vendi mund të preket nga stuhi të ndryshme dhe në këtë mënyrë të paguajë dëme në rast të dëmtimit të pemishteve,

vreshtave dhe sipërfaqeve të tjera të hapura të kultivimit. Produktet tradicionale të sigurimit bujqësor për mollët, rrushin dhe specin do të tregtohen vitin e ardhshëm (2021), duke u mundësuar fermerëve që të kenë këtë mjet financiar shumë të rëndësishëm.

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Duke qenë se trajnimi i vlerësuesve të humbjeve filloi për herë të parë në fund të vitit 2018, në vitin 2020 ka vazhduar trajnimi i vlerësuesve të humbjeve për të mbuluar produktin tradicional të sigurimit për spec. Trajnimi i vlerësuesve të humbjeve ka krijuar një platformë të qëndrueshme për funksionalizimin e produkteve tradicionale të sigurimeve për treg.

Kampanjat Publike Vetëdijësuese

Si pjesë e projektit të sigurimit të bujqësisë, në vitin 2020, IFC në bashkëpunim të ngushtë me MBPZhR-në organizoi dhe zbatoi disa ngjarje në kuadër të marrëdhënieve me publikun në të gjithë Kosovën. Qëllimi i këtyre ngjarjeve ishte zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe rritja e ndërgjegjësimit për sigurimet në bujqësi.

Janë mbajtur disa lloje të ngjarjeve përfshirë fushatat e ndërgjegjësimit të publikut, ditë të hapura me fermerët, trajnime dhe takime me akterë të ndryshëm. Në përgjithësi, në vitin 2020, një numër prej 157 personave morën pjesë në një total prej 13 ngjarjeve të organizuara. Disa prej këtyre ngjarjeve u organizuan në mënyrë virtuale për shkak të situatës pandemike.

Krahas këtyre ngjarjeve, është krijuar edhe një kanal në YouTube për sigurimin e bujqësisë në Kosovë. Deri më tani janë ngarkuar 5 video që mbulojnë dy produkte të sigurimit indeks, dhe procedurat e nevojshme për lëshimin e një polisë sigurimi. Deri më sot, ky kanal është vizituar gjithsej nga 635 persona.

Sistemi Informativ i Sigurimeve Bujqësore

Projekti ka zhvilluar dhe funksionalizuar Sistemin Informativ të Sigurimeve Bujqësore si një bazë e funksionimit të qartë dhe transparent të sistemit të sigurimeve bujqësore. Sistemi informativ siguron qasje për shumë nivele duke filluar prej Ministrisë, kompanive të sigurimeve/risigurimeve, shoqatave dhe institucioneve tjera financiare. Komponentët kryesorë të tij janë në përputhje me procesin e sigurimit dhe lejojnë procedurat e mëposhtme: lëshimi i polisave të sigurimit bujqësor, mbledhja e të dhënave (moti, rendimenti), sistemi i vlerësimit të risigurimit, mbledhja e statistikave për krijimin e politikave qeveritare dhe krijon një sistem të automatizuar për administrimin e subvencioneve.

Përgjatë vitit 2020, përveç mjedrës, pesë produktet e tjera të sigurimit indeks u përfshinë në këtë sistem informativ.

Faqja (www.sigurimibujqesor.com)

Përveç ngjarjeve me karakter të ndryshëm në sektorin e bujqësisë, që nga viti 2018, projekti i sigurimeve ka punuar në zhvillimin e një faqe interneti që do të ishte e destinuar posaçërisht për sigurimet bujqësore të Kosovës. Kjo faqe në internet u lansua në fillim të vitit 2019 me emrin e domain-it (adresa) - "www.sigurimibujqesor.com".

Faqja aktualisht është plotësisht funksionale dhe mund të vizitohet gjithashtu nga faqja e internetit e MBPZhR-së, nën skedën "Sigurimi i Bujqësisë". Uebfaqja përfshin informacion mbi projektin e sigurimit, informacion të detajuar mbi produktet, artikujt e botuar nga puna e sigurimit dhe çmimet për secilin produkt të sigurimit. Përveç kësaj, kjo faqe u jep vizitorëve një mundësi për të llogaritur tarifat e tyre të sigurimit varësisht nga vendndodhja e tyre.

6.5 Projektet e zhvillimit rural – Grantet investive

Si çdo vit edhe për vitin 2020, Qeveria e Kosovës përmes MBPZhR-së e cila harton Programin për Zhvillimit Rural, ofron mbështetje përmes granteve investive për zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Programi për Zhvillim Rural 2020-21, adreson objektivat strategjike të zhvillimit agro-rural për periudhën 2014-2020, të cilat, janë:

- Rritja e aftësisë konkurruese të sektorit agro-ushqimor, që bazohet në përdorimin e teknologjisë moderne, në rritjen e prodhimit, të produktivitetit dhe sigurisë së ushqimit për të qenë konkurrent në tregun e brendshëm e të jashtëm, si dhe në zvogëlimin e bilancit negativ tregtar;
- Përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve në zonat rurale nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve në ferma dhe jashtë fermave, me qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjes së të ardhurave të banorëve ruralë;
- Mbrojtja e mjedisit dhe e resurseve natyrore, nëpërmjet investimeve në ujtje, kullim, trajtim të mbetjeve, si dhe në energji të ripërtërishme.

Në vijim paraqitet përmbajtja e granteve duke përfshirë masat dhe nën-masat e tyre.

Masa 101 – Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore, përfshinë sektorin e pemëve frutore (mollë, dardhë, kumbull, vishnje, qershi, kajsi, pjeshkë dhe ftua), sektorin e serrave përfshirë patatet dhe depo për ruajtjen e perimeve, sektorin e mishit (trashja e viçave), sektorin e mishit (trashja e derrave), sektorin e qumështit (lopë qumështore, dele dhe dhi), sektorin e pikave grumbulluese, sektorin e rrushit si dhe sektorin e pulave vojse;

Masa 103 – Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, përfshinë sektorin e përpunimit të qumështit, sektorin e përpunimit të mishit, sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve si dhe sektorin e prodhimit të verës;

Masa 302 – Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale, përfshinë nën-masat si prodhimi dhe marketingu i mjaltit, përpunimi i prodhimeve bujqësore (të kultivuara) dhe marketingun e tyre, zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre, zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë, akuakultura/kultivimi i peshkut dhe rritja e shpezëve për vezë dhe mish;

Masa – Ujitja e tokave bujqësore;

Masa 303 – Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale – qasja Leader, përfshinë nën-masën përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territoreve të GLV-ve të përzgjedhura; zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal, qasja LEADER – për GLV-të e përzgjedhura; dhe kooperimi-bashkëpunimi i cili do të fillohet në një fazë të mëvonshme, pasi që GLV-të të jenë mirë të strukturuar, punonjësit e tyre të jenë trajnuar dhe banorët e territoreve të tyre të kenë demonstruar kapacitet për të përfituar nga ato aktivitete;

Tabela më poshtë paraqet buxhetin e paraparë për implementimin e Programit për Zhvillimin Rural 2020-2021, vlera e paraparë arrin 29,370,000 € dhe përfshinë buxhetin për secilën masë dhe nën masë.

Tabela 102: Buxheti i paraparë i PZhR-së, 2020-2021

Masa dhe nën-masa	Vlera në €
Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore	17,620,000
101.1 Sektori pemë drufrutore arra dhe lajthia	3,200,000 800,000
101.2 Pemë manore	1,500,000
101.3 Sektori i perimeve dhe serrave	3,000,000
101.4 Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	1,200,000
101.5 Prodhimi i mishit/rritja e viçave	2,500,000
101.6 Prodhimi i mishit/rritja e derrave	400,000
101.7 Prodhimi i qumështit/lopë	2,500,000
101.8 Prodhimi i qumështit/dele dhe dhi	420,000
101.9 Pikat grumbulluese të qumështit	500,000
101.10 Prodhimi i rrushit	900,000
101.11 Prodhimi i vezëve	700,000
Masa 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	6,800,000
103.1 Sektori i përpunimit të qumështit	1,700,000
103.2 Sektori i përpunimit të mishit	2,000,000
103.3 Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve	2,100,000
103.4 Sektori i prodhimit të verës	1,000,000
Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	3,850,000
302.1 Sektori, bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit	700,000
302.2 Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i produkteve jo drusore të malit	700,000
302.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara	600,000
302.4 Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre	300,000
302.5 Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë	700,000
302.6 Sektori i akuakulturës/kultivimi i peshkut	350,000
302.7 Sektori rritja e shpezëve për vezë dhe mish	500,000
Masa: Ujitja e tokave bujqësore	800,000
Masa 303: "Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale qasje-Leader"	300,000
303.1 Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territoreve të GLV-ve të përzgjedhura	89,000
303.2 Hartimi dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal qasja LEADER për GLV-të e përzgjedhura	211,000
Gjithsej	29,370,000

Burimi: Programi për Zhvillim Rural 2020-21, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Implementimi i Programit për Zhvillimin Rural 2020-2021 ka hasë në vështirësi vitin e kaluar dhe vazhdon edhe gjatë vitit 2021.

Andaj, Raporti i Gjellbër këtë vit tek pjesa e projekteve të zhvillimit rural – grantet investive do ti prezantoj vetëm të dhënat e autorizuara nga Drejtoria e Autorizimit të Pagesave nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë deri me datë **31 Tetor 2021**.

Të dhënat të cilat do të prezantohen në vijim janë për masat:

101: Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore

103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, dhe

302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale

Në total janë autorizuar 239 aplikime, prej të cilave 153 janë nga masa 101 gjegjësisht nën masat sektori i pemëve drufrutore 48 aplikacione, arra dhe lajthia 13 aplikacione dhe sektori i perimeve dhe serrave 92 aplikacione në vlerë prej 7,948,496 €, ku vlera e miratuar për aplikacionet e kësaj nën mase ishte 7,526,391 €, ndërsa vlera e autorizuar pas aplikimi të % së përkrahjes e cila varësisht aplikimit ishte 60 -70% ishte 4,679,565 €.

Tabela 103: Numri i aplikacioneve, vlera e aplikuar e miratuar dhe autorizuar për masën 101

Masa 101	Nr. i aplikacioneve	Vlera e aplikuar në €	Vlera e miratuar në €	Vlera e autorizuar €
Spektori pemë drufrutore	48	3,274,309	2,965,689	1,815,140
Arra dhe lajthia	13	788,688	754,044	448,117
Spektori i perimeve dhe serrave	92	3,885,500	3,806,658	2,416,308
Gjithsej	153	7,948,496	7,526,391	4,679,565

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB), përpunuar nga DAESB – MBPZhR; *të dhënat janë të raportuara deri me datë 31.10.2021

Nga masa 103, është vetëm 1 aplikacion i miratuar nga nën masa sektori i prodhimit të verës me vlerë aplikimi dhe miratimi 399,600 €, ndërsa vlera e autorizuar pas aplikimi të % së përkrahjes ishte 198,061 €.

Tabela 104: Numri i aplikacioneve, vlera e aplikuar e miratuar dhe autorizuar për masën 103

Masa 103	Nr. i aplikacioneve	Vlera e aplikuar në €	Vlera e miratuar në €	Vlera e autorizuar €
Spektori i prodhimit të verës	1	399,600.00	399,600.00	198,061
Gjithsej	1	399,600.00	399,600.00	198,061

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB), përpunuar nga DAESB – MBPZhR; *të dhënat janë të raportuara deri me datë 31.10.2021

Nga masa 302, janë gjithsej 85 aplikacione nga nën masat prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit 41 aplikacione, përpunimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara 16 aplikacione, zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre 9 aplikacione dhe rritja e shpezëve për vezë dhe mish 19 aplikacione në vlerë prej 1,771,025 €, kurse vlera e miratuar ishte 1,626,245 € dhe vlera e autorizuar pas aplikimi të % së përkrahjes ishte 1,068,220 €.

Tabela 105: Numri i aplikacioneve, vlera e aplikuar e miratuar dhe autorizuar për masën 302

Masa 302	Nr. i aplikacioneve	Vlera e aplikuar në €	Vlera e miratuar në €	Vlera e autorizuar €
Prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit	41	816,694	706,891	467,527
Përpunimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara	16	314,585	305,918	193,747
Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre	9	259,987	249,419	166,138
Rritja e shpezëve për vezë dhe mish	19	379,759	364,017	240,807
Gjithsej	85	1,771,025	1,626,245	1,068,220

Burimi: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB), përpunuar nga DAESB – MBPZhR; *të dhënat janë të raportuara deri me datë 31.10.2021

Sa i përket masës për ujitjen e tokave bujqësore e cila është pjesë Programit për Zhvillimin Rural 2020-2021, për periudhën e raportuar deri më 31.10.2021 vetëm 1 aplikacion është pranuar në avans me vlerë prej 80,000 €.

6.6 Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve

6.6.1 Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, bazuar në planin e punës në vazhdimësi merret me edukimin dhe trajnimin e këshilltarëve dhe të fermerëve duke ofruar këshilla dhe trajnime. Të gjitha këto trajnime dhe këshilla organizohen bazuar në Ligjin për shërbime këshilluese nr. 04/L-074, udhëzimet administrative që dalin nga ky ligj dhe Strategjinë e Shërbimit Këshillues 2015-2020.

Shërbimi këshillues me ligj është i organizuar në formë të sistemit këshillues për bujqësi dhe zhvillim rural, ku përfshin të gjitha komunat e Republikës së Kosovës duke përfshirë sektorin publik dhe atë privat.

Projektet që janë zhvilluar në Departamentin e Shërbimeve Këshillimore:

- Projekti “Përkrahja e fermerëve për analiza të tokës, trajnime, këshillime dhe rekomandime për rezultatet e analizave të tokës”, i cili financohet nga buxheti i Kosovës;
- Projekti “Ofrimi i këshillave e trajnimeve për fermerët, ngritja e kapaciteteve për këshilltar komunal dhe hapja e QIK-ve në komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan”, i cili financohet nga buxheti i Kosovës;
- Projekti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, komponenti e parë: “Trajnimi i fermerëve aplikues potencial për grante”, i financuar nga Banka Botërore, projekt i cili nuk ka mund të jap kontributin për të cilin ishte dizajnuar, për arsye të trajnimeve online dhe nuk ka arritur objektivat.

- Projekti “Trajnim për certifikimin e kandidatëve për Shërbimet Këshillimore në Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe për përmirësimin e efikasitetit të stafit këshillues”, i financuar nga Banka Botërore. Ky projekt sipas termave të referencës është paraparë si projekt 3 vjeçar (2019-2021), mirëpo Banka Botërore konkretisht projekti ARDP ka kontraktuar një kompani në Qershor të vitit 2020 e cila ka realizuar aktivitetet e vitit (2019-2021), në formë online.

Projektet që janë planifikuar por nuk janë realizuar:

- Projekti “Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit të Shërbimeve Këshilluese”, i cili financohet nga buxheti i Kosovës, është ndërprerë dhe nuk është zhvilluar tutje.

Përmes projektit “Përkrahja e fermerëve për analiza të tokës, trajnime, këshillime dhe rekomandime për rezultatet e analizave të tokës”, ka vazhduar realizimin i aktiviteteteve sipas planit:

- Marrja dhe analizimi i mostrave të tokës ku janë marrë 380 mostra, mostrat e marra janë analizuar në laborator;
- Prezantimi i analizave ku janë prezantuar të gjitha rezultatet dhe secilit fermer i është dhënë dokumenti i analizës, dhe rekomandimet në bazë të analizave.
- Trajnime rreth analizave, ku janë trajnuar 884 fermer, dhe
- Janë përgatitur dhe shtypur broshura për analizat e tokës.

Tabela 106: Pjesëmarrja në trajnime

Pjesëmarrësit në Trajnime, 2020							
Nr. i trajnimeve	Gjithsej nr. i pjesëmarrësve	Shqiptarë	Minoritete	Femra	Meshkuj	Mosha 18-40 vjeçar	Mosha mbi 40 vjeçar
65	884	709	175	52	832	299	585
	100%	75%	25%	4%	96%	24%	76%

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

Sa i përket projektit “Ofrimi i këshillave e trajnimeve për fermerët, ngritja e kapaciteteve për këshilltar komunal dhe hapja e QIK-ve në komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut dhe Zveçan”, janë realizuar aktivitetet në vijim:

- Mobilizimi i këshilltarëve komunalë dhe hapja e QIK-ve në 4 komunat e Republikës së Kosovës;
- Organizimi i 20 këshillimeve nga ekspertë në sektorë të ndryshëm;
- Pjesëmarrja e fermerëve në këto këshillime, ishte 216 fermer në të gjitha komunat;

Projekti “Trajnim për certifikimin e kandidatëve për Shërbimet Këshillimore në Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe për përmirësimin e efikasitetit të stafit këshillues”. Në periudhën Qershor - Dhjetor 2020 janë organizuar trajnimet e kandidatëve që kanë aplikuar në vitin 2019 dhe 2020, ku gjithsejtë ishin 174 kandidat (95 në vitin 2019 dhe 79 në vitin 2020). Nga gjithsej 174 janë certifikuar 144 këshilltar për bujqësi dhe zhvillim rural.

Aktivitetet e zhvilluara në Qendrat Këshilluese Informative (QKI) komunale të shërbimeve këshillimore

Janë organizuar aktivitete për të përkrahur fermerët me këshilla teknike në sektorët e blegtorisë, bletarisë, vreshtarisë, pemëtarisë dhe perimtarisë dhe prodhimtarisë organike. Aktivitetet e zhvilluara në qendrat këshilluese informative komunale të shërbimeve këshillimore janë zhvilluar me një intensitet më të ulët, megjithatë konform kushteve të krijuara janë realizuar disa aktivitete në mbështetje të fermerëve si: mbështetja e fermerëve në plotësimin e aplikacioneve për grante dhe subvencione, pranimi i dokumentacioneve për subvencione, janë shpërndarë materiale për ekstension si broshura fletëpalosje, etj.

Po ashtu këshilltarët e terrenit brenda mundësive që kanë lejuar kushtet e pandemisë kanë realizuar disa aktivitete me pajisjet e tyre në përkrahje fermerëve për përcaktimin e disa parametrave dhe në bazë të tyre në dhënien e këshillave.

Aktivitetet e zhvilluara në Qendrat këshilluese informative komunale janë si në vijim:

Tabela 107: Aktivitetet e zhvilluara në qendrat këshilluese komunale

Nr. i aplikacioneve për subvencione të pranuar nga këshilltarët	9,376
Nr. i fermerëve të informuar për grante dhe subvencione	6,947
Nr. i fermerëve të përkrahur në aplikim për grante dhe subvencione	4,229
Nr. i fermerëve të përkrahur në përgatitjen e projekteve	709
Materialet e dhëna në formë të broshurave dhe fletëpalosjeve	5,155
Nr. i fermerëve i përkrahur me këshilla teknike në zyre	4,797
Nr. i përfituesve me trajnime dhe këshilla në teren	847

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

Sa i përket aktiviteteve të zhvilluara në terren të këshilltarëve me pajisjet janë:

Tabela 108: Aktivitetet e zhvilluara në terren nga këshilltarët

Nr. i mostrave të marra dhe dërgimi i tyre për analizë	132
Nr. i matjeve dhe përcaktimi i pH të tokës	37
Nr. i matjeve dhe përcaktimi i pH të ujit	37
Nr. i matjeve të kripëzimit në tokë – EC e që bazohet në përmbajtje të kripërave në tokë	32
Nr. i matjeve të temperaturës dhe lagështisë së ajrit në objekte të mbyllura	30
Nr. i matjeve të sheqerit në fryte dhe përcaktimi i afatit të vjeljes	18
Nr. i matjeve të fortësisë së fryteve dhe përcaktimi kohës së vjeljes	25
Identifikimi i dëmtuesve në kultura bujqësore	29

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

Në kuadër të trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të këshilltarëve për bujqësi dhe zhvillim rural, janë mbajtur trajnime për ngritjen e kapaciteteve në bashkëpunim DShKT/USAID, ku kanë marrë pjesë 40 këshilltarë publik komunal dhe rreth 30 këshilltar privat të certifikuar për bujqësi dhe zhvillim rural, temat trajnimit ishin:

- Grantet e USAID-it, kërkesat për aplikim dhe procesi
- Grantet e EU-së dhe kërkesat - shkrimi i projektit
- Dokumentet dhe procesi tek grantet e EU-së
- Informimi dhe Promovimi –
- Vështrimi i përgjithshëm i granteve
- Llojet e granteve
- Monitorimi dhe vlerësimi i programit AGRO
- Perimekulturë
- Pemë të imëta
- Pemëtari dhe Vreshtari
- Standardet e sigurisë së ushqimit, GLOBAL G.A.P.
- Vlerësimi mjedisor

DShKT është përgjegjëse për planifikimin, bashkërendimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve këshilluese në nivel kombëtar dhe lokal. Po ashtu koordinon edhe me kompanitë e licencuara të cilat sipas udhëzimit administrativ obligohen të raportojnë dy herë brenda vitit si dhe të dërgojnë planin vjetor në DShKT. Në tabelën në vijim janë të paraqitura kompanitë e licencuara dhe raportimi i tyre.

Tabela 109: Licencimi i kompanive për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural

Kompanitë	Trajnime	Ditë fushore	Vizita në fermë	Punëtori	Konferenca	Fletëpalosje	Broshura	Panaire	Vizita në regjion dhe BE
IADK	300				4	5	2		7
Consult Engineering					1				
IKC	21	2	210	7	1	500	350	8	1
ESG	614	380	24	4	4		43,500		5
KDC	10	20	50	2	2	2,000	1,000		1
NSH. KMI									
SH.P.K "PMC"									
Ekrem Strana B.I	10	100	60	2		150	150		3
Novus Consulting	10	5					200		
Kosovo Consulting Group SH.P.K	2	1	75						
Agrovinifera Sh.P.K									
Recura Sh.a									
Organika									

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

6.6.2 Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor

Promovimi vazhdon të bëhet përmes web-faqes e cila azhurnohet vazhdimisht me informacione të reja dhe është në funksion nga DShKT, ku ofrohen shërbime, të dhëna statistikore dhe këshilla nga të gjitha fushat.

Duke u gjendur në një situatë pandemike, vizitat tek fermerët për video incizime rreth praktikave të mira nuk kanë mund të realizohen. Mirëpo, përmes informacioneve në web faqe DShKT është munduar që të qëndroj sa më afër palëve të interesuara duke ju shërbyer me gjitha resurset që ka në dispozicion.

Do të vazhdohet në të ardhmen puna në promovim të sektorit përmes shpërndarjes së broshurave informuese dhe gjithashtu mesazheve me karakter informues dhe vetëdijësues për punët dhe sukseset e fermerëve në bujqësi.

6.7 Politikat mbi tregjet, tregtinë dhe zhvillimet e politikave ndërkombëtare

Sa i përket zhvillimeve të politikave tregtare bujqësore, pas hyrjes në fuqi dhe fillimit të zbatimit të MSA dhe CEFTA-s për kapitujt 1-24, bazuar në të dhënat statistikore nga Doganat e Kosovës, vërehet se ka një rritje të vogël të eksportit për disa produkte bujqësore, por njëkohësisht vërehet edhe një rritje e vogël e importit të produkteve bujqësore nga shtetet e BE-së para fillimit të zbatimit të MSA-së.

Sipas të dhënave nga Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit dhe të Doganave të Kosovës, produktet të cilat eksportohen në sasi të vogla janë: patatet, specat, mielli, birra, vera, ujërat,

ndërsa eksporti më i madh është tek të gjitha llojet e bimëve aromatike medicinale dhe frutat e malit.

Prej vitit 2017, kur Komisioni Ndërmintor për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në Importe me qëllim të mbrojtjes së prodhuesve të miellit, ka rekomanduar Ministrinë e MINT-së për marrjen e masës së veçantë për vendosjen e një tarife shtesë për miellin e importuar nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës në vlerë prej 0.04 €/kg të miellit të importuar, masë e cila është ende në fuqi. Me qëllim të mbrojtjes së këtij sektori dhe zhvillimit të industrisë së miellit, si dhe rritjes së prodhimtarisë së grurit me datë 19.10.2017, MINT ka nxjerrë vendimin lidhur me rekomandimin që i është bërë nga Komisioni Ndërmintor për Vlerësimin e Detyrimeve të Veçanta në importe lidhur me importin e miellit nga Republika e Serbisë. Ky instrument politik ka dhënë rezultate pasi që është arritur që të mbrohet industria e miellit dhe prodhimtaria e grurit në Kosovë.

Reformat e Politikave të Përbashkëta Bujqësore gjatë dekadës së fundit kanë nxitur sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore të vendit në përmirësimin e orientimit të tij drejt tregjeve Evropiane dhe vendeve të tjera jashtë BE-së, duke u bërë kështu produktet tona bujqësore konkurruese me vendet e regjionit dhe më gjerë.

Si rezultat i kësaj, vlera e eksportit të produkteve agro-ushqimore është dyfishuar dhe Kosova është duke u bërë shtet konkurrues në disa nivele të zinxhirit të vlerave të produkteve bujqësore.

Me qëllim të zhvillimit të politikave tregtare bujqësore, mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, MBPZhR ka formuar grupin punues për hartimin e draft strategjisë për "Avancimin e Ndërmarrjeve Agropërpunuese". Grupi punues ka filluar punën dhe është në fazën e grumbullimit dhe shqyrtimit të materialeve nga institucionet relevante me qëllim të hartimit të draftit të parë. MBPZhR – DPBT, në hartimin e këtij drafti presim angazhimin e eksperteve ndërkombëtar nga projekti "Ndërtimi i kapaciteteve për Kosovën në lidhje me Organizimin e Tregut të Përbashkët të BE-së (OTP) dhe Statistikat Bujqësore".

7 Shtojcat

7.1 Lista e ligjeve dhe akteve ligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural

7.1.1 Legjislacioni kombëtar në fuqi

Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27 Korrik 2009)

7.1.2 Udhëzimet Administrative të miratuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2020

1. Udhëzimi Administrativ (MBPZhR) - NR. 01/2020 të datës 11.06.2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2010 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, të dt.27.12.2006.
2. Udhëzimit Administrativ (MBPZhR)-NR.02/2020 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për Vitin 2020-2021, të datës 17.07.2020.
3. Udhëzimit Administrativ (MBPZhR)-NR.03/2020 për pagesa direkte në bujqësi për vitin 2020, të datës 17.07.2020.

7.2 Statistikat krahasuese

Tabela 110: Reshjet mesatare për vit sipas zonave klimatike, (mm, l/m²)

	2015	2016	2017	2019	2020
Rrafshi i Kosovës	696.7	754.2	591.9	561.9	671.7
Rrafshi i Dukagjinit	683.9	948.7	701.1	696.9	654.9

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Tabela 111: Pyjet e Kosovës sipas llojit dhe pronësisë

	Shtetërore	Private	Gjithsej
Pyje te larta	51,000	15,000	66,000
Pyje te ulëta	116,000	63,000	179,000
Pyje te degraduara	34,000	48,000	82,000
Shkurre/kaçuba	67,000	36,000	103,000
Gjithsej	268,000	162,000	430,000

Burimi: APK- Agjencia Pyjore e Kosovës

Tabela 112: Përdorimi i internetit sipas grup-moshave, %

	2018	2019	2020
16-24	17.0	14.5	17.4
25-34	16.5	17.4	16.1
35-44	20.6	20.5	19.5
45-54	19.3	19.5	18.9
55-64	12.7	13.5	15.5
65+	8.4	9.2	10.1

Burimi: ASK- Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 113: Treguesit e zgjedhur makroekonomikë

	BPV-ja reale			Norma e papunësisë			Inflacioni		
	2018	2019	2020	2018	2019	2020	2018	2019	2020
Eurozona	1.9	1.3	-6.6	8.2	7.6	7.9	1.8	1.2	0.3
Gjermania	1.3	0.6	-4.9	3.4	3.2	4.2	1.9	1.4	0.4
Franca	1.9	1.5	-8.2	9.0	8.5	8.2	2.1	1.3	0.5
Italia	0.9	0.3	-8.9	10.6	9.9	9.1	1.2	0.6	-0.1
Spanja	2.4	2.0	-11.0	15.3	14.1	15.5	1.7	0.7	-0.3
Kosova	3.8	4.9	-3.9	29.6	25.7	25.6	1.1	2.7	0.2
Mali i Zi	5.1	4.1	-15.2	n/a	n/a	n/a	2.6	0.4	-0.2
Maqedonia e Ver.	2.9	3.2	-4.5	20.7	17.3	16.4	1.5	0.8	1.2
Bosnja dhe Herc.	3.7	2.8	-5.5	18.4	15.7	19.0	1.4	0.6	-0.6
Serbia	4.5	4.2	-1.0	13.3	10.9	13.3	2.0	1.9	1.7
Shqipëria	4.1	2.2	-3.5	12.3	11.5	12.5	2.0	1.4	1.6

Burimi: FMN, WEO prill 2021, ASK dhe BQK për Kosovën

7.3 Personat përgjegjës për Raportin e Gjelbër, 2021

Tabela e përmbajtjes		Personi përgjegjës
1	<u>Mjedisi i përgjithshëm ekonomik</u>	
1.1	<u>Niveli i zhvillimit socio-ekonomik</u>	H. Xhaferi
1.2	<u>Puna dhe punësimi</u>	H. Xhaferi
1.3	<u>Llogaritë ekonomike në bujqësi</u>	E. Mekuli
1.3.1	<u>Prodhimet bujqësore</u>	E. Mekuli
1.3.2	<u>Të ardhurat sipërmarrëse</u>	E. Mekuli
1.3.3	<u>Inputet në bujqësi</u>	E. Mekuli
1.4	<u>Çmimet e inputeve dhe prodhimeve bujqësore</u>	E. Mekuli
1.4.1	<u>Çmimet e inputeve bujqësore</u>	E. Mekuli
	<u>Çmimet e fermës të prodhimeve bujqësore</u>	D. Hana
	<u>Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore</u>	D. Hana
	<u>Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore</u>	D. Hana
	<u>Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së</u>	D. Hana
1.4.2	<u>Çmimet e prodhimeve bujqësore</u>	D. Hana
1.5	<u>FADN - Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit në fermë</u>	E. Mekuli
1.5.1	<u>Rezultatet Standarde të FADN-së në Kosovë</u>	E. Mekuli
1.5.2	<u>Krahasimi me vendet e BE-së</u>	E. Mekuli
1.6	<u>Privatizimi i tokave bujqësore</u>	H. Xhaferi
1.7	<u>Bizneset bujqësore – Agroindustria</u>	H. Xhaferi
2	<u>Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij</u>	
2.1	<u>Përdorimi i tokës bujqësore</u>	H. Xhaferi
2.2	<u>Madhësia e fermës</u>	H. Xhaferi
2.3	<u>Prodhimtaria bimore</u>	A. Maksuti
2.3.1	<u>Drithërat</u>	A. Maksuti
2.3.2	<u>Perimet</u>	D. Hana
2.3.3	<u>Pemët</u>	D. Hana
2.3.4	<u>Vreshtat dhe verërat</u>	E. Mekuli
	<u>Vreshtat</u>	E. Mekuli
	<u>Verërat</u>	E. Mekuli
	<u>Analizat fiziko-kimike të verës</u>	E. Mekuli
2.3.5	<u>Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra</u>	A. Maksuti
2.3.6	<u>Kulturat industriale</u>	A. Maksuti
2.3.7	<u>Prodhimtaria Organike në Kosovë</u>	D. Hana
2.4	<u>Ujitja e tokës bujqësore</u>	D. Hana
2.5	<u>Blegtoria</u>	A. Maksuti
2.5.1	<u>Gjedhet</u>	A. Maksuti
2.5.2	<u>Dhentë dhe dhinë</u>	A. Maksuti
2.5.3	<u>Derrat dhe kafshët e tjera të fermës</u>	A. Maksuti
2.5.4	<u>Shpezëtaria</u>	A. Maksuti
2.5.5	<u>Bletaria</u>	A. Maksuti
3	<u>Pylltaria</u>	S. Bajrami
4	<u>Tregtia</u>	
4.1	<u>Tregtia e përgjithshme</u>	B. Dabiqaj/ H. Xhaferi
4.2	<u>Tregtia e produkteve bujqësore</u>	B. Dabiqaj/ H. Xhaferi
4.2.1	<u>Tregtia sipas grupeve të shteteve</u>	B. Dabiqaj/ H. Xhaferi
	<u>Tregtia me vendet e CEFTA-s</u>	B. Dabiqaj/ H. Xhaferi
	<u>Tregtia me vendet e BE-së</u>	B. Dabiqaj/ H. Xhaferi
	<u>Tregtia me vendet e treta</u>	B. Dabiqaj/ H. Xhaferi
4.2.2	<u>Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)</u>	B. Dabiqaj/ H. Xhaferi
	<u>Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)</u>	B. Dabiqaj/ H. Xhaferi

	<u>Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24)</u>	B. Dabiqaj/ H. Xhaferi
5	<u>Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit</u>	H. Xhaferi
5.1	<u>Emetimi i gazrave serrë në Kosovë</u>	H. Xhaferi
6	<u>Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural</u>	
6.1	<u>Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve</u>	A. Maksuti
6.2	<u>Pagesat direkte/subvencionet</u>	A. Maksuti
6.2.1	<u>Pagesat direkte për kulturat bujqësore, verë dhe sigurim bujqësor</u>	A. Maksuti
	<u>Sigurimi bujqësor</u>	A. Maksuti
6.2.2	<u>Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht</u>	A. Maksuti
6.2.3	<u>Mbështetja e inputeve në bujqësi</u>	A. Maksuti
	<u>Mbështetja e fidanëve</u>	A. Maksuti
6.3	<u>Agro kreditë dhe fondi garantues</u>	Sh. Duraku
6.3.1	<u>Agro Kreditë</u>	Sh. Duraku
6.3.2	<u>Fondi garantues</u>	Sh. Duraku
	<u>Fondi Kosovar për Garanci Kreditore - FKKG</u>	Sh. Duraku
6.4	<u>Sigurimet në fushën e bujqësisë</u>	A. Maksuti
	<u>Produktet Indeks të Sigurimit Bujqësor</u>	A. Maksuti
	<u>Dëmet/humbjet dhe Pagesat e Dëmshpërblimit</u>	A. Maksuti
	<u>Produktet Tradicionale të Sigurimit Bujqësor</u>	A. Maksuti
	<u>Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore</u>	A. Maksuti
	<u>Kampanjat Publike Vetëdijësuese</u>	A. Maksuti
	<u>Sistemi Informativ i Sigurimeve Bujqësore</u>	A. Maksuti
	<u>Faqja (www.sigurimibujqesor.com)</u>	A. Maksuti
6.5	<u>Projektet e zhvillimit rural - Grantet investive</u>	D. Hana
6.6	<u>Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve</u>	D. Hana
6.6.1	<u>Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor</u>	D. Hana
6.6.2	<u>Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor</u>	D. Hana
6.7	<u>Politikat mbi tregjet, tregtinë dhe zhvillimet e politikave ndërkombëtare</u>	H. Xhaferi
7	<u>Shtojcat</u>	
7.1	<u>Lista e ligjeve dhe akteve ligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural</u>	D. Hana
7.1.1	<u>Legjislacioni kombëtar në fuqi</u>	D. Hana
7.1.2	<u>Udhëzimet Administrative të miratuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2020</u>	D. Hana
7.2	<u>Statistikat krahasuese</u>	H. Xhaferi

e-mailat kontaktues:

delvina.hana@rks-gov.net

hakile.xhaferi@rks-gov.net

adelina.maksuti@rks-gov.net

edona.mekuli@rks-gov.net

shkelqim.duraku@rks-gov.net

belgin.dabiqaj@rks-gov.net

skender.bajrami@rks-gov.net